



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJE

RAPORT I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS



***“Rikonstrukcion dhe ndertim palestere, ne shkollen 9-vjeçare
Thumane Kruje “***

Përgatitur nga:
Shoqeria “ERALD-G” shpk
GEZIM ISLAMI
Administrator

Viti 2018

PERMBAJTJA E RAPORTIT

1-Hyrje	4
2.1-Legjistacioni i shfrytezuar per hartimin e ketij raporti	10
2.2 -Perskrim te metodikes per hartimin e ketij raporti	15
2.2.1 –Vleresimi i rrezikut ne hartimin e ketij raporti	16
2.2.2 –Analiza e rrezikut	17
2.2.3 –Egzaminimi i ndikimeve dhe parashikimi i pasojave	17
2.3 – Planet territoriale	21
2.3.1– Planifikimi hapasinor	21
2.3.2– Standartet mjedisore te perdorura per ndertimin e shkollave	21
3. -Perskrimi i projektit	24
3.1- Perskrimi i qellimit te projektit	Error! Bookmark not defined.
3.2 –Natyra e projektit	31
3.3 –Madhesia e projektit dhe rendesia per rajonin ku do ndertohet	31
3.3.1 –Rendesia e projektit per rajonin ku do ndertohet	31
3.4 –Kriteret e pergjithshme per projektimin e objektit	Error! Bookmark not defined.
3.5–Karakteristikat , perskrimi dhe programi per ndertimin	32
3.5.1 –Karakteristikat e vendit te ndertimit	32
3.5.2 –Perskrimi i projektit	Error! Bookmark not defined.
3.5.3 –Programi per ndertimin	32
3.5.4–Perskrimi i alternativave dhe analiza e tyre	33
4. –Perskrimi i gjendjes egzistuese te mjedisit	35
4.1–Kushtet klimaterike	35
4.2 –Ekosistemet , flora dhe fauna	36
4.3 –Popullsia	37
4.4–Sizmiciteti	38
4.5–Hidrologjia	40
4.7–Trashegimia , peisazhi dhe statusi i zones	44
4.8–Rrjeti rrugor dhe trafiku	Error! Bookmark not defined.
5.–Efektet e kesaj veprimtarie ne mjedis te drejtperdrejta dhe te terthorta	47
5.1 –Ndryshimet ne mjedis gjate ndertimit	47
5.1.1 –Ndryshimet ne mjedis gjate punimeve te germimit	47
5.1.2 –Pritshmerite e ndodhive gjate ndertimit te objektit	48
5.2 –Ndikimet ne fazen e ndertimit	51
5.2.1–Masa te rekomanduara ne fazen e ndertimit	54
5.2.2–Peisazhi dhe bukurite natyrore	55
5.2.3 –Cilesia e ajrit	64

5.2.4 –Uji siperfaqesor dhe nentokesor -----	68
5.2.5 –Zhurmat dhe dridhjet-----	69
5.2.5.1 –Zona ku mund te perdoren shperthime per zgjerimin e rruges -----	72
5.2.5.2 –Ndjeshmeria e receptoreve -----	74
5.2.5.3 –Zbutja e zhurmave te trafikut -----	Error! Bookmark not defined.
5.2.7 –Mbeturinat qe krijohen -----	74
5.3 –Vleresimi i ndikimeve dhe masat zbutese -----	75
5.4 –Ndikimi ne ambjentin perreth objektit -----	76
5.5 –Ndikimi ne mjedis gjate shfrytezimit te objektit -----	78
5.5.1 –Tokat me bimesi -----	81
5.5.2 –Habitatet -----	81
5.5.3 –Reptilet-----	82
6 –Plani i menaxhimit te mjedisit -----	82
6.1 –Rekomandime per minimizimin e ndikimeve negative-----	84
6.2 –Vleresimi i efekteve ne menyre permbledhese -----	89
6.2.1 –Metodologjia e vleresimit -----	89
7–Plani i masave te mbrojtjes se mjedisit -----	93
7.1–Plani i reagimit ndaj emergjencave (PRE) -----	93
7.2–Plani i masave social ekonomike -----	94
7.2.1 –Plani i manaxhimit social ekonomike-----	95
7.2.2 –Qellimi i vleresimit social ekonomike-----	96
7.2.3 –Masat e rekomanduara social ekonomike dhe te shendetit -----	97
7.3–Permbledhje e masave zbutese , kompensimi dhe rritja e masave -----	100
7.3.1–Gjitaret-----	100
7.3.2–Vleresimi rendesise se efekteve dhe parimet zbutese -----	103
7.3.3–Parimet zbutese ne sistemet ekologjike -----	104
7.4–Plani i menaxhimit te trafikut-----	105
8–Plani i Monitorimit te ndikimit ne mjedis -----	106
8.1 –Permbajtja e Planeve te Monitorimit te ndikimit ne mjedis-----	110
9 –Benifitet e projekti -----	116
9.1 –Permiresim ne infrastrukture-----	116
9.2 –Zhvillim ekonomik , punesim dhe rritje e cilesise se jetes -----	117
9.3–Analiza SWOT -----	117
9.5–Turizem -----	117

SHKURTIMET DHE FJALOR

BE	Bashkimi Europian
CH₄	Metani
CO₂	Dioksid Karboni
DPKZHT	Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
DRM	Drejtoria Rajonale e Mjedisit
INU	Inspektorati Ndërtimit dhe Urbanistikës
IUCN	Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës
KUZ	Kanalizimet e Ujrave të Zeza
KUB	Kanalizimet e Ujrave të Bardha
LNP	Lënda e Ngurtë Pezull
N₂O	Oksid azoti
NBO	Nevoja Biokimike për Oksigjen
NH₃	Amoniaku
NKO	Nevoja Kimike për Oksigjen
NO_x	Oksidet e Azotit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PM₁₀	Grimcat e imta
SO_x	Oksidet e Squfurit
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
MNRRU	Manual për ndërtimin e rrugëve dhe urave
PMM	Plani i menaxhimit mjedisor
RP	Raport mjedisor
VNMS	Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social
VR	Vlerësimi i rrezikut
MS dhe SH	Menaxhimi social dhe shëndetsor
Receptor	Qenie e gjallë ose objekt që mund të ndikohet nga një ndërhyrje në mjedisin pranë vendndodhjes së tij

1–Hyrje

Fushe Kruja është një prej qyteteve më historike të Shqipërisë. Ajo ndodhet në një distancë të afërt nga kryeqyteti, vetëm 32 km larg. Emri dhe rëndësia e Fushe Krujës lidhet me veprën dhe aktivitetin 25 vjeçar të heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti (Skënderbeu) i cili gjatë periudhës së mesjetës në shek e XVI e shndërroi Fushe Krujën në një pikë të papërkulur rezistencë ndaj rrezikut Osman dhe duke e bërë atë të njohur dhe të famshme në të gjitha kancelaritë diplomatike të Europës.

Emri i Fushe Krujës rrjedh nga fjala shqipe “krua”. Në periudhën bizantine ajo përmendet si një që ndër peshkopale . Rreth vitit 1190 aty u krijua i pari shtet feudal shqiptar. Më vonë ajo kaloi nën sundi min e familjes feudale shqiptare të Topiajve . Pushtimi i parë ottoman ndodhi në 1396 por ata u terho qën për 20 vjet . Në 1430 ajo u kthye në qendër të kryegritjes Shqiptare të udhëhequr nga Gjon Kastri oti , i ati i Skënderbeut. Periudha më e lavdishme fillon në 28 Nëntorin e vitit 1443 kur kalaja e Krujës u morr në kontrollin e Gjergj Kastriotit , i cili organizoi rezistencën e gjatë anti – ottomane. Që nga kjo periudhë Kruja nën udhëheqjen e Skënderbeut theu tre rrethime të saj nga ottomanet në 1450, 1457 dhe 1466. Vetem 10 vjet mbas vdekjes së Skënderbeut në 1478 otomanët pushtuan kalanë dhe shkatë rruan qytetin .Ata e quajtën Fushe Krujën Akcahisar (fortesë e bardhë). Pjesa e popullsisë që mbeti u kthye në myslimane.



Fushe Kruja si pjese perberese e qytetit te Krujes është një nga qytetet me historinë më të ndritur, më të mirë dhe më të dokumentuar se të gjithë qytetet e tjerë shqiptarë, çka e bën atë një

“kryeqytet” të vërtetë historik. Historia e këtij qyteti të lashtë na bën të ndihemi krenarë sa herë që e vizitojmë.


Në një farë mënyre Fushe Kruja është “oda shqitare e pritjes”, ku të huajt njihen me historinë tonë shekullore. Pa dyshim mund të quhet aktraksioni më i madh turistik në Shqipëri, si për të huajt ashtu edhe për ne. Fushe- Kruja i ka premiset për të qenë madhështore në çdo kohë. Ka qenë kryeqendër në një nga periudhat më të lavdishme të historisë së shqiptarëve, në periudhën e Heroit Kombëtar, Skënderbeut. Ka qenë zonë e njohur që në lashtësinë ilirike.

Me këtë histori dhe objektet arkeologjike që e pasqyrojnë atë, kalaja, muzeu, pazari karakteristik, rrënojat e Albanopolisit dhe monumenti i Skënderbeut, etj., Kruja është në interesin e të gjithë shqiptarëve, sidomos të turistëve të huaj.

Veç vlerave historike pozicioni i Fushe Krujës, mjedisi mali, kodrat, fushat, deti krijojnë një panoramë të mrekullueshme për t’a soditur, pse jo edhe për të jetuar. Fushe - Kruja mund të jetë një rezidencë interesante për shumë vizitorë që vijnë në Shqipëri për arsye pune apo për turizëm. Pamja që të shpërfaqet nga Fushe Kruja, në kohë të kthjellët, sidomos natën, në dritën e hënës e të yjeve, është shumë mbresëlënëse. Shihet fusha e gjerë, shihet aeroporti i Rinasit, kalaja e Prezës, ajo e Petrelës dhe e Lezhës. Shihet deti Adriatik, Durrësi, Porto Romano, Patoku e më tej Lezha e Shëngjini. Është një mrekulli. Duket sikur fluturon mbi hapësira të pamata. Pak më në lindje të Krujës është pika turistike e Qafë Shtamës që mund të kthehet në një perlë të turizmit malor. Aty është dhe instalimi i prodhimit të ujit ‘Qafështama’, që ka zënë një vend të veçantë në tregun shqiptar. Kruja është edhe vend pele grinazhi fetar. Teqeja bektashiane, lart në mal, është një vend i shenjtë që ka rifilluar të vizitohet nga mijëra njerëz.

Thumana ka potenciale të mëdha ekonomike, sidomos në fushën e prodhimeve blegtorale dhe të pemëtari së. Mund të bëhet një serë e madhe e prodhimeve bio shumë të kërkuara nga qytetarët, sidomos nga turistët.





Projekti yne eshte “*Rikonstruktion dhe ndertim palestre, ne shkollen 9-vjecare Thumane* “ Kruje dhe sherben per permirësimin e infrastruktures se shkollavave ne Fushe Krujës , dhe akses shume te mire per femijet ne procesin e mesimnxenies. Projekti per rikonstruktionin e shkolles se mesme “Shote Galica” ne Fushe- Kruje eshte hartuar duke marre ne konsiderate problemet aktuale qe paraqet godina si dhe zhvillimin perspektiv te shkollave si institucione edukative.

Shkolla aktualisht ka 1230 nxenes dhe 54 mesues. Kapaciteti mesatar i cdo klase eshte afersisht 42 nxenes/klase. Sic vihet re nga pershkrimi dhe te dhenat qe na jep gjendja ekzistuese, themi se shkolla karakterizohet nga mungesa te theksuara hapësirash dhe ambjentesh studimore. Hapësirat qe ajo ve ne dispozicion te nxenesve, por edhe te stafit mesimor paraqiten jashte cdo standarti dhe sjellin mangesi te dukshme gjate procesit mesimor dhe edukativ. Si pasoje e mungeses te ambienteve studimore dhe numrit te madh te nxenesve, procesi mesimor kryet me dy trune (paradite dhe mbasdite).

Synimi i ketij projekti ka te beje me perftrimin e hapësirave reja qe plotesojne nevojat e nxenesve dhe mesuesve per kryerjen e veprimtarive perkatese. Gjithashtu, hapësira ekzistuese do t’i pershtatet kerkesave bashkekohore per nje shkolle qe i pergjigjet jo vetem se tashmes, por edhe brezave te se ardhmes.

Parcela e vënë në dispozicion për këtë ndërtim është dhënë nga Bashkia e Krujes. Ajo ka nje siperfaqe prej 5477 m².

2.–Pershkrimi i qellimit dhe objektivave

Qëllimi kryesor i hartimit të VNM-se është evidentimi dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe marrja e masave të domosdoshme për minimizimin dhe parandalimin e efekteve të demshme në mjedis gjatë studimit , projektimit dhe me pas ndertimit të këtij objekti e shfrytëzimit të tij .

Qëllimi kryesor i hartimit të VNM-së është të identifikojë mënyrat se si projekti i propozuar mund të hartohet dhe të transformohet në mënyrë të tillë për të zbutur efektet e padëshiruara në mjedis. Në mënyrë të thjeshtë, zbutja e mjedisit është konsideruar të përfshijë ndonjë veti të projektit të propozuar , i cili shmanget , zvogëlon ose riparon efektin e saj negativ mbi mjedisin apo siguron përfitime mjedisore . Masat zbutëse mund të përfshijnë aspektet fizike të projektit apo mënyrat sipas të cilave ai është projektuar dhe do të ndertohet .

Në përmbushje të detyrimeve të legjislacionit shqiptar i cili është përafshuar plotësisht me Direktivën 85/337/KEE të Këshillit të Europës, Datë 27 Qershor 1985 “Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin”, të ndryshuar me Direktivën 97/11 të Këshillit të Europës si dhe Procedurave Mjedisore të kërkuara nga BERZH , me qëllim që të sigurohet:

a) një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekti i propozuar që përpara miratimit të tij për zhvillim;

b) garantimi i një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të duke synuar të përcaktojmë kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis nga implementimi i projektit të propozuar .

Projekti ynë që kerkohet klasifikohet në projektet të parashikuara në Ligjin Nr. 10440 , datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar Projektet e Shtojcës II i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Ndikimet mjedisore do të jenë kryesisht të lidhura me fazën e reabilitim/ndertimit (dhe për rrjedhojë për një kohë të shkurtër) dhe projekti do të sjellë një përmirësim të përgjithshëm të cilësive mjedisore . D.m.th ndikimi potencial mjedisor do të jetë minimal dhe i lehtë për tu identifikuar, analizuar dhe për të marrë masa zbutëse ndaj këtij ndikimi në mjedis dhe sipas arsyetimit të mesipër, në këtë raport bëhet fjalë për një vlerësim “përmblendës” të ndikimit mjedisor për reabilitim/ndertimin e kësaj shkolle

Qëllimi është të identifikojë dhe të sigurojë informacion të duhur për publikun dhe institucionet e tjera për pasojat mjedisore të reabilitim/ndertimit dhe rikonstrukcioni i shkolles në kohën e zhvillimit të punimeve për realizimin e këtij projekti .

Brenda këtij qëllimi në hartimin e kësaj VNM-je kemi konsideruar :

- alternativat për vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqëruese
- përmirësimin e plani mjedisor
- përdorimin si duhet dhe në mënyrë eficiente të burimeve
- masat e duhura për zbutjen e ndikimeve të mundshme të propozimit të këtij projekti
- kushtet për ndërtimin duke e realizuar në një kohë sa më të shpejtë

Objekti i këtij raporti është vlerësimi në mënyrën e duhur të efekteve të drejtperdrejta dhe indirekte të këtij projekti sipas klasifikimit :

- Efektet në njëzëri prane dhe afër këtij objekti që kerkohet

- Ndikimet ne toke , uje , klime dhe peisazh te zones
- Ndikimet ne materiale dhe asete kulturore
- Nderveprimet midis ketyre faktoreve qe permendem

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit duke miratuar variantin me te mire , qe ne fazën e fillimit te vendimmarrjes , për te shmangur ndikime te dëmshme kesaj veprimtarie ne mjedis.

Per kete çeshtje te menaxhimit te mbeturinave , ne baze te udhezimit 75/442/CEE i modifikuar nga udhezimi 91/156/CEE , kjo lloj hierarkie aktualizohet ne tre nivele:

1. parandalim;
2. rikuperim;
3. shperberje.

Parimi i parandalimit dhe parimi i masave paraprake i perfshire ne Traktatin e Masatricht-it vendos detyren te zvogeloje emetimin ndotes ne burim pavaresisht nga kostatimi efektiv i nje efekti mjedisor negativ pra dhe ne mungese te provave qe tregojne ekzistencen e nje lidhjeje rastesore midis emetimeve dhe efekteve negative.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis ka si objektiv te percaktoje :

→ Pershkrimin dhe vleresimin e ndikimeve te drejtperdrejta apo te terthorta te mjedisit gjate te gjithë kohes se rehabilitim/ndertimit te ketij objekti .

→ Ndikimet mjedisore ne lidhje me gjendjen e mjedisit ku do te realizohet ky projekt .

→ Propozimin e masave te nevojshme per parandalimin , reduktimin , zbutjen dhe mi nimizimin e ndikimeve negative dhe rritjen e ndikimeve pozitive ne mjedis.

Gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi , përshkrimi dhe vlerësi mi, në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të kesaj veprimtarie punimesh rrugore duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale e trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh dhe lidhjet e tyre të ndërsjella.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, nëpërmjet harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

VNM-ja mendohet si një mënyrë për të ndaluar projekte që kanë ndikime të papranueshme në mjedis por një pikëpamje shumë më pozitive dhe e dobishme është të mendohet për VNM-ne si një mënyrë për të ndihmuar zhvilluesit dhe vendimmarrësit të projektojnë projekte që të kenë ndikim sa më të vogël të mundshëm në mjedis në mënyrë që ata të mund të lejohen të shkojnë përpara dhe të sigurojnë përfitime të tjera që zhvillimi krijon për ekonominë dhe shoqërinë . VNM bën këtë duke identifikuar zbutjen e mjedisit gjatë studimeve vlerësuese.

Ekipi i VNM-së ka bashkepunuar ne menyre te vazhdueshme qe ne faza të hershme te marrjes se detyres se projektimit me ekipin e projektimit dhe do bashkepusoje me zhvilluesin e ketij projekti rehabilitim/ndertimit gjatë gjithë zhvillimit të projektit qe nga studimi , hartimi , perfundimi dhe zbatimi deri ne perfundim te ndertimit për të identifikuar mënyrat nëpërmjet të cilave ato mund të reduktohen dhe qe jane vendosur me pare . Ky eshte një proces i vazhdueshem deri ne perfundim te objektit .

Bashkepunimi eshte realizuar për të vendosur se çfarë është e mundur dhe e përballueshme në kontekstin e zhvillimit të propozuar duke miratuar dhe projektuar variantin me te mire me sa me pak ndikime ne mjedis .

Raporti i VNM-së përshkruan ne vijim te gjitha masat që zhvilluesi është përgatitur të adoptojë dhe ndikimet mbetëse të mbetura pas zbutjes. Masat zbutëse jane paraqitur si angazhime në mënyrë që

autoriteti kompetent të dijë se çfarë mund të marrë parasysh në marrjen e vendimit nëse do të japë pëlqimin.

Parashikimi i ndikimit të ngjarjeve të pazakonshme në VNM-në merret kryesisht me pasiguri që lidhen me ndikimet që janë relativisht të sigurt që të ndodhin dhe ato janë pasojat e operacioneve rutinë të projektit ne serine e llojeve te punimeve qe do realizohen ne zbatim te projektit .

Megjithatë , gjithmonë qëndron një rrezik që një ngjarje e pazakonshme mund të shkaktojë probleme të rënda mjedisore gjatë ciklit të jetës së një projekti duke konsideruar qe kemi punime me mjete te renda , punime te veshtira germimi nen nivelin e siperfaqes se tokes etj qe do pershkruen me poshte dhe gjithmone mund te kemi ndonje te papritur te pakendshme .

Objektivat kryesore kesaj procedure per vleresimin e ndikimit mjedisor mund te permbliiden si me poshte vijon:

- ✓ Sigurimin e plote qe konsideratat mjedisore jane te trajtuara shprehimisht dhe jane te perfshira ne procesin e vendimmarrjes
- ✓ Pershkrimin mbi menyren se si projekti ndikon ne kushtet aktuale mjedisore
- ✓ Eshte marre parasysh shmangia , reduktimi dhe minimizimi i ndikimeve potenciale ne mjedis , edhe aspektet socialo-ekonomike si edhe ato te shendetit te njeriut .
- ✓ Jane dhene sugjerime ne lidhje me masat qe duhet te perfshihen ne projekt per te reduktuar apo neutralizuar ndikimet negative mjedisore apo per te reflektuar ndryshime te tjera te paparashi kuara.
- ✓ Percaktimin e nje programi te pershtatshem monitorimi per te verifikuar qe te zbatohen me efektivitet dhe sukses te plote masat e nevojshme per mbrojtjen e mjedisit .

Me qellim plotesimin e ketyre objektivave dhe sipas referencave te permenduara me siper , ky Raport VNM-je eshte strukturuar ne menyren e meposhtme:

- a) Te dhena mbi zonen aktuale te mjedisit dhe zonat perreth ku zbatohet projekti
- b) Objektivat e projektit
- c) Pershkrim i detajuar i te gjitha instalimeve qe jane pjese e projektit, apo qe do te perdo ren gjate zbatimit te tij
- d) Plani i ndertimit dhe afatet per zbatimin e tij
- e) Pershkrimi i vlerave inxhinierike qe do te ndertohen apo zgjerohen, si edhe pershkrimi i punimeve te nevojshme per zbatimin e projektit
- f) Ndikimet potenciale ne mjedis dhe masat e propozuara per te parandaluar apo per te amortizuar keto ndikime
- g) Program monitorimi te ndikimeve te projektit ne mjedis
- h) Masa rehabilituese ne rast demtimi te mjedisit si edhe kostot e tyre perkatese
- i) Perputhshmeria e projektit me planet e rregullimit te territorit dhe me planin e zhvillimit ekonomik te zones ku do te zbatohet projekti
- j) Permbledhje e konsultimeve me organet e pushtetit vendor, me publikun e gjere dhe organizatat jo-fitimprures, si edhe mendimeve te tyre.

Keto sugjerohen te jene pjese e nje raporti ne rastin e nje "VNM-je permbledhese", siç theksohet ne Ligjin Nr.10440 , date 07.07.2011”Per vleresimin e ndikimit ne mjedis ”, i ndryshuar .

2.1-Legjistacioni i shfrytezuar per hartimin e ketij raporti

Vendi yne eshte antaresuar ne konventat nderkombetare dhe ne kete kuader eshte i detyruar te zbatoje nje rregullshmeri te percaktuar nga keto konventa dhe ne vijim te ligjeve qe kane qene dhe te dala ne vite per ruajtjen e mjedisit pasi eshte burimi i gjithckaje i cili percakton jetesen e njerezve duke siguruar nje mjedis te rregullt dhe nje menazhim te mire te tij .

Prej disa vitesh, Shqipëria është përfshirë në zhvillime të vrrullshme urbane, gjë që është shoqëruar me një faturë jo të vogël në planin mjedisor. Rritja e konsumit, transportit, mbeturinat urbane apo inerte, derdhja e ujërave të zeza në dete e lumenj , prerja pa kriter e pyjeve , gërryerja e shtretërve të lumenjve , djegia e gomave , gërryerja e maleve , ndërtimet e pakontrolluara, etj, janë vetëm disa prej ndikimeve të ndodhura mbi mjedis. Shpesh njeriu nuk e kupton se ajo cfarë e rrethon edhe nëse nuk mund ta shikoj (ajri), ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e jetës. Për rrjedhojë, ai tenton të bëhet indiferent ndaj çështjeve të mjedisit, deri në momentin që natyra reagon ashpër (përmbytje, psh).

Në fakt ndikimi negativ mbi mjedis , është një faturë që të gjitha shtetet po e pa guajnë për zhvillimin. Për këtë arsye shpesh , indikatorët e energjisë , transportit dhe mjedisit trajtohen së bashku pasi është pothuajse e pamundur që të mos ndikojnë te njëri-tjetri. Megjithatë shtetet e zhvilluara kanë marrë angazhime serioze dhe po mundohen të japin shembullin e mirë se jo gjithmonë zhvillimi në përgjithësi dhe ai i industrisë në vecanti ecën paralel me ndotjen e mjedisit . Nënshkrimi i Protokolleve të tilla si ai i *Kyoto-s* për uljen e emëtimit të gazrave , tregojnë se shtetet e kanë rritur ndjeshëm vëmendjen e tyre ndaj mjedisit, pasi kjo lidhet drejtpërsëdrejti me cilësinë e jetës së qytetarëve të tyre.

Akoma më i rëndësishëm është *Protokolli i Gothenburg-ut* i cili përcakton tavanet për emëtimin e katër ndotësve më të rrezikshëm të ajrit që krijojnë shirat acide.

Ndoshta Shqipëria nuk është ndër vendet më të ndotura në botë por duhen marrë urgjentisht masa për ndërprerjen e masakrës mjedisore dhe paralel me të hapa konkret për përmirësimin e situatës.

Në studimin e saj ODA konstatoi se Shqipëria nuk vuan për strategji , plan masash apo përcaktim objektivash në letër .

Kështu , aktualisht , Shqipëria ka:

- » Nënshkruar 7 Konventa Ndërkombëtare për çështje të ndryshme mjedisore;
- » Hartuar 7 Strategji Zhvillimi për disa aspekte mjedisore;
- » Ka mbi 23 ligje për mbrojtje të mjedisit, biodiversitetit, florës e faunës, etj;
- » Ka mbi 20 ligje për ratifikime e aderime nëpër Protokolle Ndërkombëtare, Marrëveshje, Amendamente, etj;
- » Mbi 20 rishikime e shtesa të legjislacionit të mëparshëm;
- » Mbi 80 VKM që lidhen drejtpërsëdrejti me mjedisin;
- » 20 udhëzime dhe mbi 5 rregullore, etj.

I domosdoshëm është zbatimi i ligjeve dhe zotimeve të nënshkruara dhe akoma më tej vullneti për të cuar deri në fund nismat që ndërmerren për mbrojtjen e mjedist. Megjithatë , edhe në hartimin e strategjive dhe përfshirjen e hapave për zbatimin e tyre ka ende shumë punë për t’u bërë, në mënyrë që të reflektohen të gjitha problemet që po has sot mjedisi në vend.

Për realizimin e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të veprimtarisë së propozuar u konsultuan dokumente mjedisore që lidhen me politikat shtetërore të mbrojtjes së mjedisit , zonës në të cilën kerkon te realizohet kjo nderhyerje rikonstrukcioni .

Shqipëria, pas viteve '90, është bërë palë në një sërë konventash ndërkombëtare edhe në fushën e mbrojtjes së mjedisit, që janë marrëveshje mjedisore ndërshtetërore me mjaft vende të botës , lidhur me ndryshimet klimatike , mbrojtjen e biodiversitetit , luftën kundër shkretëtirizimit të tokave , për llojet migratore , për specie , faunën , kimikatet, si dhe një sërë çështjesh të tjera mjedisore të përbashkëta në shkallë rajonale dhe ndërkombëtare . Qeveria shqiptare gjate viteve te fundit ka nxjerre mjaft ligje dhe udhezime per mjedisin te cilat jane ne perputhje te plote edhe me konventat nderkombe tare si :

- Konventa e Finlandes ”Per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne konteksin nderkufi tar” Espoo e dt.25.02.1991

- Konventa e Gjeneves “Per ndotjen atmosferike” e dt.13.11.1979
 - Konventa e Bernes “Per ruajtjen e flores dhe Faunes “ e dt.19.09.1979 e ratifikuar me Ligjin Nr.8294, date 02.03.1998
 - Konventa per “Mbrotjtjen e mjedisit detar dhe te zones detare te detit Mesdhe si dhe gjashte protokolleve shoqeruese “ pershtatur ne Barcelone me 16.02.1976 , me 10.06.1995 nga Konferenca e shumefuqishmeve “Per mbrotjtjen e detit Mesdhe nga ndotjet” e ratifikuar me ligjin Nr.8690 , date 16.11.2000
 - Konventa e Rios “Mbi larmine biologjike “ , ne Rio de Zhaniero me 15.06.1992 e ratifikuar me Ligjin Nr.9279 , date 23.09.2004 ,
 - Ligji per aderimin e Shqipërisë në protokollin “Për përgatitjen , reagimin dhe bashkëpunimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme (OPRC – HNS), 2000” shpallur me dekretin Nr.7990 , date 15.10.2012 .
- Konventa per "diversitetin biologjik", qe perfaqeson nje marreveshje midis vendeve te ndryshme per ruajtjen e biodiversitetit, per perdorimin e qendrueshem te burimeve gjenetike dhe per transferimin e teknologjive perkatese me financimet perkatese. Shqiperia e firmosi kete konvente ne date 5 janar 1994. Konventa hyri ne fuqi me date 5 prill 1994.
- Me date 29 nentor 1995, Shqiperia u anetaresua ne "Konventen e Ramsarit" (Ramsar, 1971), e njohur gjithashtu si "Konventa per ligatinat me rendesi nderkombetare, ne vecanti per shpendet e ujit". Shqiperia u be anetare e kesaj konvente duke e ratifikuar ate me date 29 mars 1996.
 - Me date 31 tetor 1995 Shqiperia nenshkroi Konventen e Bernes per Mbrotjtjen e Flores dhe Faunes se Jetes se Eger te mjedisit natyror ne Evrope" (Berne, 19 shtator 1979). Shqiperia u be anetare e kesaj konvente permes ratifikimit te saj me date 2 mars 1998.
 - Konventa e Aarhus-it "Ne lidhje me aksesin ne informacion, pjesemarrjen e publikut ne vendim-marrje dhe aksesin ne sistemin e drejtesise ne ceshtje mjedisore" (Danimarke, 25 qershor 1998). Konventa perfaqeson nje instrument te rendesishem per forcimin dhe harmonizimin e te drejtave mjedisore te qytetareve duke u dhene atyre me shume mundesi per te qene te informuar per pjesemarrje publike dhe per drejtesi ne Evrope. Shqiperia ishte nder 35 vendet anetare qe nenshkruan kete konvente.
 - Konventa per "Luften kunder shkretetirizimit", me qellim luftimin e ketij fenomeni ne vendet qe vuajne prej tij (4 dhjetor 1996). Aneksi 4 trajton problemin e shkretetirizimit ne vendet mesdhetare. Pjesemarrja e Shqiperise u miratua ne vitin 1999.
 - Konventa "Per Mbrotjtjen e Shtreses se Ozonit", qe njihet si Konventa e Vienes (1985) e ratifikuar ne 8 tetor 1999.

Që prej krijimit më 1974, Komiteti i mbrotjtjes së ambientit detar (MEPC = KMAD) ka studiuar dispozita të ndryshme të MARPOL 73/78 që kërkonin sqarime ose që zbatimi i të cilave nxirrte probleme. Me qëllim që të hiqeshin paqartësitë dhe të zgjidheshin problemet në mënyrë uniforme, MEPC vendosi se ishte e dëshirueshme të zbatoheshin interpretime uniforme të MARPOL 73/78 dhe ka pranuar se, në një farë mënyre, duheshin ndryshuar disa prej rregullave ose të parashikoheshin të reja me qëllim që të reduktohej akoma më shumë ndotja që lidhej me përdorimin e anijeve dhe të asaj të shkaktuar aksidentalisht nga anijet. Këto masa të marra nga MEPC kanë çuar në hartimin e një numri interpretimesh uniforme të Konventës dhe amendamentesh.

Ky botim ka për objekt të lehtësojë konsultimin e dispozitave dhe interpretimeve uniforme të përditësuara të artikujve, Protokolleve dhe të pesë Anekseve të MARPOL 73/78. Ajo përfshin të gjitha amendamentet e vitit 2000 (siç janë miratuar nga rezoluta MEPC.89(45). Sekretaria do të saktësojë se nuk ka për qëllim të sjellë modifikime formale, as modifikime të tjera, të teksteve të besueshme. Për qëllime juridike, duhen konsultuar

tekstet e MARPOL 73/78 të besueshme.

Megjithatë, do te gjejmë në këtë botim amendamentet e rregullit 13G të Aneksit i dhe te suplementit të Certifikatës IOPP (siç janë miratuar më 11 maj 2001 nga rezoluta MEPC.95(46). Këto amendamente të rëndësishme do të hyjnë në fuqi më 1 shtator 2002 ne qofte se ato pranohen ne datën e pranimit te heshtur te fiksuar ne 1 mars 2002. Në datën e publikimit të këtij botimi përmbledhës, kushtet e hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve nuk ishin plotësuar akoma. Megjithatë u mendua se këto amendamente mund të hynin në fuqi para rishikimit të ardhshëm të këtij botimi përmbledhës dhe për këtë arsye, teksti i rezolutës MEPC.95(46) është riprodhuar në seksionin e titulluar "Informacione shtese" (rubrika 7). Një tekst i bashkangjitur (Sistem vlerësimi i gjendjes së anijes) i miratuar nga rezoluta MEPC.95(46) figuron në të njëjtin seksion (rubrika 8).

Permbajtja eshte shume e ngjashme me ate qe kerkohet nga dispozitat e BERZH-it, ne Aneksin 4 te "Procedurave Mjedisore" dhe nga BEI, qe ndjek direktivat perkatese evropiane (direktiva 85/337/e Keshillit te Evropes, ndryshuar me ane te direktives 97/11/ te Keshillit te Evropes).

BERZH-i jep me shume detaje per çdo pike ne veçanti dhe kjo eshte ne veçanti e vertete per pershkrimin e aspekteve mjedisore dhe te kushteve shoqeroro-ekonomike qe mund te ndikohen nga projekti. Nder to permendim: klimen , gjeomorfologjine dhe gjeologjine , burimet ujore , burimet biologjike dhe ekologjike, ndikimin ne panorame dhe ate vizual, ne cilesine e ajrit, zhurmat dhe perdorimin e tokes.

Persa i takon perkufizimit te ndikimeve potenciale kemi keto perkufizime:

→ Ndikim mesatar i pranueshem: ndikim negativ ne mjedis qe mund te pakesohet .Ky nuk eshte nje ndikim qe akumulohet dhe nuk shkakton deme mjedisore qe perhapen.

→ Ndikim thelbesor : ndikim ne mjedis qe nuk mund te pakesohet me aq lehtesi. Ky ndikim akumulohet dhe shkakton deme qe perhapen ne mjedis.

→ Ndikim jo i drejtperdrejte : eshte ndikimi i akumuluar me pare apo qe eshte zhvendosur ne distance dhe te mund te parashikohet.

Serish edhe per kete rast legjislacioni shqiptar eshte i ngjashem me dispozitat e BERZH- it, ne veçanti per mundesine e ndikimeve kumulative.

Pervec sa me siper, BERZH-i thekson rendesine e pershkrimit te ndikimeve si pozitive, ashtu edhe negative (persa i takon shkalles, rendesise, perseritjes, kthimit, mases dhe kohezgjatjes), si edhe rendesine e shkalles se ndikimeve (ne eshte ky nje ndikim ne nivel lokal, rajonal, kombetar apo nderko mbetar).

Përgatitja e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të aktivitetit të propozuar është kryer duke u bazuar në aktet ligjorë të mëposhtëm:

- ☞ Ligji Nr. 8094 datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”
- ☞ Ligji Nr.8756 dt.26.03.2001 “Per emergjencat civile”
- ☞ Ligji Nr.8766 dt.05.04.2001 i azhornuar “Per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin “
- ☞ Ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit në lidhje me dokume ntet zyrtare”
- ☞ Ligjin Nr.9010, datë 13.2.2003 “Mbi trajtimin e mbetjeve të ngurta”,
- ☞ Ligji Nr.9774 , dt.12.07.2007 “Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis” ,
- ☞ Ligji Nr.8906 , dt.06.06.2002 “Per zonat e mbrojtura”
- ☞ Ligjin Nr.10 , dt.18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune “
- ☞ Rregullore Nr.1 dt.30.03.2007 “Per trajtimin e mbetjeve te ndertimit , nga krijimi , transportimi deri ne asgjesimine tyre “
- ☞ Udhzues Metodik per “Pregatitjen e Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”

- ☞ V.K.M Nr.994 , date 02.07.2008 “Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimarrje per mjedisin”
- ☞ Vendimin KM Nr.175 , dt.19.01.2011 “ Per miratimin e strategjise kombetare te menazhimit te mbetjeve ...”,
- ☞ Vendim KM Nr.123 , dt.17.02.2011, “Per miratimin e planit kombetar te veprimit per menaxhimin e zhurmave ne mjedis “
- ☞ Vendimin KM Nr.805 , dt.04.12.2003 “Per miratimin e listes se veprimtarive me ndikim ne mjesis “
- ☞ Vendimin KM Nr.103, dt.31.07.2002 “Per monitorimin e mjedisit ne RSH”
- ☞ Udhëzuesi Nr.6, datë 27.11.2007 “Mbi miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për hartimin e planeve për administrimin e mbetjeve të ngurta”
- ☞ Udhëzim nr.6 datë 27.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie”
- ☞ Vendimin KM Nr.99 , dt.18.02.2005 “ Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve “
- ☞ Udhëzim nr. 2 datë 21.05.2007 “Për miratimin e listës së aktiviteteve me ndikim në mjedis, mënyrën e aplikimit dhe rregullat e procedurat e dhënies së autorizimit dhe pëlqimit mjedisor nga Agjensitë Rajonale të Mjedisit”
- ☞ Udhëzimin Nr.8 , dt.27.11.2007 “ Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara
- ☞ Udhëzimin Nr.1037/1, dt.12.04.2011 “Per vleresimin dhe menaxhimin e zhurmes mjedisore ”
- ☞ Vendimin KM Nr.123 , dt.17.02.2011 “Per miratimin e planit kombetar per menaxhimin e zhurmave ne mjedis”
- ☞ Udhëzimin Nr.1037/1, dt.12.04.2011 “Per vleresimin dhe menaxhimin e zhurmes mjedisore ”
- ☞ Vendimin KM Nr.123 , dt.17.02.2011 “Per miratimin e planit kombetar per menaxhimin e zhurmave ne mjedis” ,
- ☞ Ligjit Nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- ☞ Ligjit Nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar
- ☞ Ligjit Nr. 10 440 , date 07.07.2011” Per vleresimin e ndikimit ne mjedis “
- ☞ Ligjit nr. 10 448 , date 14.07.2011 “Per lejet mjedisore “
- ☞ V.K.M Nr.13 , date 04.01.2013 “ Per miratimin e rregullave , te pergjegjesive te afateve per zhvillimin e procedures te vleresimit te ndikimit ne mjedis “
- ☞ V.K.M Nr.419 , date 25.06.2014 “ Per miratimin e kerkesave per leje , transferim te lejeve , rregullat per shqyrtimin e lejeve “
- ☞ V.K.M Nr.912 , date 11.11.2015 “Per miratimin e metodologjise kombetare per hartimin e raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis “
- ☞ V.K.M Nr.352 , date 29.04.2015 “Per vleresimin e cilesise se ajrit dhe kerkesat per disa ndotes ne lidhje me te “
- ☞ Ligji nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar qe trajton në mënyrë të veçantë çështje si:
 - (i) caktimin e rolit të organeve të pushtetit vendor (MB);
 - (ii) rregullat për shoqëritë e transportit;
 - (iii) poçedurat që zbatohen mbi firmat e transportit rrugor për hyrjen në treg;
 - (iv) transporti i mallrave të rrezikshme. Është bërë përafrimi i këtij ligji me direktivën e KE 96/26 me miratimin e ndryshimeve të tij me ligjin nr. 9760, datë 21.6.2007.

☞ Ligji nr.9808, date 24.9.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" (për peshat dhe dimensionet, kapacitetin transportues të mjeteve, etj), i cili hap rrugë hartimit të akteve të tjera ligjore sipas Direktivave dhe Rregulloreve të KE-së.

☞ VKM nr. 325, datë 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, i përputhur pjesërisht me Direktivën nr. 96/26/KE përcakton kriteret cilësore që duhet të plotësohen për pranimin në veprimtarinë e transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve për operatorët e transportit rrugor, si për tregun e brendshëm, ashtu edhe për tregun ndërkombëtar.

2.2 -Pershkrim te metodikes per hartimin e ketij raporti

Zbatimi i legjistacionit shqiptar ne menyre qe te sigurojme nje nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit permes parandalimit , kompensimit te demeve ne mjedis , garantimin e nje vendimmarrje te hapur , te gjere duke u konsultuar me hartuesit e projektit te ndertimit , me stafin inxhinierik dhe me gjere me specialiste te fushes perkatese vendas por edhe me konsulence nga eksperte te jashtem , per te cilin kerkohet te realizohet ky projekt reabilitimi/ndertimi te shkollave ne qytetin e Fushe Krujes permbush ne te gjitha anet si interesa shume-paleshe dhe nga pikepamje mjedisore dhe shteterore .

Gjate hartimit te ketij raporti eshte konsideruar :

- Gjendja e mjedisit egzistues te zones se shkollave.
- Ndikimet ne mjedis gjate fazes se ndertimit te objektit
- Ndikimet ne mjedis dhe menyren e zbutjes se tyre
- Harmonizimi dhe lidhja e kesaj veprimtarie me te gjitha masat e nevojshme per minimizimin e demeve mjedisore
- Infrastruktura e nevojshme per ndertim dhe me pas per funksionim
- Perputhja e ketij projekti me planin e pergjithshem vendor.

VNM-ja ka lejuar dhe ndihmuar ne hartimin e ketij projekti pasi nuk ka ndikime të papra nueshme në mjedis dhe ka sherbyer si orientim për të ndihmuar zhvilluesit dhe vendimmarrësit të hartojë projektin e ndertimit me nje ndikim sa më të vogël të mundshëm në mjedis duke identifikuar zbutjen e mjedisit gjatë studimeve vlerësuese.

Eshte arritur qe hartuesi të identifikojë ndikimet e rëndësishme mbi mjedisin dhe eshte bashkepunuar me zhvilluesin për të identifikuar mënyrat nëpërmjet të cilave ato mund të reduktohen . Ky eshte realizuar një proces i përsëritur që ka filluar në faza të hershme dhe të vazhdojë gjatë gjithë zhvillimit të projektit .

Zakonisht nuk është e mundur të zbutet çdo ndikim i një projekti , por puna e ekipit të VNM-së është që të punojë me zhvilluesin e projektit për të vendosur se çfarë është e mundur dhe e përba llueshme në kontekstin e zhvillimit të propozuar.

Sapo eshte kryer vlerësimi i ndikimeve mbetëse dhe raporti i VNM - së përshkruan masat që zhvilluesi është përgatitur të adoptojë dhe ndikimet mbetëse të mbetura pas zbutjes .

Masat zbutëse paraqiten si angazhime në mënyrë që autoriteti kompetent të dijë se çfarë mund të marrë parasysh në marrjen e vendimit nëse do të japë pëlqimin .

2.2.1 –Vlerësimi i rrezikut në hartimin e këtij raporti

Parashikimi i ndikimit të ngjarjeve të pazakonshme në VNM-në merret kryesisht me pasiguritë që lidhen me ndikimet që janë relativisht të sigurt që të ndodhin pasi ato janë pasojat e operacioneve rutinë të projektit.

Megjithatë, gjithmonë qëndron një rrezik që një ngjarje e pazakonshme mund të shkaktojë probleme të rënda mjedisore gjatë ciklit të zbatimit të këtij projekti . Identifikimi i rreziqeve kërkon ekzaminimin sistematik të të gjithë elementeve në hartimin e projektit dhe ndërveprimeve të tyre me njerëzit dhe mjedisin për të përcaktuar se sa dëme (për shëndetin ose për mjedisin) mund të lindin.

Vlerësimi i rrezikut (VR) është metoda shkencore e përcaktimit të pasigurisë në lidhje me ngjarjet e ardhshme të këtij lloji. Teknikat mund të jenë ose cilësore ose sasiore. Teknikat cilësore janë përdorur zakonisht për të vlerësuar sisteme të thjeshta ku pasojat e ngjarjeve janë më pak të rënda. Vlerësimi sasior i rrezikut është përdorur për sistemet më komplekse dhe për rreziqet që mund të çojnë në konsekuencë të rënda si vdekja e njerëzve (viktima). Vlerësimet duhet të fillojë në një nivel të thjeshtë dhe mund të bëhen më të sofistikuar, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të rrezikut dhe nevojat e vendimmarrësit në menaxhimin e riskut kjo është e njohur si një “qasje e niveluar” (*tiered approach*). Duke përdorur një “qasje nivelesh” duhet të sigurohet që burimet e aplikuara për vlerësimin e rrezikut të jenë proporcionale me rrezikun.

Një numër aktiviteteve esenciale janë të përfshirë në vlerësimin e rrezikut. Këto ndahen në pesë hapa kryesorë:

- Identifikimi i rrezikut;
- Analiza e rrezikut;
- Analiza e pasojave;
- Përcaktimi i rrezikut,
- Vlerësimi dhe masat zbutëse.

Identifikimi i rrezikut përfshin identifikimin e materialeve të rrezikshme ose ndonjë ngjarje të rrezikshme që mund të lidhet me projektin. Një konsekuencë e përbashkët në krijimin e rreziqeve të mundshme është që të administrohen rreziqet dytësore që mund të lindin. Është e rëndësishme që gama e plotë e rreziqeve të mundshme të identifikohet që në fillim, edhe nëse është për të sqaruar se pse disa rreziqe të mundshme janë hedhur poshtë si të tilla dhe që nuk kërkojnë vlerësim të mëtejshëm.

Ne kete projekt , gjate realizimit te tij qofte te ndertimit te nje pjese te re aksi apo reabilitim / ndertim te aksit egzistues kemi rrezik nga mosfunksionimi i pajisjeve qe do te perdoren gjate te gjithe kohes se ndertimit deri ne perfundim te tyre dhe konkretisht duhet bere kujdes nga :

- Funkcionimi i mjeteve te renda dhe germuese ne momentin e fillimit te punimeve dhe gjate te gjithe kohes deri ne perfundim te objektit pasi mund te shkaktohet ndonje aksident i mundshem .
- Mjetet e renda , eskavatore , vinca , fadroma duhet te mos punojne panderprerje dhe njekohesisht ne menyre qe te mos ngrene lart dhe ne menyre te dendur pluhurin qe del nga punimet e ndertimit dhe te mos perhapet ne ambjentin perreth pasi eshte shesh i hapur , ne rruge kryesore dhe brenda qendres se banuar nga shume banore . Njekohesisht evitim e prodhimit te zhurmave mbi ato te lejuarat pasi te gjitha punimet do behen kryesisht brenda zones se banuar .
- Mosndotja e ambjentit nga materialet qe do dalin nga punimet e germimit dhe nga dhererat qe dalin te cilat nuk do perdoren me ne objekt si dhe kujdesi i duhur gjate evadimit te tyre ne vendin e caktuar me pare ose per riperdorim me autorizim dhe vendim vetem nga supervizori i punimeve dhe nga institucioni .

- Funksionimi i mire , shume rigoroz dhe brenda kushteve teknike i sheshit te ndertimit si dhe kantjerit te punes nga sipërmarresi qe ne momentin e fillimit te punimeve ne menyre qe te evito het ndonje aksident i mundshem .
- Kujdesi te mjetet auto si fadrome , eskavator , kamionet e te gjitha tonazheve qe do sjellin materiale si dhe te gjitha mjetet e tjera motorrike qe punojne edhe vetem nje seksion kohor te perca ktuar dhe kufizuar per mosderdhje te karburanti apo vajrave ne shesh qe sjellin ndotje mjedisore

Një rrezik mund të përkufizohet si një situatë që në rrethana të caktuara mund të sjellë dëmtime ose të dëmtuar. Niveli i rrezikut llogaritet duke kombinuar probabilitetin ose frekuencën e shfaqjes së një rreziku të përcaktuar dhe madhësinë e pasojave që mund të ndodhin.

Përderisa ligji në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, nuk i referohet në mënyrë eksplicite rrezikut si pjesë e fushës së VNM-së është praktikë e mirë për raportin mjedisor të përshkruaje rreziqet mjedisore dhe shëndetësore që rrjedhin nga projektet ku këto janë të rëndësishme.

2.2.2 –Analiza e rrezikut

Ky është vlerësimi i frekuencës ose i probabilitetit të të ndodhurit të ndonjë incidenti të rrezik shëm që mund të shkaktojë dëm për kete lloj projekti dhe me pas gjate zhvilli mit për ndertimin e tij . Kjo përfshin:

- specifikimin e sekuencës së ngjarjeve që mund të çojnë në të ndodhurin e incidentit të rrezikshëm nga defekti ose analizës se pemës/historisë së ngjarjes;
- kuantifikimin e gjasës së incidentit.

“Analiza e pemës/historisë së defektit, shkakut” fillon me incidentin që shkakton efekti mbi njerëzit e mjedisin (p.sh., zjarr ose derdhje/rrjedhje lengjesh ndotese , shkarje apo rreshqitje makinerie gjate punimeve te ndryshme te germimit) dhe të rikthehet përmes dështimeve apo ngjarjeve që mund të kenë çuar në këtë pikë. “Analiza e pemës/historisë së ngjarjes” shtrihet nga fillimi i ngjarjes deri në incidentet që mund të dëmtojnë njerëzit dhe mjedisin. Të dyja mund të përdoren për të siguruar një paraqitje grafike të marrëdhënieve ndërmjet ngjarjeve të veçanta dhe incidenteve të padëshiruara përfundimtare (nganjëherë referuar si “ngjarje kryesore”).

Studimet e rrezikut dhe operacionalitetit(HazOps)“*Hazard and Operability Studies*” është qasje e veçantë për analizën e pemës/historisë së ngjarjes e përdorur shpesh në studimet e instalimeve me rrezikshmëri të lartë. Qasja HazOps është që të shqyrtojë segme nte të vogla të procesit ose operimit në një mënyrë sistematike për të identifikuar të gjithë skenarët e mundshëm të aksidenteve. Informata të hollësishme të projektimit, karakteri stikat operative dhe të dhënat historike mbi frekuencat e dështimit nga furnitori ose pajisje të ngjashme janë përdorur për të kryer analiza. Pasi janë identifikuar fillesat e ngjarjeve të ndryshme, historitë e ngjarjeve janë gjurmuar përmes incidenteve të rrezikshme që prekin njerëzit apo mjedisin dhe probabiliteti që të ndodhin të përcaktohet, nëse është e mundur. Burimi i çdo të dhëne të përdorur në llogaritjet duhet të referohet për të siguruar një tregues besueshmërie.

Analiza e pasojës në proces përfshin parashikimin e pasojave për njerëzit dhe mjedisin që mund të lindin nga një rrezik i dhënë. Ajo mund të ndahet në tri faza kryesore, si më poshtë:

- përcaktimi i pasojave ose ndikimeve të mundshme të rrezikut, duke përfshirë sekuencën e ngjarjeve nga incidentet e rrezikshme deri në ndikimi;
- parashikimin e përmasave të pasojave të mundshme;
- vlerësimin e probabilitetit të ndodhjes së pasojës.

2.2.3 –Egzaminimi i ndikimeve dhe parashikimi i pasojave

Ekzaminimi i ndikimeve/pasojave

Është e rëndësishme që gama e plotë e pasojave të mundshme është konsideruar në këtë fazë. Disa pasoja janë të lidhura qartë me rrezikun e veçantë që analizohet të tilla si ndikimet shëndetësore të njeriu nga shkarkimet e ujrave të larjes të perziera me elemente të papranueshem si vajra , lubrifikante etj. në kanalet e ujërave.

Shqyrtimi i sekuencës së ngjarjeve nga incidenti i rrezikshëm deri të ndikimi do të ndryshojnë në kompleks, në varësi të natyrës së rrezikut të konsideruar. Është e papra nueshme në rastin e projektit tone të lihen në shesh apo hapen përreth tij të mbetjeve të çfaredollojshme dhe natyre .

Parashikimi i përmasave të pasojave

Parashikimi i përmasave të pasojave do të ndryshojë në varësi të kompleksitetit të ngjarjes së rrezikshme në vlerësim. Disa karakteristika kyçe duhet të konsiderohen në këtë fazë:

- Shkalla hapësinore e pasojave e dëmit që rezulton nga një ndikim mjedisor shpesh do të shtrihet në mënyrë të konsiderueshme përtej kufijve të burimit të rrezikut . E rëndësishme është që vlerësimi i rrezikut të mos jetë shumë i kufizuar në këtë drejtim.

- Shkalla e përkohshme e pasojave. Është e rëndësishme për t’u marrë parasysh kohëzgjatja e një ndikimi se si mund të shkaktojë dëme që do të zgjasin gjatë në të ardhmen. Për shembull, pasojat e mundshme të një derdhjeje të madhe të naftës që prek plazhet mund të kenë ndikime afatgjata në industrinë e turizmit në zonë; një derdhje e një solventi në tokë të depërtueshme mund të rezultojë në një ndikim në shtresat ujëmbajtëse për shumë vjet më vonë.

Për vlerësime sasiore/kuantitative, modelimi i fuqishëm dhe afatgjatë, duke përdorur mjete të ngjashme me ato të përdorura në parashikimin e ndikimit konvencional, mund të përdoret për të parashikuar dhe përcaktuar shkallën kohore dhe shtrirjen e ndikimit mjedisor.

Vlerësimi i probabilitetit të pasojave

Qëllimi i këtij hapi është që të vlerësojë mundësinë e pasojave dhe përbëhet nga tre komponentë:

- probabilitetin e të ndodhurit të incidentit të rrezikshëm,
- probabilitetin e receptorëve të ekspozuar ndaj rrezikut dhe
- probabilitetin e dëmit që rezulton nga ekspozimi ndaj rrezikut.

Varur nga rrethanat e incidentit të rrezikshëm, caktimi i probabiliteteve mund të jetë relativisht i drejtpërdrejtë ose mund të kërkojë një qasje më të sofistikuar.

Pasiguria

Kjo pjesë diskuton rëndësinë e shqyrtimit të pasigurisë në VNM. Pasiguria është e rëndësishme pasi mund të ndikojë cilësinë e informacionit disponibël në vendimmarrje. Ka dy mënyra kryesore në të cilat pasiguria është relevante në VNM:

- *Pasiguria në parashikimin e ndikimeve.* Parashikimet, nga natyra janë të pasigurta pasi kanë të bëjnë me të ardhmen. Pasiguria është e lidhur kryesisht me mungesën e dijeve se si do të sillen në të ardhmen projekti dhe mjedisi. Për shembull, efekti i shkarkimeve të projektit në cilësinë e ajrit do të varet në mënyrë vendimtare nga pozicioni i saktë, forca e shkarkimit, temperatura dhe përbërja e shkarkimeve, si dhe kushtet e ardhme të motit dhe të gjitha këto janë të paqarta. Por pasiguria/paqartësia mund të rritet edhe sepse dija jonë rreth mjedisit bazë bazohet vetëm në mostrat/modelet, si dhe metodat që përdoren për të parashikuar ndikimet (modelet etj.) janë gjithmonë thjeshtime të atyre që ndodhin në botë. Gjithashtu, mund të ketë gabime në të dhëna dhe në aplikimin e metodave por me shpresë që këto mund të shmangen me ndihmën e kontrolleve të kujdesshme dhe të detajuara.

- Pasiguri rreth ekzistencës së “ngjarje të jashtëzakonshme” gjatë zbatimit të projekt
- Rreziqe të paparashikuara që rrezikojnë jetën e njerëzve dhe mjedisin

- Nga keqfunksionimi i makinave , mjeteve dhe pajisjeve që marrin pjesë në projekt dhe shkaktojnë aksidente si zjarr, shpërthime dhe rrjedhje të ndryshme ose rreshqitje .

Procesi i parashikimit përbëhet nga një numër fazash, përfshirë vendimin se si të përshkruash ndikimet, mbledhjen e të dhënave lidhur me projektin dhe mjedisin, dhe selektimin dhe aplikimin e metodës së parashikimit. Pasiguria mund të shfaqet te secila nga këto faza.

Ka një sërë kriteresh për marrjen e vendimit se si të përshkruhet një ndikim. Këto përfshijnë:

-natyrën e ndikimit në vetvete, p.sh., vendndodhjen dhe shtrirjen, kohën dhe karakteristika të tjera të lidhura me të;

-llojin e standardeve kundrejt të cilëve do të vlerësohen parashikimet;

-aftësia dhe mundësia e metodave për të bërë lloje të ndryshme parashikimesh (mesatare /amplituda maksimale, afatshkurtra/gjata, afër/larg etj.)

Vendimi për përshkrimin e ndikimit duke përdorur një masë se sa atë që mund të çojë në një përfundim të ndryshëm rreth ndikimit.Falë kësaj, do të ketë gjithmonë një shkallë pasigurie nëse mënyra se si është përshkruar një ndikim, ka ndikuar në vendimin rreth rëndësisë së tij.

Do të ketë gjithmonë pasiguri në të dhënat që duhen për të bërë parashikimet. Këto mund të jenë të dhëna rreth vetë aktivitetit : se pari ,

☞ sa mbetje do të depozitohen në një vendndodhje të propozuar ? Nisur që ne rastin tone do kemi mbetje :

→ nga punimet e prishjes se siperfaqeve egzistuese te cilat duhet te ndahen vecmas mbetjet e betoneve , mbetjet metalike dhe mbetjet e tjera .

→ nga punimet e germimit per zbatimin e projektit sipas specifikimeve dhe parashikimeve te bera ne te per realizimin e ketij objekti .

→ mbetjet qe dalin gjate punimeve te ndertimit dhe qe nuk perdoren me tej .

☞ Cila është përbërja e tyre kimike ? Meqë kemi të bëjmë me rikonstruktion dhe shtese ambjent shkolle duhet mbikeqyerje e vazhdueshme sepse mund të perballemi me situata jo te kendshme .

Mund të lidhet edhe me mjedisin bazë që ndikohet: sa është popullata lokale e specieve të ndikuara. Cilin proporcion të popullatës kombëtare rajonale përfshin? Çfarë kanalesh bëjnë të mundur shpërhapjen e ndotësve? Cilat janë kushtet lokale të shpërhapjes në ajër, tokë dhe ujë? Sa njerëz jetojnë në vendndodhjen e projektit?

Të dhënat janë subjekt i dy lloj pasigurish:

- Pasaktësia në matje dhe zgjedhjen e mostrave – saktësia e instrumenteve, teknika dhe përdoruesi si dhe frekuenca e matjeve shkalla e modelit të zgjedhur;

- Ndryshueshmëria natyrale dhe e pashmangshme në mjedis , p.sh., kushtet mesatare të motit do të ndryshojnë gjatë një viti dhe ndër vite; nivelet e prurjes së lumit lagështia e tokës ndryshojnë në kohë, po ashtu popullimet dhe riprodhimi i specieve; përbërja e ndryshme gjenetike e individëve në një popullim mikroorganizmash do të rezultojë në një ndryshueshmëri të reagimit të tyre ndaj ndotjes së tokës.

Të gjitha metodat parashikuese, kur përdorin modele shkencore ose gjykime ekspertësh, përfshijnë disa modele të mjedisit: matematike, fizike, eksperimentale ose konceptuale (verbale/mendore). Pasiguritë ndodhin sepse asnjë nga këto modele nuk mund të parashikojë se çfarë do të ndodhë në mjedisin e vërtetë. Modeli është vetëm një përafërsi e botës reale dhe përfundimet nuk mund të japin një përshkrim të saktë dhe preciz të asaj që mund të ndodhë.

Ku është e mundur, supozimet në bazë të parashikimit të ndikimeve, dhe besueshmëria në parashikim duhet të specifikohet qartë. Aty ku është një nivel i konsiderueshëm i pasigurisë, parashikimet duhet të shprehen gjithmonë si shkallë ose cilësore (p.sh., nga më i ulëti të më i larti dhe

vlerat më të mundshme) ose statistikisht (p.sh., 95% limitit/nivelit të besueshmërisë). Për shembull, analizat statistike mund të tregojnë që 95% e intervalit të besueshmërisë për zhurmat lidhur me një projekt industrial të jenë 65-70dBA. Kjo do të thotë se ka një probabilitet rreth 95% që zhurmat aktuale të jenë brenda këtyre normave. Ka disa metoda të ndryshme statistike që mund të përcaktojnë nivelin e pasigurisë në parashikime dhe është e përshtatshme të përdoren këto atje ku ka pasiguri të konsiderueshme.

Analiza e Monte Karlos është një teknikë simuluese kompjuterike që mund të aplikohet në çdo sistem që përdor variabël të pasigurt. Simulimi heton pasojat e këtyre pasigurive në produktin final duke përdorur analizën e probabiliteteve duke ndryshuar çdo variabël në pajtim me shpërndarjen e kufijtë e pasigurisë së tyre.

Pasiguria mund të reduktohet duke përmirësuar cilësinë e të dhënave të futura, duke rritur numrin e kampioneve të studiuar, duke përdorur metoda matëse më të përshtatshme, ose duke përdorur metoda parashikimi si një model më të sofistikuar. Është e rëndësishme, sidoqoftë, të mos mbledhen më shumë të dhëna ose të përdoren metoda që janë më efektive se ç’është për të bërë një parashikim adekuat. Parashikimi “Adekuat” është i tillë që lejon që vlerësimi gjykues të bëhet në lidhje me rëndësinë që ka dhe i jep vendim-marrësit dhe aktorëve të tjerë informacion të mjaftueshëm për të bërë gjykimet e tyre. Një sasi e madhe kohe dhe parashpesh shpërdorohet në VNM, për të mbledhur sasi të mëdha të të dhënave dhe duke përdorur mjete shumë të sofistikuar, kur një metodë më e thjeshtë dhe një përshkrim përsëri i thjeshtë i ndikimeve mund të jetë shumë më i përshtatshëm. Për disa vlerësime qasjet cilësore janë të përshtatshme, për shembull duke i kërkuar një ekspert ose duke u bazuar në përvojën e dikujt tjetër, dhe në këto raste pasiguria mund të menaxhohet duke u kontrolluar me një ekspert tjetër ose duke përdorur më shumë se një krahasim.

Reduktimi i pasigurisë në këto raste është më shumë një rast i “sensit të përbashkët” sesa një metodologji komplekse:

-Kur përvoja e mëparshme është përdorur për të parashikuar efektet e mundshme të një zhvillimi të propozuar, vlerësuesi duhet të sigurojë që vendndodhja tjetër ose aktiviteti është i arsyeshëm, krahasuar me propozimin aktual në aspektin e hartimit të projektit dhe mjedisit. Nëse ekzistojnë dallime, ato duhet të merren në konsideratë gjatë interpretimit të ndikimit të parashikuar.

-Nëse përdoret gjykimi i ekspertit ai duhet të jetë sa më i paanshëm që të jetë e mundur. Nëse paragjykimi ose polemika është e pashmangshme, duhen nxjerrë vëzhgime nga ekspertët e tjerë dhe çdo ndryshim në opinionin e shprehet qartë për vendim-marrësit.

-Aty ku ka pasiguri, analiza e ndjeshmërisë mund të jetë një mjet i dobishëm. Analiza formale e ndjeshmërisë është një metodë analitike e përdorur për të vlerësuar qëndrueshmërinë e marrëdhënieve mes variablave: në terma të thjeshtë, sa do të rritet X nëse rritet Y? Një faktor i quajtur derivat i pjesshëm që llogaritet për çdo të dhënë është i njohur si koeficient i ndjeshmërisë. Të dhënat me koeficientin më të lartë të ndjeshmërisë kanë ndikimin më të madh mbi pasigurinë në rezultate.

Në formën më të thjeshtë të analizës së ndjeshmërisë bëhet pyetja “Nëse” Çfarë do të ndodhë me ndikimin e cilësisë së ajrit nëse kushtet e motit bëhen progresivisht më të ngrohta me kalimin e kohës?”.

Kjo lloj analize mund të përdoret për të provuar se si mund të ndryshojnë rezultati sipas skenarëve të ndryshëm të ardhshëm dhe sa i ndjeshëm është ndikimi në pasigurinë e të ardhmes. Nëse rezultati është shumë i ndjeshëm, atëherë mund të jetë e nevojshme që të punohet shumë më tej për të reduktuar pasigurinë ose të imponohen kufizime në projekt për të parandaluar ndikimin që të bëhet shumë i lartë, p.sh., duke imponuar kushte të lejueshme për kufizimin e niveleve të punimit. Teknika

lejon burimet të fokusohen në variablat kryesorë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në pasigurinë, në mënyrë që pasiguria e përgjithshme e rezultatit përfundimtar të zvogëlohet.

Metoda gjithashtu promovon një kuptim më të mirë të punimeve të sistemit dhe rëndësinë e variablave që nxjerrin rezultatin.

2.3 – Planet territoriale

Projekti i kerkuar “*Rikonstruktion dhe Shtese i Shkolles se Mesme, Lagjia Kastrioti, "Fushe Kruje*” është hartuar dhe propozuar nga specialistet e fushave perkatese dhe krahas pregatitjes se tij ne peputhje me kerkesat te propozuara nga investitori dhe kushtet teknike te zbatimit permbushe dhe eshte ne perputhje me planet rajonale te zhvillimit ekonomiko-social si edhe ato te regullimit te territorit per kete zone .

Projekti aktual i parashikuar nga investitori do te perfshije reabilitim/ndertimin e shkollave qe ndodhet brenda qytetit te Fushe Krujes .

Për kete zone dhe per Fushe Krujen ne vecanti janë hatuar disa plane rregulluese dhe funksionale brenda te cilave padiskutim kane qene keto shkolla per te cilin eshte detyra e projektimit per permiresim te mjedisit egzistues ne menyre qe te mundesoje rritjen e sigurise se ketyre shkollave si dhe pershtatjen me kerkesat teknike te kohes ne menyre q ete funksionojë sipas parametrave te vendosur me pare .

2.3.1– Planifikimi hapësinor

Parimet e përgjithshme te ketij planifikimi ne forme te shkurtuar janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare qe mund të permblidhen si më poshtë:

- 1) Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm
- 2) Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror
- 3) Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazhore, të florës e faunës
- 4) Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve
- 5) Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore
- 6) Përfshirja e parimeve të tilla si “ndotësi paguan”
- 7) Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit
- 8) Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe pergatitjen e sheshit të ndërtimit.
- 9) Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe akses i publikut në informacion
- 10) Bashkëpunim kufitar dhe rajonal

2.3.2– Standartet mjedisore per ndertimin e shkollave

Ligji shqiptar mbi Mbrojtjen e Mjedisit kërkon që çdo projekt apo veprimtari që do të prekë, apo ka gjasa të prekë mjedisin duhet të marrë një Deklaratë Mjedisore, Leje, Autorizim apo Pëlqim Mjedisor nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU) apo Drejtoria Rajonale e Mjedisit para fillimit të implementimit të projektit. Një vendim i Këshillit të Ministrave ka përcaktuar tipet e projekteve që duhet të marrin njërin prej aprovimeve të sipërpërmendura.

Ligji parashikon përkufizimet e mëposhtme që janë të rëndësishme për klasifikimin e projekteve dhe licencat respektive që duhen lëshuar.

1. “*Projekt*” i referohet çdo implementimi të punimeve me karakter ndërtimi, instalime apo skema apo ndërhyrje të tjera në një mjedis apo peisazh natyror , duke përfshirë shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe pasurive minerare.

2. “*Vlerësim i ndikimit në mjedis*” (VNM) është procesi i ndërmarrë për të identifikuar, parashikuar, interpretuar, matur, komunikuar dhe parandaluar impaktin e një projekti mbi mjedisin , sipas alternativave të tij, në mënyrë që të zgjidhet alternativa më e mirë për të parandaluar apo lehtësuar impaktet negative, para miratimit të projektit dhe implementimit të tij.

3. “*Vlerësimi strategjik mjedisor*”(VSM) është procesi i vlerësimit të impakteve të mundshme mbi mjedisin, të një politike, plani apo programi.

4. “*Deklaratë mjedisore*” është dokumenti zyrtar lëshuar nga Ministria e Mjedisit, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës për miratimin e projektit, planit apo programit. Deklarata mund të refuzojë apo aprovojë kërkesën e parashtruar, duke e shoqëruar atë me kushtet detyruese për tu implementuar nga propozuesi dhe autoritetet kompetente. Deklarata Mjedisore lëshohet pasi kryhet Vlerësimi strategjik Mjedisor.

5. “*Leja Mjedisore*” është dokumenti zyrtar, lëshuar nga Ministria e Mjedisit, pas shqyrtimit dhe konsultimeve mbi kërkesën dhe dokumentacionin përkatës me pjesëma rrësit e interesuar në proces. Leja miraton ushtrimin e një veprimtarie që ka një impakt mbi mjedisin, dhe përcakton kushtet dhe rrethanat detyruese që duhet t’i përmbahet, në mënyrë që ndotja dhe dëmet të mos tejkalojnë normat e lejuara.

6. “*Pëlqimi dhe Autorizimi Mjedisor*” lëshohet për aktivitete të karakterit lokal që kanë një ndikim mbi mjedisin, por nuk përfshihet në Vendimin e Këshillit të Ministrave. Ato miratohen nga Drejtorite Rajonale e Mjedisit në formën e pëqimit apo autorizimit, në bashkëpunim me organet e qeverisjes lokale.

Udhëzimet e Ministrisë të Mjedisit aprovojnë listën e veprimtarive, formatin e aplikimit, rregullat dhe procedurat për dhënien e lejes apo autorizimit nga DRM-të.

Çdo formë miratimi mund të përmbajë kushte dhe procedura detyruese për t’u implementuar, në mënyrë që ndotja dhe dëmet ndaj mjedisit të mos i tejkalojnë normat e lejuara. MMPAU ka autorizuar zyrat e sal lokale të ARM-ve për të lëshuar Aprovimet Mjedisore për veprimtari me impaktin më të vogël mbi mjedisin, përkatësisht Autori i Mjedisit (për impakt më i madh) dhe Pëlqim Mjedisor (për impakte më të vogla).

Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) përcakton tipin dhe shkallën e projekteve apo veprimtarive që kërkojnë VNM para implementimit. Kategoritë e VNM-ve janë:

- *VNM i përmbledhur*. Ky vlen për projekte që mund të kenë impakte potenciale më të vegjël në përmasa që sërish kërkojnë një vlerësim profesional të impakteve të tyre. Këto përfshijnë projekte që janë listuar në Shojcën 2 të Ligjit për VNM dhe ndryshime apo rehabilitime të projekteve të listuar në Shtojcën 1.

- *VNM i Thelluar*. Ky vlen për projekte me impakte potencialisht të konsideru eshme, siç figurojnë në listën e Shojcës 1 të Ligjit, ato projekte të listuara në Shtojcën 2 për të cilët MMAP mendon se do të kenë një impakt të konsiderueshëm mbi mjedisin (bazuar në informacionin e siguruar nga propozuesi në kohën e aplikimit, në mënyrën e detajuar në Shtojcën 3 të Ligjit) dhe veprimtaritë janë për tu implementura në zonat e mbrojtura të Republikës së Shqipërisë.

Kërkesa specifike sipas legjislacionit shqiptar për çështje të pronës kulturore, habitatet natyrore dhe pyjet paraqiten shkurtimisht më poshtë:

▲ Çështjet që lidhen me trashëgiminë kulturore rregullohen nga Ligji Nr. 9048, “Mbi Trashëgiminë Kulturore”, datë 7 Prill 2003. Ky është një ligj shumë i gjerë që mbulon shumë aspekte të trashëgimisë kulturore.

Ligji kërkon se në rast se çdo person zbulon ose gërmon në mënyrë të rastësishme objekte të trashëgimisë kulturore gjatë punimeve të ndërtimit duhet të ndërpresë punimet menjëherë dhe të njoftojë autoritetet përkatëse locale brenda tri ditësh . Këto organizma janë pastaj përgjegjëse për të bërë kontrollin përkatës të objekteve të gjetura, të raportojnë mbi vlerën e tyre dhe të bëjnë propozime mbi vazhdimin e punimeve ose ndërprerjen e tyre për hetime të mëtejshme. Këto organizma mundën gjithashtu të vendosin mbi çdo ndryshim ose ndërprerje të mundshme të punimeve për të ruajtur objektet e gjetura. (Neni 48)

Për raste të ndërtimit të mëdha investitorët janë të detyruar të konsultohen me autoritetet përkatëse gjatë hartimit të projektit dhe aplikimit për lejdërtimi. Specialistët duhet të kontrollojnë zonën dhe të përgatisin raportin përkatës si dhe çdo modifikim të nevojshëm për mbrojtjen e çdo objekti me rëndësi kulturore. Propozimi për ndryshime në projekt bëhet nga institucionet që kanë kryer kontrollin. Shpenzimet për këto ndryshime duhet të përballohen nga vetë investitori. (Neni 47)

Çdo restaurim i objekteve me rëndësi kulturore, p.sh.një ndërtesë publike e mbrojtur me urdhër të autoriteteve kompetente, duhet të kryhet nga persona të licencuar për punime të tilla.(Neni 17)Çdo objekt i restauruar nga një institucion jo-qeveritar duhet të supervizohet nga institucioni/et përkatëse shtetërore. Zona që rrethon një monument kulture konsiderohet si zonë e mbrojtur(Neni 32)dhe punimet që do të kryhen duhet të autorizohen nga organizmi kompetent. (Neni 33)

Çdo kosto ose shpenzim për ndryshimet e kërkuara nga autoritetet kompetente, në çdo fazë të projektit, për secilën nga situatat e mësipërme, përfshi çdo kërkim shkencor të kërkuar dhe çdo aktivitet të nevojshëm restaurimi ose ruajtjeje, duhet të përballohen totalisht nga investitori. Megjithatë, në rastin e restaurimeve të objekteve të trashëgimisë kulturore autoritetet përkatëse vënë në dispozicion një fond të caktuar në varësi të kategorisë së monumentit.

▲ Çështje që kanë të bëjnë me habitatet Natyrore rregullohen me anë të Ligjit Nr. 8906, datë 6.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura”. Ky është një ligj me ndikim të gjerë, që mbulon shumë aspekte të zonave të mbrojtura.

Objekti i Ligjit

Ky ligj ka për objekt shpalljen , ruajtjen , administrimin , menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre; lehtësi mine kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor;për informimin dhe edukimin e publikut dhe për përfitime ekonomike, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, nga popullsia vendore, nga sektori publik dhe privat. (Neni 1)

Qëllimi i Ligjit

1.Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mbrojtje të veçantë të përbërësve të rëndësishëm të rezervave natyrore,të biodiversitetit dhe të natyrës,në tërësi nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura.

2.Zonat e mbrojtura krijohen për të siguruar ruajtjen dhe ripërtëritjen e habitateve natyrore, të llojeve, të rezervave dhe të peisazheve natyrore.

3.Ky ligj rregullon mbrojtjen e 6 kategorive të zonave të mbrojtura, që zbatohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.Kategorizimi i zonave,statusi dhe niveli i mbrojtjes për secilën zonë, mbështetet në kriteret e Qendrës Botërore të Ruajtjes së Natyrës (IUCN). (Article 2)

1.Veprimtaritë dhe ndërtimet në zonat e mbrojtura bëhen vetëm sipas kërkesave të këtij ligji, në përputhje me planin e manaxhimit dhe pasi të jetë marrë leja e mjedisit.Për ndërtimet që janë bërë ose bëhen në kundërshtim me këtë ligj,zbatohet ligji“Për Urbani stikën” i ndryshuar.

2.Veprimtaritë ekonomike e shoqërore, projektet që synojnë të zbatohen në një zonë të mbrojtur, pajisen me leje mjedisi, pasi të paraqesin studimin përkatës dhe raportin e plotë të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

3. Të gjitha ndërtimet publike, private e turistike në territorin e zonave të mbrojtura, bëhen në bazë te studimevedhe të planeve rregulluese të përgjithshme,të cilat miratohen nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.Administrata e zonave të mbrojtura, inspektorët e mjedisit , organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe atë ndërtimore ndalojnë zbatimin e projekteve e të veprimtarive me ndikim në mjedis dhe që bien ndesh me planin e manaxhimit të zonës.

5.Personat juridikë e fizikë, që kryejnë veprimtari të lejuara në territorin e zonave të mbrojtura , me hyrjen në fuqi të këtij ligji, janë të detyruar të lidhin kontratë me institucionet administrative për ushtrimin e veprimtarisë, kundrejt pagesave përkatëse. (Neni 19)

▲ Çështje që kanë të bëjnë me pyjet rregullohen me anë të Ligjit Nr 9385 datë 4.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”:

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të njëjta për marrëdhëniet, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore, organeve të pushtetit vendor, organizatave jofitimprure, pronarëve privatë dhe të biznesit, për ruajtjen, administrimin, manaxhimin dhe përdorimin e fondit pyjor kombëtar, të tokës pyjore dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre.

2.Ky ligj rregullon edhe veprimtaritë mbrojtëse, shoqërore, ekoturistike dhe ekonomike që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar dhe në burimet e tjera pyjore dhe jopyjore, në bazë të parimeve të mbarështimit të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të pyjeve. (Neni 1)

1.Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore për t’u kthyer në truall, për ndërtimin e strukturave turistike,të qendrave të pushimit apo shëndetësore, për zgjerimeviejës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit dhe të qendrave të banuara në zona rurale ose për qëllime të tjera publike si për rrugë automobilistike dhe hekurudhore, për çpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake e qendra industriale, hiqen nga fondi pyjor dhe Kadastra e Pyjeve si më poshtë:

a)Pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 30 ha, me miratim të Këshillit të Ministrave

b)Pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 30,1 ha, me ligj të veçantë.

2.Rregullat për paraqitjen e kërkesës,mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik,kriteret dhe procedurat zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. (Neni 17)

3. -Pershkrimi i projektit

POZICIONI ORTOFOTO



- Qellimi i projektit

Si rezultat i lëkundjeve sizmike të datës 04.07.2018, midis shumë objekteve ndërtimore të dëmtuara, është dëmtuar shumë dhe shkolla e mesme e bashkuar “Ramazan Jangozi” në Njesinë Administrative Thumanë, e cila që mëparë ishte shumë e dëmtuar, si pasojë e amortizimit dhe e mosinvestimit ndër vite, por që në këto momente zhvillimi i procesit mesimor në këto ambiente është bërë i rrezikshëm për sigurinë e nxënësve.

- Gjendja ekzistuese

Në Thumanë aktualisht janë dy shkolla, shkolla 9-vjeçare dhe shkolla e mesme, që i korespondojnë dy godinave, godina e re 3 kate ku aktualisht zhvillohet procesi mësimor për arsimin parashkollor, 9-vjeçar të mesëm dhe godina e vjetër 2kat, që aktualisht nuk zhvillohet proces mësimdhënie për arsye sigurie, si rrjedhojë e dëmtimit të saj nga amortizimi ndër vite dhe nga tërmeti i mësipërm, po që më parë përdorej për procesin e mësimdhënies për arsimin parashkollor dhe fillor.

Në godinën 2 kat, para dëmtimit të fundit nga tërmeti, zhvillohej procesi mësimor për arsimin parashkollor dhe fillor, vetëm në tre ambiente të saj, ndërsa 4 klasa ishin totalisht të dëmtuara si pasojë e amortizimit ndër vite.

Godina e vjetër 2 kate është ndërtuar rreth viteve 70 dhe që nga ajo periudhë nuk është investuar duke e kthyer në një objekt mjaft të amortizuar ku procesi i mësimdhënies është pezulluar për arsye sigurie.

Numri i nxënësve në total, që studiojnë në këto shkolla është rreth 550 nxënës, të ndarë;170 nxënës (parashkollore dhe fillor) tek shkolla e vjetër 2kat dhe rreth 380 nxënës studiojnë tek shkolla 3 kat (fillorë dhe e mesme).

Kati përdhe 280 m²:

Klasa te Pergjithshme	3 klasa
Banjo	6 copë
Ambjente sherbimesh	2 copë
Korridor	

Kati i parë 280 m² :

Klasa te Pergjithshme	4 klasa
Salle mesuesish	1 copë
Korridor	

Ambientet qe disponon shkolla ne total jane:

Klasa te Pergjithshme = 3 klasa aktuale, 4 klasa të dëmtuara, në total 7 klasa.

Per rrjedhoje, shkolla nuk realizon sic duhet funksionin baze te saj si institucion edukativ. Si pasojë e numrit të madh të nxënësve dhe e ambjenteve të pamjaftueshmë për mësimdhënie (duke i konsideruar të dy godinat aktive), procesi mësimor në godinën 3 kat zhvillohet me turne, duke kaluar 3 klasa mbasdite, pasi edhe para dëmtimit të godinës 2kat nga tërmeti, mësimdhënia në 4 klasa të saj nuk zhvillohej pasi ishin mjaft të dëmtuara.













- Propozimi

Ndodhur në këto kushte, bashkia Krujë ka hartuar projekt preventivin për rikonstrukcionin e godinës së vjetër 2kat, e cila do të zgjidhte njëherë e mirë procesin e mësimdhënies për arsimin parashkollor, 9-vjeçar dhe të mesëm, duke eliminuar dhe procesin e mësimdhënies me turne, pasi restaurimi i saj do të krijojë 4 ambjente të reja veç ambjenteve ekzistuese si dhe do të bëjë të mundur dhe ndërtimin e 6 banjove të reja.

Po ashtu, në këtë projekt është parashikuar dhe ndërtimi i një palestere të re me sipërfaqe 350m², e cila do ti shërbente dy shkollave respektive, ku aktualisht të dy shkollat janë pa palestër.

3.2 –Natyra e projektit

Projekti është i llojit “ndërtim dhe rikonstrukcion shkolle ekzistuese ” dhe përfshin rikonstrukcionin dhe ndertimin e pjesëve ekzistuese te shkollave te qytetit te Fushe Krujes dhe qendres e qytetit .

3.3 –Madhesia e projektit dhe rendesia per rajonin ku do ndertohe

Projekti per rikonstrukcionin e shkolles se mesme “Shote Galica” ne Fushe- Kruje eshte hartuar duke marre ne konsiderate problemet aktuale qe paraqet godina si dhe zhvillimin perspektiv te shkollave si institucione edukative.

3.3.1 –Rendesia e projektit per rajonin ku do ndertohe

Shkolla aktualisht ka 550 nxenes sic vihet re nga pershkrimi dhe te dhenat qe na jep gjendja ekzistuese, themi se shkolla karakterizohet nga mungesa te theksuara hapësirash dhe ambjentesh studimore. Hapësirat qe ajo ve ne dispozicion te nxenesve, por edhe te stafit mesimor paraqiten jashte cdo standarti dhe sjellin mangesi te dukshme gjate procesit mesimor dhe edukativ.Si pasoje e

mungeses te ambienteve studimore dhe numrit te madh te nxenesve, procesi mesimor kryet me dy trune (paradite dhe mbasdite).

Synimi i ketij projekti ka te beje me perftrimin e hapësirave reja qe plotesojne nevojat e nxenesve dhe mesuesve per kryerjen e veprimtarive perkatese. Gjithashtu, hapësira ekzistuese do t'i pershtatet kerkesave bashkekohore per nje shkolle qe i pergjigjet jo vetem se tashmes, por edhe brezave te se ardhmes.

Parcela e vënë në dispozicion për këtë ndërtim është dhënë nga Bashkia e Krujes. Ajo ka nje siperfaqe prej 5477 m².

3.5–Karakteristikat , pershkrimi dhe programi per ndertimin

Projekti per rikonstrukcionin e shkolles se mesme “Shote Galica” ne Fushe- Kruje eshte hartuar duke marre ne konsiderate problemet aktuale qe paraqet godina si dhe zhvillimin perspektiv te shkollave si institucione edukative.

3.5.1 –Karakteristikat e vendit te ndertimit

Synimi i ketij projekti ka te beje me perftrimin e hapësirave reja qe plotesojne nevojat e nxenesve dhe mesuesve per kryerjen e veprimtarive perkatese. Gjithashtu, hapësira ekzistuese do t'i pershtatet kerkesave bashkekohore per nje shkolle qe i pergjigjet jo vetem se tashmes, por edhe brezave te se ardhmes.

Parcela e vënë në dispozicion për këtë ndërtim është dhënë nga Bashkia e Krujes. Ajo ka nje siperfaqe prej 5477 m².

3.5.3 –Programi per ndertimin

E rendesishme eshte te permendim edhe nje sere problemesh qe kane te bejne me mirembajtjen e mjediseve te brendshme te shkolles. Keshtu, duke iu referuar gjendjes ekzistuese dhe analizave te kryera ne terren, nenvizojme probleme ne mirefunksionimin e rjetit elektrik te godines, suva ne gjendje te degraduar, problem ne shtrimin e ambjenteve me pllaka, ne kullimin e ujerave, prezencen e lageshtise si dhe mungese te theksuar te kushteve higjeno-sanitare ne ambjentet e brendshme si dhe ne ambjentin perreth godines.



3.5.4–Pershkrimi i alternativave dhe analiza e tyre

Koncepti i alternativave mund të përkufizohet si një kurs të mundshëm të veprimit nga një vend në një tjetër për përmbushjen e të njëjtit qëllim.

Një krahasim i alternativave do të ndihmojë për të përcaktuar metodën më të mirë për arritjen e objektivave të projektit duke minimizuar ndikimet mjedisore ose, të tregojnë opsionin më miqësor për mjedisin ose atë më të mirë në praktikë.

Marrja në konsideratë e alternativave mund të jetë më e dobishme kur VNMS punohet në fillim të ciklit të projektit. Në varësi të kohës, llojit dhe numrit të alternativave të hapura për shqyrtim mund të përfshijnë:

- Alternativa “aktivitet”
- Alternativa “Vendndodhje”
- Alternativa Procesi
- Alternativa e kërkesës
- Alternativa e caktimit
- Alternativa “rruga më e mirë”
- Alternativa “kantier”
- Alternativa “shkallë”
- Alternativa ‘projekt’

Gama e kategorive të alternativave që do të vlerësohen duhet të konsiderohen së bashku me alternativën Do nothing .Ndikimi relativ i çdo alternative është krahasuar kundër mjedisit bazë me

projekt-pa projekt) për të zgjedhur një alternativë të preferuar, duke përfshirë dhe opsionin për të mos marrë asnjë masë. Vlerësimi i alternativave duhet të përfshijë një krahasim të plotë të të gjitha ndikimeve të mundshme, të direkt dhe indirekt dhe përmbledhës (Kapitulli 14), në mjedis. Qëllimi i vlerësimit të alternativave është për të gjetur mënyrën më efektive të takimit midis qëllimit e propozimit, dhe përfitimeve mjedisore të aktivitetit të propozuar, ose përmes reduktimit ose shmangies së ndikimeve potencialisht të rëndësishme negative.

Vlerësimi Mjedisor

Vlerësimi mjedisor i alternativave ka për qëllim për të siguruar :

- ☞ Një vlerësim të përgjithshëm mjedisor të investimeve të propozuara
- ☞ Rekomandimet për masat zbutëse mjedisore që do të shoqërojnë investimet.

Aktivitetet e mëposhtme kryesore që do të përfshihen janë:

- ☞ Përmbledhje e legjislacionit shqiptar në fushën e mjedisit;
- ☞ Identifikimi i çështjeve kryesore mjedisore për të vlerësuar e ndikimimi në mjedis përgjatë rrugës nga zbatimi i alternativave;
- ☞ Përshkrimi i masave të mundshme zbutëse për të parandaluar ose reduktuar ndikimet e rëndësishme në mjedis;
- ☞ Propozimi i veprimeve mjedisore që do të ndërmerren gjatë fazave të planifikimit dhe ndërtimit në të ardhmen

Vlerësimi Ekonomik

Problemi themelor i studimit të fizibilitetit është vlerësimi ekonomik i cili krahason kostot dhe përfitimet e alternativave të ndryshme të investimit në një situatë të referencës - dmth një situatë pa investime të reja.

Kushtet e vlerësimit ekonomik:

- Një analizë kosto-përfitim e çdo alternative studiuar;
- Një analizë financiare për të njohur ndikimin rrugor. Këtu duhet të përfshihen :
- Përgatitja e një modeli “spreadsheet” për analizë kosto-përfitim gjatë një horizonti me shume se 20-vjeçare;
- Përgatitja e analiza të parashikimeve ekonomike dhe faktorëve të rritjes
- Përgatitja e analizës kosto-përfitim për çdo alternativë të studiuar;
- Përgatitja e analizës së ndjeshmërisë mbi rezultatet e kosto-përfitimit;
- Krijimi i një plani të të detajuar të zbatimit.

“Alternativa mos bëj asgjë “do nothing”.

Pasojë e “alternativës mos bëj asgjë” është sikur njëllon sikur kërkesa për një infrastrukturë moderne dhe tepër e nevojshme për të gjithë zonën dhe më tej të mos merret në konsideratë . Kjo alternative nese do të qëndrojë në këto parametra nuk do mundësojë asnjëherë rritjen e te ardhurave për banorët e zonës dhe pushtetin vendor përkundrazi ,këto të ardhura do shkojnë në ulje si pasojë e migrimit të banorëve apo zhvendosjes së bizneseve dhe investimeve në zona të tjera me infrastrukturë rrugore të pranueshme.

Largimi i turistëve do kete pasoja shume te renda ekonomike pasi duhet te konsiderojme qe gjate gjithë vitit vihet ne levizje i gjithë mekanizmi ekonomik i kesaj zone duke ndihmuar ne rritjen e cilesise se jeteses te banoreve te kesaj zone .

Alternativa e dyte:

– Rregullim i anes panoramike duke sjelle nje zburim dhe rritje te shkalles se gjelberimit ne perputhje edhe me PPV ne te cilen jane parashikuar krijimi i të hapsirave të reja te gjelbra dhe zonave

rekreative.

- Parqet kodrinore (shtresa tampone)
- Pyllëzimi i zonave kufitare me zonat e banimit
- Mbrojtja e tokës bujqësore

Ky rehabilitim mjedisor do të sjellë një sërë ndikimesh pozitive për qytetin:

- Një panoramë shlodhese për kete zone
- Cilësia e ajrit do të jetë më e mirë duke ulur ndjeshëm sasinë e ndotësave kryesorë në ajër.
- Uljen e nivelit të zhurmave të shkaktuara nga automjetet gjatë levizjes se tyre .

Alternative e projektit

Projekti i propozuar merr në konsideratë të gjitha faktorët për rritjen ekonomike të zonës , promovimin e turizmit dhe vlerave të tjera të zonës. .

4. –Pershkrimi i gjendjes egzistuese te mjedisit

Pershkrimi i kushteve aktuale mjedisore te zones se projektit dhe zonave perreth eshte bere duke u nisur nga te dhenat e mbledhura gjate vizites se fillimit te projektit, si edhe nga te dhenat e mbledhura me pare apo te nxjerra nga interneti.

Zona ne te cilen kerkohet te ndertohej ky objekt dhe te zhvilloje veprimtarine eshte ne nje zone qytetese , pothuaj ne qender te Fushe Krujes , ne zbatim te mbrojtjes se përbërësve te mjedisit dhe proceseve mjedisore duke qene nje zone e orientuar dhe miratuar ne drejtimin industrial dhe te sherbimeve dhe prodhime te ndryshme dhe ka ne afersi nje fabrike cimentoje te rikonstruktuar vitet e fundit me nje kapacitet te madh , fabrike tjegullash te ndertuar te re , furra prodhimi gelqereje ne sasi teper te limituara dhe nu mri i tyre eshte mjaft i vogel , fasoneri , makineri gurthyese te spostuara nga zona e banuar ne drejtimin e lokaleve te sherbimit social , mobilieri , lavazhe , servise si dhe atyre te treg timit te materialeve te ndryshme ushqimore dhe ushqimore . Zona afer ketij objekti eshte zone e banuar ka lokale te sherbimeve sociale dhe institucione shteterore .

Territori ne studim nuk eshte i perfshire ne menyre te drejtperdrejte ne zone te mbrojtur si rezervat, park kombetar etj. dhe nuk eshte zone e ruajtur ne perputhje me planet e zhvillimit ekonomik te vendit dhe ne strategjine kombetare te mjedisit .

Nuk eshte zone e përdorur per specie të mbrojtura , të rëndësishme të florës dhe faunës, si për kryqëzim, folenizim, ushqim, pushim, dimërim, migrim që mund të ndikohen nga zhvillimi i ketij aktiviteti projekti .

Eshte zone me rendesi historike dhe kulturore dhe ndikon ne menyre shume te madhe ne ruget e kalimit te publikut apo mjedisore te tjera shplodhese , pushuese .

Ekipi i projektimit ka propozuar zgjidhje të te , te ndryshme teknike nga egzistuese duke konsideruar qellimin kryesor përmirësimin e sherbimit te mesimdhenies qe për momentin është në kushte të vështira , me nje siguri te ulet dhe me vështirësi ne funksionim.

4.1–Kushtet klimaterike

Kjo zone ben pjese ne nenzonen qendrore te zones klimaterike mesdhetare . Dimri eshte i bute dhe me lageshti ndersa vera eshte e nxehte dhe e thate .

Kjo zone ka mbi 2500 ore ndricim dielli ne vit . Muaji me ndricim me te gjate eshte Korriku me 350 ore dhe muaji me ndricim me te shkurter eshte Dhjetori me 108 ore .

Temperatura mesatare e ajrit eshte afersisht 13.8 grade celsius ndersa me te ulet e ka muaji Janar me afersisht mesatare prej 5.7 °C.

Ne pergjithesi ndryshimet mujore te temperaturave jane graduale dhe jane me te medha gjate kohes se ndryshimit te regjimit te stineve . Keto fenomene ndodhin ne periudhat Mars-Prill dhe ne Tetor – Nentor kur kemi perkatesisht kalimin nga regjimi dimeror ne ate pranveror dhe nga vjeshtor ne dimeror .

Paneli 1

Muaj	Temperaturë Mesatare (°C)	Temperaturë Minimale (°C)	Temperaturë Maksimale (°C)	Lagështi Relative Mesatare (%)	Shira Mujore Mesatare (mm)	Shira Mujore Minimale (mm)	Shira Mujore Maksimale (mm)
JAN		-10,4	21,3			2,4	304,3
SHK		-7,6	27,7			18,6	288,4
MAR		7	27,9			14,4	308,7
PRI		0	31,7			26,9	214,5
MAJ		2,5	35,8			7,2	228,4
QER		5,6	39,7			4,6	167,1
KOR		9,4	41,5			0	168,3
GSH		10	40			0	178,7
SHT		3,8	35,8			11,5	175,3
TET		-1,3	31,4			0	340,5
NËN		-4,3	26,4			17,1	390,9
DHJ		-6,9	22,5			21,4	257,8

Vlera maksimale e reshjeve te rregjistruara ne 24 ore ka arritur shifren prej 185 mm pa konsideruar matjet e koheve te fundit .

Reshjet e bores ne kete zone jane shume te rralla dhe bore mund te kete 2-3 dite ne vit sipas statistikave te fundit me nje trashesi qe nuk i kalon 5 cm .

Vlera maksimale e temperatures se ajrit ne kete zone me nje siguri prej 50% eshte rreth 37 °C dhe temperatura minimale rreth 4 °C .

Mesatarja e reshjeve vjetore sipas statistikave eshte 1.800 mm/vit e shperndare ne menyre te crregullt ne kohe dhe sasisa me e madhe eshte ne periudhat Tetor – Maj me nje sasi rreth 70% duke rregjistruar si muajin me te lagesht muajin Nentor . Muaji me i thate rezulton muaji Korrik por ka ndryshime nga viti ne vit per shkak te ndryshimeve globale.

Si rrjedhim ky territor ne te cilin kerkohet te zhvillohet ky aktivitet eshte i favorshem per kete zhvillimin e kesaj veprimtarie .

Erat kryesore jane ne drejtimet juglindje - veriperendim dhe verilindje – jugpere ndim por nuk jane te forta .

Nder ererat kryesore ne kete zone mund te permendim :

- ≈ murlanin i cili vjen nga veri-lindja eshte i ndjeshem vecanerisht ne peridhen e dimrit ,ka shpejtesi te madhe dhe karakterizohet nga nje mot i ftohte .
- ≈ shirokun e cila vjen nga juglindja vecanerisht ne periudhen e vjeshtes dhe fillim dimri , eshte e ftohte dhe karakterizohet nga mot me lageshtira , me shira te shumte .
- puhia e cila vjen nga veriperendimi , eshte e ngrohte dhe ndihmon ne nje klime te nxehte

4.2 –Ekosistemet , flora dhe fauna

Ekologjia eshte shkenca qe studion ligjet e marredhenieve te ndersjellta ndermjet gjallesave dhe mjedisit ku ato jetojne.

- Faktoret ekologjikë (elementë të mjedisit)
 - Abiotikë (fizikë dhe kimikë)
 - Biotikë
- Faktorët Antropogjen(ndikimi i njeriut)
- Ekosistem (sistem ekologjik) – çdo bashkesi e formuar nga gjallesat dhe mjedisi abiotik, qe kane ndermjet tyre bashkeveprim e lidhje te ndersjellta.
- Biocenoza – teresia e individëve të llojeve të ndryshme që bëjnë pjesë në ekosistem.
- Biotop – mjedisi ku jeton Biocenoza.
- Rrjetat ushqimore – zinxhire ushqimore paralele ose të gërshetuarnë biocenozat natyrore. Zinxhirët ushqimorë nga ana e tyre përfaqësojnë njeseri gjallesash (tri nivele trofike: prodhues, konsumator, dekompozues), ku cdo organizem (hallkë) sherben si ushqim per hallkën pasardhë

Larmia biologjike paraqitet e mire ne disa vende dhe me bimesi drunore te larte te ruajtur nga investimet e viteve me pare. Duke qene ne zone banimi ka disa lloj pemesh frutore dhe jo jofrutore te kultivuar ne vite por qe i kane mbjelle vete pronaret ne disa objekte private banimi ose sherbimi dhe nga njesia vendore jane mbjellur disa bime te ndryshme me nje dendesi te vogel dhe lartesi te ulet .

Ne kete sipërfaqe nuk ka bime endemike apo specie bimore te mbrojtura nga Konventat Nderkombetare ne te cilat vendi yne aderon .

Ne kete territor ka nje faune mjaft te varfer. Nder gjitaret kryesisht jane brejtësit e vegjel. Ne kete zone kryesisht per shkak te lartesisë se vogel te bimeve verehen te ulen harabele edhe disa lloj migratorësh , trumçaket , kryesartezat , kumrite etj.

Karakteristika kryesore e zonës së marë në shqyrtim është se në një territor shumë të vogël takohen lloje të ndryshme ekosistemesh duke përfshirë ato malore, lumore, të ujrave të ëmbëla (e rezervuarë) si dhe ekosisteme bujqësore ose agro ekosisteme. Vegjetacioni tokësor në këtë zonë i përket kryesisht karakterit të Europës Qendrore Kontinentale me prani të pak elementëve mesdhetarë.

Formacionet bimore të tërësisë tokësore shprehin një larmi formash, duke uzhvilluar ne mjediset e ulta afër ujembledhesve dhe Perrenjve ku sistemet ekulturave bujqësore dominojnë, në rajonet me lartësi të mesme e të madhe, e deri ne zonat e kullotave alpine. Në fushat e ulëta dhe kodrat, janë përshkruar një larmi formash barishtore si më poshte vijon: vegjetacioni i barishteve të këqija ndaj kulturave bujqësore, *vegjetacioni nitrofil* dhe *vegjetacioni anash rrugor*, *vegjetacioni amofil* , i kullotave të ulta e kodrinave, vegjetacioni i livadheve mocalore, dhe vegjetacioni i sistemeve pyjore.

Duke u mbështetur në vëzhgimet e deritanishme, ekosistemet natyrore të kësaj zone përbëhen nga një tërësi nën habitatësh siato të sistemeve të përhershme ujore , të kanaleve kullues e ujitës, ekosistemeve të rezervuareve , bankinave të sistemeve rrjedhëse ujore etj. Bimët e rralla Ekosistemet tokësore të zonës i përkasin nën ndarjes ballkanike të zonës së vegjetacionit Sub-Mesdhetar.

4.3 –Popullsia


Qyteti i Fushe Krujes ka nje popullsi rreth 17.000 mije numer i cili ndryshon ne menyre te vazhdu eshme per shkak te ardhjeve dhe levizjeve nga vende te tjera pothuaj nga te gjitha trevat .

Aktivitetet kryesore ne kete zone jane fasonerite te zhvilluar shume vitet e fundit ku jane te punesuar ndonese me page minimale nje numer i konsiderueshem punonjesish , punimet artistike , dy fabrika cimentoje ne afersi te cilat megjthe masat e marra kane ndikimin e tyre mbi mjedis , jane te zhvilluara bujqesia ne zonen ne afersi me qytetin dhe zonat perreth , blegtoria dhe tregtia e materaleve

te ndryeshme , te sherbimeve industriale dhe sociale , tregtim karburantesh , hoteleri , prodhim dhe tregtim mobilierish per objekte banimi , zyra etj. perpunim mermeresh dhe granitesh , linja te ndryshme prodhimi sfungjeresh etj.

4.4–Sizmiciteti

Rajoni ku shtrihet territori i Bashkisë së Krujës ndodhet ne pjesën veriore të Ultësirës së Tiranës. Ajo ndodhet në një distance mesatare prej 18 km nga qyteti i Tiranës dhe 28 km nga qyteti i Durrësit dhe si e tille perfshihet kryesisht ne territoret e prekura nga po të njëjtët tërmete që kanë prek ur këto dy qytete dhe zonat përreth tyre .



Zona Joniko-Adriatike e shkëputjeve mbi hipëse është zona më egjatë dhe me aktivitetin sizmik më të fuqishëm të vëndit tone prej së cilës janë gjeneruar edhe tërmetet më të mëdhenj që kanë prekur vendin tone. Ajo ndiqet për disa qindra km përgjatë bregdetit Adriatik e Jonian edhe jashtë territorit tonë dhe nëpërmjet dy shkëputjeve tërthoreve, Shkodër-Pejë dhe Vlorë-Tepelenë, ndahet në tre segmente si :

a)Segmenti verior me shtrirje PVP i karakterizuar nga shkëputje para-Pliocenike të tipit mbihypëse të zones Kruja ; ndiqet mbi 200 km nga Lezhanë Ulqin e më tej përgjatë bregdetit dhe është aktive edhe në ditët tona.

b) Segmenti jugor me shtrirje VP që ndiqet për mbi 250 km, nga Vlora në Konispol e më tej në Greqi, përgjatë bregdetit Jonian dhe karakterizohet nga shkëputje para-Pliocenike mbihypëse të zones Jonike.

c) Segmenti qëndror me shtrirje V deri VP që përbëhet nga shkëputje pas-Pliocenike mbihy pëse aktive të Ultësirës Pranadriatike dhe ndiqet përreth 130 km nga Vlora deri në Lezhë. Këtu përfshihet edhe zona ku shtrihet territori i Bashkisë së Fushë Krujës .

Ky segment është aktiv edhe në ditët e sotme. Sipas hartës së tërmeteve maksimale të pritshëm në këtë zonë mund të gjenerohen tërmete me magnitudë maksimale të pritshme deri $M_{max} = 6.5-6.9$

Nga ana gjeologjike rajoni i Krujës përfshihet kryesisht në zonën e jashtme tektonike Jonike që përbën edhe ballin orogjenik në zonën ekolizionit Adriatik .

Zona e Krujes

Zona e Krujes përfaqëson një kurrizore që kufizohet në lindje me zonën tektonike të Krastë-Cukalit ndërsa në perëndim me zonën Jonike dhe zonën e Adriatikut Jugor. Gjate gjithë kufirit tektonik lindor, vërehet branisje e flisheve dhe rralle here edhe gelqeroreve globotrunkanike të nënzones së Krastës mbi flijshin oligocenik të zones Kruja. Kontakti me zonën e Adriatikut Jugor dhe zonën Jonike nuk është kudo i qartë dhe i prërë. Ky kufi është i diskutueshëm sidomos për pjesën jugore (nga antiklinali i Tomorrit e më në jug).

Zona tektonike e Krujes, në të gjitha studimet e realizuara deri tani, është trajtuar si një zonë e vetme nga Leskoviku në jug, deri në Shkoder në veri. Disa studiues (Misha, etj. 1982, etj.) mbështetur në praninë e foraminifereve planktonike në depozitimet pelagjike të Kretakut në antiklinalin e Melesinit, e kanë trajtuar këtë të fundit si njësi të zones Jonike. Studimi tematik për deshifrimin biostratigrafik të depozitimeve karbonatike të zones Kruja (Korovesi, etj. 1999) solli të dhëna të rëndësishme biostratigrafike të cilat tregojnë për ndryshime të theksura të facies karbonatike nga veriu në jug. Në pjesën veriore, në të gjitha prerjet stratigrafike të kryera në depozitimet karbonatike rezultojnë vetëm foraminifere bentosike, që janë tipike për facien neritike. Këtu bëjnë përjashtim struktura me perëndimore, ajo e Ishmit, ku nga analizat e kryera në kampionet e marra në pusin Ish.1. ka rezultuar faunë e perzier, e cila interpretohet si kalimtare për në zonën Jonike (Nakuçi etj. 2001). Në jug, në antiklinalin e Tomorrit, në depozitimet e Kretakut të sipërme janë takuar foraminifere planktonike krahas atyre bentosike, po kështu dhe në Kulmakë e Qeshibesh, (shih kap. e stratigrafisë) dhe sidomos në Melesin ku takohen vetëm foraminifer planktonike.

Duke analizuar kohën e rudhaformimit, facien e depozitimeve karbonatike dhe stilin tektonik vëhet re qartë një ndryshim i dukshëm ndërmjet strukturave në rajonet nga Elbasani e më në veri nga ato më në jug. Në veri të Elbasanit strukturat janë lineare, kryesisht izoklinale, me facie neritike, të karakterizuara nga praninë e foraminifereve bentosike, me moshe të orogjenezës në fund të Oligocenit të hershëm. Ndërsa strukturat në pjesën jugore janë të natyrës antiklinale ose brahiantiklinale me facie të perziere, me fenomene paleogjeografike dhe me moshe më të vonshme të orogjenezës (në fund të Oligocenit të mesëm). Ky dallim esencial interpretohet si efekt i ndikimit të terthores Vlore – Elbasan - Diber, në jug të së cilës ndërtimi tektonik kondicionohet dhe nga praninë e prishjeve të tjera terthore dytesore dhe tektonikes kripore. Nisur nga veçoritë e mesiperme, për të evidentuar më mirë ndërtimin tektonik të kësaj zone, përshkrimin tektonik të saj do ta bëjmë sipas dy nënzonave tektonike të kondicionuar nga thyerja e thelle tektonike e lindur qysh në kohën e riftezimit të Albanideve të Jashteme.

Nënzona e Krastës.

Për një nënzonë paleogjeografike lindore të zones së Krastë - Cukalit. Ka përhapje sipërfaqesore në trajtën e një rrypi kryesisht të ngushtë, por me sektore ku zgjerohet dalja e saj si në Qaf-Shtame-Xiber, Qaf Molle-Polis, ndërsa prej rajoneve të masivit ultrabazik të Devollit e drejtë jugut ka formën e një brezi të gjërë dhe duke u ngushtuar mjaftë në afërsi të Leskovikut nga mbulimi i ofioliteve të zones së Mirditës. Në ndërtimin gjeologjik të kësaj nënzone marrin pjesë kryesisht depozitimet pelagjike, duke

filluar nga ato te flishit te hershem kryesisht te Albanit, gelqeroret me globotrunkana te Kretakut te siperm dhe flishit te ri te Maastriktian-Eocenit, qe njekohehisht pasqyrojne edhe fizionomin tektonike te saj, duke formuar rrudhosje e struktura te ngushta, te permbysura e te shtrira, te nderlikuara nga shkeputje tektonike mbihypse deri ne luspore.

Ne perendim kjo nenzone mbulon sektore te gjere te zones se Krujes. Ne ballin e mbihipjes takohet nje zone e gjere e luspezuar dhe shkateruar. Karakteristike per kete nenzone eshte se strukturat perendimore (te ballit te nenzones) ne berthame te antiklina leve ndertohen nga flishi i hershem ngjyre gri i Albanit.

Kështu, nga ky segment i Zones Joniko-Adriatike të shkeputjeve mbihypëse janë gjeneruar shumë tërmete mesatare deri të fortë. Zona e Fushë Krujës ,ne ditet e sotme është prekur nga tërmete me vatra pranë saj , si p.sh., tërmeti i 26 gushtit 1852 në Kepin e Rodonit, tërmeti i 16 majit 1860 në Urën e Beshirit , tërmeti i 4 shkurtit 1934 në Ndroq , tërmeti i 19 gushtit 1970 në Vrap dhe tërmeti i 9 janarit 1988 në (Yzberish) Tiranë, të cilët janë ndjerë në rajonin e Fushë Krujës me intensitet 6 ballë MSK-64. Ndër tërmetet më të fortë që kanë ndodhur në dy shekujt e fundit dhe që janë ndjerë në këtë zonë (referimi bëhet për pjesën qendrore të zones se Fushë Krujës) mund të përmëndim:

- Tërmeti i 1 Qershorit 1905 me $M_s=6.6$ dhe $I_0=IX$ ballë (MSK-64). Tërmeti është shoqëruar me viktima dhe dëme materiale në qytetin e Shkodrës. Ky tërmet është ndjerë fort në zonën e Fushë Krujës , ndersa ne pjesen veriore te kesaj zone është shoqëruar po ashtu me dëme materiale.

- Tërmeti i viti 1617 me $M_s=8$ ballë (MSK -64) në Krujë, (6 balle ne zonën e Fushë Krujës)

- tërmeti i 26.8.1852 me $M_s=6.0$ dhe intensitet $I_0=8$ ballë MSK-64, në Kepin e Rodonit; ky tërmet është pasuar me dëme të mëdha në zonën egjirit të Rodonit dhe të Lezhës.

- Tërmeti i 16.5.1860 me (MSK-64) në Urën e Beshirit, është ndjerë VI balle ne zonën e Fushë Krujës , Krujes

- Tërmeti i 17.12.1926 me $M_s=6.2$ dhe $I_0=IX$ ballë (MSK-64) në Durrës, është ndjerë VIII ballene zonën e Krujës

- Tërmeti i 4.2.1934 me $M_s=5.6$ në Ndroq , është ndjerë VI balle ne zonën e Fushë Krujës-

- Tërmeti i 19.8.1970 me $M_s=5.5$ dhe $I_0=IX$ ballë (MSK-64) në zonën e Vrapit, është ndjerë 6 balle ne zonën e Krujës

- Tërmeti i viti 16.9.1975 me $M_s=5.3$ në Kepin e Rodonit

- Tërmeti i viti 9.1.1988 me $M_s=5.4$ në Tiranë.

- Tërmeti i 15 Prillit 1979 me epiqëndër në det pranë kufirit shqiptar. Tërmeti ka qënë imadhesisë $M_s=6.9$ dhe me intensitet 9—10 balle (MSK-64) në zonën epiqëndrore. Ky tërmet ka shkaktuar dëme të mëdha dhe viktima në njerëz në bregdetin malazez dhe në vëndin tonë në rrethet Shkodër , Lezhë dhe Mirditë . Intensiteti i këtij tërmeti në zonën e Fushë Krujës ka qënë VII- VIII ballë MSK-64.

4.5–Hidrologjia

Zona e kerkuar per ndertim perfshin Qytetin Fushe Kruje ku rajoni eshte kryesisht zone malore Ne rajonin e poshtme te Fushe Krujes takohen formacionet gjeologjike te meposhtme:

1.-Depozitimet kuaternare-Holocen i vonshem: aluvione te shtratit , rera , zhavore

2-Depozitime kuaternare-Holocen i hershem:-alQh -aluvione te taraces separe ; alevrite, rera, zhavore.

3-Depozitime Kuaternare–Pleistocen-Holocenkoluvione, deluvione, proluvione-argjila, alevrolit zhavore.

4.- Depozitime te Neogenit - Tortonianit molasa; -alevrolite , argjila, ranore me shtresa qymyro re (formacioni Mezezi).

Bazuar ne kriterin litologjik dhe ujembajtjen e shkembinjve qe ndertojne rajonin klasifikojme tre grupe (Harta Hidrogeologjike) :

I.Shkembinj te shkrifet

1.Me ujembajtje te larte. Depozitime kuaternare-Holocen i hershem:-alQh1-aluvione te taraces se pare;alevrite, rera, zhavore.

2.Me ujembajtje mesatare. Depozitimet kuaternare - Holocen i vonshem:aluvione te shtratit rera, zhavore . Depozitime kuaternare Holocen i hershem:-aluvione te taraces se pare (alevrite, rera, zhavore)

II. Shkembinj kompakt :-Me ujembajtje te ulet. Depozitime te Neogenit- tortonianit N13t(d)-molasa; -alevrolite, argjila, ranore me shtresa qymyrore (formacioniMezezi).

III. Shkembinj praktikisht pa uje1. shkembinj te shkrifet. Ne depozitime te shkriфта praktikisht pa uje bejnepjese depozitimet e Kuaternar-Pleistocen i siperm-Holocen-c,d,pQp3-h, koluvio ne,deluvione, proluvione te perfaqesuara nga argjila, alevrite,zhavore

4.6–Cilesia e ajrit dhe zhurmat

- **Ajri** . Në bazë të të dhënave te monitorimit , ajri urban ne kete zone rezulton i pastër për 4 treguesit e monitoruar, SO₂, NO₂, O₃, dhe Pb të cilët rezultojnë brenda normave të lejuara të Standa rdit Shqiptar dhe të BE në të gjitha stacionet dhe qytetet e monitoruara.

Monitorimi i ndotjes atmosferike nëpërmjet analizës elementare të aerosoleve, konfirmon se përmbajtja e metaleve toksike në ajrin urban në qendër të Tiranës rezulton në vlera mjaftmë të ulëta se normat e lejuara.Kurse elementet e lidhur me pluhurin tokësor, si K,Ca, Ti dhe Fe janë në përqëndrime më të larta.

Në përgjithësi erërat mbizotëruese vijnë nga anët veriperëndimore dhe juglindore të objektit. Ky fillad freskues detar mund të vërehet veçanërisht gjatë periudhës së verës. Për të vlerësuar situatën në lidhje me cilësinë e ajrit u përdorën të dhëna mbi ndotësit e ajrit të marra nga stacionet matëse ekzistuese më përfaqësuese dhe më pranë zonës së projektit.

Cilësia e tanishme e ajrit në zonën e Projektit është tepër e varfër: ne pjesën perëndimore të dhënat e matura japin një vlerë mesatare vjetore të matur të PM₁₀ (grimca me masë 10 micrometer ose më pak) prej 354 µg/m³. Në pjesën lindore PM₁₀ është 96 µg/m³. Këto vlera duhen krahasuar me standardin shqiptar për këtë parametër që është 70 µg/m³ dhe standardin Evropian që është 40 µg/m³ (që duhet pakësuar në 20 ne te ardhmen).

Ndotësit e ajrit mund të jenë grimca pluhuri, kimikate apo materiale biologjike, të cilat kanë efekte mbi organizmin e njeriut, mjedisin apo atmosferën. Disa nga grupet më të rëndësishme të indikatorëve të cilësisë së ajrit janë:

SO₂, NO_x dhe NH₃ (amonjaku), të cilët shkaktojnë edhe shirat acide;

CO₂, CH₄ (metani), NO₂, të cilët lidhen me emëtimin e gazrave;

PM₁₀, LNP, që tregojnë masën e grimcave të ngurta në ajër.

Secili prej këtyre indikatorëve, shkaktohet nga arsye të ndryshme. Historikisht, ndotësit kryesorë të ajrit në Shqipëri kanë qenë industritë e kromit, bakrit, metalurgjiku celikut, cimentos dhe TEC-et,etj. Duke nisur që nga vitet '90, një pjesë e madhe prej tyre u mbyll. Në vitet e fundit, ndotja ka ardhur kryesisht nga nxjerrja dhe përpunimi i naftës, prodhimi i cimentos, djegia e pakontrolluar e plehrave si dhe rritja e transportit.

Të dhënat mbi NO₂ dhe SO₂

Dioksidi i Azotit (NO₂) dhe Dioksidi i Squfurit (SO₂) janë pjesë përbërëse e smogut dhe shkaktarë të shirave acidë. Ata krijohen nga djegia e qymyrit, naftës dhe derivatëve të saj. Secili prej tyre depërton shumë lehtë në organizmin e njeriut dhe mund të shkaktojë sëmundje të mushkrive, të rrisin mundësinë e marrjes së viruseve si dhe irritime të syve apo lëkurës. Në ndërveprim me diellin dhe ujin në atmosferë, këto dy gazra shndërrohen në acide, të cilat bien në tokë në formën e shiut acid apo borës.

Në Shqipëri, normat e lejuara të këtyrë gazrave në atmosferë janë përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 4.12.2003, “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”. Ato janë mesatarisht 60 µg/m³ në vit për secilin indikator, apo 50% më të larta se normat e përcaktuara nga Bashkimi European, i cili ka një mesatare prej 40 µg/m³.

Prezenca e NO₂ në zonat urbane vjen kryesisht si pasojë e transportit dhe trafikut në rritje. Në një shikim të përgjithshëm, mund të thuhet se prezenca e këtyrë ndotësve është nën normat e vendosura nga Shteti Shqiptar, por edhe nën normën europiane. Listën e qyteteve më të ndotura me NO₂ e kryeson Tirana dhe pas saj Durrësi dhe Fieri. Një pamje më e qartë vjen nga raporti mjedisor për vitin 2009 i Ministrisë së Mjedisit, sipas të cilit zona e 21 Dhjetorit në Tiranë është mbi normat e lejuara nga BE me 12 µg/m³ apo 30% më shumë. Situata me SO₂-shin është gjithashtu brenda parametrave të lejuar nëpër qytete. Fieri vazhdon të ketë një normë të lartë, por edhe Elbasani, pasojë e industrive që kanë funksionuar në këto zona. Prezenca e SO₂-shit është nën mesataren e BE-së, dhe në këtë ndihmon shumë prodhimi i energjisë elektrike nga burimet hidro.

Keto te dhena jane marre nga Ministria e Mjedisit , Pyjeve dhe administrimit te ujrave .

- **Zhurmat .**

Ky objekt do te ndertohet ne rruget kryesore te hyrjes per ne qytetin e Fushe Krujes ndaj e ka te pashmangshme zhurmen e mjeteve qe qarkullojne ne kete zone .

Duke iu referuar ligjit Nr.7994 , dt.12.07.2007 , ”Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis “ investitori ka marre te gjitha masat per zhurma sa me vogla ne kete aktivitet qe kerkon te zhvilloje nepermjet :

- a) përzgjedhjes dhe përdorimit të pajisjeve që lëshojnë zhurmë të niveleve të ulëta,
- b) përzgjedhjen e vendit, që instalimi dhe funksionimi i mjeteve e pajisjeve që lëshojnë zhurmë, të garantojnë nivelin kufi në të gjitha mjediset, të cilat ndikohen prej saj ,
- c) masat parandaluese e zbutëse të zhurmës në pikën e lëshimit , përgjatë rrugëve të përhapjes dhe në mjediset që ndikohen prej saj.

Burimi i akumuluar i zhurmave nga puna e motokompresorit ne distance 7 ml nga to eshte 90 dB. Duke marre parasysh shprehjen e nivelit te intesitetit akustik te nje zhurme me relacion si me poshte :

$$L = 10 \lg (I_1 / I_0)$$

L - Niveli akustik i zhurmes se marre ne considerate.

I₁ - Intesiteti akustik i zhurmave te kumuluar.

I₀ - Intesiteti akustik i references.

Theksojme se niveli akustik i zhurmave ne qendren e banuar eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te, praktikisht ai eshte 32 – 40 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal.

Analiza e frekuences se zhurmave te emertuar nga keto makineri dhe paisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 200- 2000 Hz, e qe nuk eshte shqetesuese per veshin e njeriut, por me shume ndikohet nga zhurmat e mjeteve interurbane se sa mjetet e karrierve te aferta qe shfrytezojne kete rruge .

Shkaktari kryesor i ndotjes akustike për këto zone është trafiku i automjeteve dhe i kamionave me tonazh të rëndë që transportojnë materiale inerte apo të ndryshme ndërtimi. Frekuenca e levizjes së këtyre kamioneve nuk është shumë e lartë kështu që nuk shqeteson në çdo kohë.

Së pari, zhurma është përcaktuar si tingujt i padëshiruar. Gama e njohur ndërkomëtare degjimit fillon nga 0 dB (pragut i dëgjimit) deri në 140 dB (pragut të dhimbjes). Frekuenca e përgjigjes për veshin e njeriut merret zakonisht për të mbuluar gamën nga 20 Hz (numri i oshilacione për sekondë) deri 20.000 Hz. Veshi nuk i përgjigjet në mënyrë të barabartë frekuencave të ndryshme në të njëjtin nivel me presion të tingullit. Zhurmat janë më të ndryshme në rangun në mes të frekuencave sesa në frekuencat e fundme dhe për shkak të kësaj, i ulët dhe komponentet frekuencë të lartë të një tingulli ulin rëndësie për të aplikuar një koeficient (filtrim) për matjet e zhurmës.

Koeficienti i cili është përdorur më gjerësisht për matjen e zhurmave është A-koeficienti i cili shpreh reagimin subjektiv të njeriut ndaj zhurmave. Ky është një standard i pranuar ndërkombëtarisht për matjet e zhurmave për të përfaqësuar përgjigje subjektive të ndjesisë së njeriut për sa i takon zhurmave. Zhurma e tepruar dëmton seriozisht shëndetin e njeriut dhe ndërhyr me aktivitetet e përditshme të njerëzve në shkollë, në punë, në shtëpi dhe gjatë kohës së lirë. Ajo mund të prishin gjumin, të shkaktojë efekte kardiovaskulare dhe psiko-fiziologjike, të reduktojnë performancën dhe provokojnë reagime bezdisëse dhe ndryshime në sjelljen sociale. Organizata Botërore e Shëndetësisë vlerëson se zhurmë trafiku po dëmton shëndetin e pothuajse çdo person të moshës së tretë në BE si edhe një në pesë evropianë mendohet të jenë të ekspozuar rregullisht ndaj niveleve të larta të zhurmës gjatë natës të cilat mund të dëmtojnë në mënyrë të konsiderueshme shëndetin e tyre. Kur kuantifikimi i zhurmës është shqetësues; pranohej që në përgjithësi se, për gjendje të qëndrueshme nivelet e zhurmës rriten ose zvogëlohen me 1 dB (A) nuk dallohet nga qeniet njerëzore në kushte normale, edhe pse kjo mund të jetë e perceptueshme në kushte laboratorike. Një rritje ose ulje prej 3 dB (A) është normalisht vetëm pak e dukshme në kushte normale. Rritje e një zhurme është një parametër thjesht subjektiv, por ajo në përgjithësi është pranuar se një rritje / rënie prej 10 dB (A) i korrespondon një dyfishim apo përgjysmimi në rritjes/rënies së perceptuar.

Nivelet e zhurmave të jashtme rrallë janë të qëndrueshme, sepse rriten dhe bien në bazë të aktiviteteve përreth. Në përpjekje për të gjetur një parametër matës së zhurmës së jashtme variable është përdorur matësi i zhurmave. Parametri më i rëndësishëm për vlerësimin e zhurmave është ekuivalenti i vazhdueshëm A-ponderuar i presionit të tingullit në nivel LAeq. Ky është i pranuar ndërkombëtarisht përkufizohet si vlera e A-ponderuar e nivelit të presionit të një tingulli, apo të disa tingujve të vazhdueshëm e të qëndrueshëm që, brenda një intervali kohor të caktuar kohor (T), ka të njëjtën kuptim si të themi ndryshimi i presionit të tingullit në njësinë e kohës. Kjo është një njësi e përdorur zakonisht për të përshkruar zhurmën në proceset e ndërtimit, zhurma nga pajisjet industriale dhe është njësi më e përshtatshme për përshkrimin e shumë formave të tjera të zhurmës në mjedis. Monitorimi i zhurmave urbane kryhet nga Instituti i Shëndetit Publik ka pasur si qëllim matjen e nivelit të ndotjes akustike, në pikat e monitorimit të 7 qyteteve kryesore të vëndit tonë, për të dhënë mundësinë që të gjykohej mbi masën e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave. Kur niveli i zhurmave është rreth 65 dBA, gjumi bëhet shqetësim serioz dhe shumica e popullatës shqetësohen. Në këtë rast, zhurma në komunitet, bëhet një problem i vërtetë i shëndetit mjedisor. Aktualisht, zhurma është një nga rreziqet mjedisore, që vazhdon të evoluojë dhe mund të krijojë probleme tek ajo pjesë e personave që janë të ekspozuar. Veçanërisht, ndotja nga trafiku rrugor është bërë problematike dhe mjaft shqetësuese. Një tjetër ndikim, ka pasur dhe prania në distanca të konsiderueshme e burimeve alternative të përkohëshme të energjisë si: gjeneratorët.

Ndotja nga zhurmat është relativisht e ulët, ne varësi nga distancat prej burimeve të tyre. Kufirii lejuar për ndotjen nga zhurmat nga qarkullimi i automjeteve gjate ditës konsiderohet 65 dB, ndërsa gjatë natës 55 dB). Në zonën e projektit, nivelet e zhurmave janë nën nivelet e lejuara nga standartet nderkombetare.

4.7–Trashegimia , peisazhi dhe statusi i zones

Shqiperia njihet per diversitetin e pasur biologjik dhe peisazhik fale pozites se saj gjeografike, kushteve gjeologjike, pedologjike dhe hidrologjike, si edhe fale karakteri stikave klimaterike. Kjo larmi e madhe ekosistemesh ben te mundur ekzistencen dhe ruajtjen e varieteteve te pasura te bimesise dhe kafsheve.

Ritmet e larta dhe te shpejta te rritjes se popullsise ne 50 vjetet e fundit, shoqeruar me migrimin nga zonat rurale drejt atyre urbane jane shoqeruar edhe nga rritje progresive e trsynise njerezore ndaj sistemeve bregdetare dhe litorale, qe jane edhe sistemet me te ndjeshme nga pikepamja ekologjike.

Territori ne studim nuk eshte i perfshire ne menyre te drejtperdrejte ne zone te mbrojtur si rezervat, park kombetar etj. dhe nuk eshte zone e ruajtur ne perputhje me planet e zhvillimit ekonomik te vendit dhe ne strategjine kombetare te mjedisit .

Nuk eshte zone e përdorur per specie të mbrojtura , të rëndësishme të florës dhe faunës, si për kryqëzim, folenizim, ushqim, pushim, dimërim, migrim që mund të ndikohen nga zhvillimi i ketij aktiviteti .

Nuk eshte zone me rendesi historike apo kulturore dhe nuk ndikon ne rruget e kalimit te publikut apo njedise te tjera shplodhese , pushuese .

Nuk ka objekte arkitektonike , arkeologjike , kulturore dhe me interesa historike te ndertuar afer tij por nje distance te konsiderueshme .

Territori ne studim nuk eshte i perfshire ne menyre te drejtperdrejte ne nje zone buferike te cilat ruhen ne perputhje me legjistacionin e mjedisit dhe ne perputhje me politikat dhe planet qe aplikon MMPAU.

Më poshtë jepen zonat me vlere historike, kulturore dhe rekreative ekzistuese të trevës së Krujës me një përshkrim informativ dhe një vlerësim mbi secilën prej tyre.

RRETHI I KRUJËS									
NR	EMRI I MONUMENTIT	FSHATI	KOMUNA	BASHKIA	RRETHI	KATEG	INSTITUCIONI I SHPALLJES	Nr. VENDIMI	DATA SHPALLJES
1	KALAJA E KRUJES në qytetin e Krujes. Në qytetin e Krujes, në kuotën 608, i gjithë muri i rrethimit, duke përfshirë pyrgjet dhe galerinë që lidh kalatë me burimin e tashilajt, pjesët e mureve që e rrethojnë këtë burim si dhe portën kryesore bashkë me kalidremin. Përfshihet edhe kulla e sahatit.			KRUJE	KRUJE	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 e 4874	17.03.1948, 23.09.1971
2	KALAJA E ZGËRDHESHIT në fshatin Zgërdhesh në Lindje të Ures së Zeze, në Jug-Perëndim të fshatit Zgërdhesh, në kuotën 252, muret dhe gjithë kodra e kufizuar nga veriu e jugu me 2 perrenjte, nga lindja me qafen dhe nga perëndimi në arat e lagjes Kakariq.	ZGËRDHESH		FUSHË-KRUJE	KRUJE	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 e 4874	17.03.1948, 23.09.1971
3	KALAJA E DAULES në fshatin Daule	DAULE			KRUJE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
4	VARREZA E LASHTË e Krujes në qytetin e Krujes			KRUJE	KRUJE	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
5	URA NE LAGJEN EMIRAJ në qytetin e Krujes			KRUJE	KRUJE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
6	URA E ABDYL AGËS në fshatin Shkallë e Zeze	SHKALLË E ZEZE	NIKEL		KRUJE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
7	URA E KURCAJT MBI LUMIN E ZEZE në fshatin Kurcaj	KURCAJ	NIKEL		KRUJE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	786/1	15.11.1984
8	TERMAT ANTIKE NE FSHATIN, Burizane	BURIZANE	THUMANE		KRUJE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
9	KALLDREMI NE LAGJEN MECE në qytetin e Krujes			KRUJE	KRUJE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
10	PJESE E KALLDREMIT TE VJETER NE RRUGEN E DROJES NE INTERVALIN KROI I KRYESHKOZES - URA E DROJES, Kruje				KRUJE	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	2854	08.08.1980
11	PJESE E KALLDREMIT TE VJETER NE RRUGEN E GRYKES SE SHKALLES ZEZE, NDERTIMET FSHATARE, BUSHNESH DHE URES SE ABDYL AGËS, Kruje				KRUJE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	2854	08.08.1980

Shumë pranë qytetit shtrihen dy zona të mbrojtura të kategorisë së V “Zonë e peisazheve të mbrojtura” :

- ☞ Qafë Shtama-Liqejt e Germanjit
- ☞ Vargmali Krujë- Tujan

-Parku arkeologjik i Zgërdheshit– Halil. Ndodhet shumë afër fshatit Halil ose Zgërdheshit të poshtëm . Zona arkeologjike përbëhet nga kalaja qështrihet mbi një faqe kodre me një pjerrësi të konsiderueshme dhe nga njëzonë më poshtë kodrës që është tërësisht e pazbuluar dhe ku mendohet tështrihen rrënojat e një qyteti . Mendohet se këto rrënoja dhe kalaja ti përkasin qytetit të Albanopolit që përmendet në burimet antike dhe ka qenë qendra e fisit ilir të albanëve nga të cilët rrjedh edhe emri i sotëm i shqiptarëve . Muret rrethuese të kalasë janë të ndërtuar me blloqe gurë shkuadratik shumë të mëdhenj . Gjatë gjurmëve janë zbuluar gjetje të shumta ndër të cilat shumë monedha të prera në Dyrrah , Apolloni , Lisus , Korkyre , Maqedoni etj. Për nga vlerat e saj kjo zonë arkeologjike mendohe të kthehet në një atraksion turistik të rëndësishëm.

-Termat antike–Borizanë . Gjenden në fshatin Borizanë në Veri të qytetit . Këto gjetje arkeologjike janë shpallur monument kulture.

-Kisha Shën Qares(Kiares)– Arrameras. Kjo kishë ndodhet në Jug të qytetit në krahun e djathtë të rrugës Kamëz-Fushë Krujë . Kjo kishë dhe kisha Shën Martini i përkinin Dioqezës së Krujës në shekujt XIV-XVII . Në afërsi të kishës mendohet të jenë dhe rrënoja termash romake dhe për më tepër mendohet që aty të ndodhej qyteti antik Pistuli.

-Kisha Shën Martini–Zgërdhesh . Kjo kishë ndodhet në fshatin e sipërm Zgërdhesh dhe faktikisht nuk janë kryer akoma gjurmime për zbulimin e plotë të saj . Është e së njëjtës

periudhë si dhe kisha e Shën Qares.

-Kisha Shën Gjon Pagëzorit–Derven . E zbuluar së fundmi ne vitin 2007 kisha ndodhet në fshatin Derven ne Veri të qytetit . Një objekt i veçantë arkeologjik . Është kishë njënefshe e datuar kryesisht në shek.XIII-XIV ku janë zbuluar dhe pjesë afreskesh shumë interesante.Kisha është aktualisht e aksesueshme për vizitorët dhe turistët.

-Teqeja Shememi Babait–Fushë Krujë. Ndodhet pas zonës së serave në Veri Lindje të qytetit Këtu është qendra e gjyshitës së Krujës që përfshin rrethet Krujë , Durrës , Mat , Shkodër , Kurbin , Dibër dhe Bulqizë.


-Teqeja Gjymës së Shenjtë–Krujë . Ndodhet në krahun e djathtë të rrugës Fushë Krujë-Krujë pas degëzimit që të lidh me fabrikën e çimentos.

-Teqeja e Sari Salltëkut– Ndodhet në lartësinë 1.117 metra dhe është njëtjetër pikë e preferuar, veçanërisht për besimtarët bektashinj . Babai shenjtor , i cili rreth vitit 1325 i ktheu qytetit të Krujës ujin dhe dinjitetin e nëpërkëmbur, nderohet gjerësisht nga banorët vendas, ndërsa teqetë bektashiane të zonës vizitohen edhe si pika me vlera historike.

-Qendra Kurative Reumatizmale– Bilaj . Qendra është a funksionale jane bere investime të reja për të përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimin.

-Qafë Shtama-Liqejt e Germanjit– Zonë e peisazheve të mbrojtura Kategoria V me një sipërfaqe prej 3500 ha . Zonë malore e preferuar nga publiku për vlerat e saj të spikatura pejsazhore , estetike , shlodhëse dhe kurative . Mbulohet nga pyje me pishë dhe ah, ku takohet bima endemike Forsythia europea.

-Vargmali Krujë-Tujan–Zonë e peisazheve të mbrojtura Kategoria V menjë sipërfaqe prej 3800 ha.Zonë me vlera pejsazhore, kulturore dhe historike.Formacionë karstike të shprehura mirë si maja, kanione ;shkurreta mesdhetare të degraduara në kufirin e saj të poshtem, pyll ahu nëlartësinë mbi 900 m. Zona ndodhet pranë PK Mali i Dajtit dhe liqenit të Bovillës.



5.–Efektet e kesaj veprimtarie ne mjedis te drejtperdrejta dhe te terthorta

5.1 –Ndryshimet ne mjedis gjate ndertimit

Veprimtaria që propozohet të kryhet nuk ka përmasa të mëdha persa i takon vepres por ne aspekt të karakterit të investimeve po , pasi eshte shkolle ne mjedis qyteti , ne zone te banuar dhe historike , me rendesi historike dhe kulturore. Kjo është arsyeja që duke qene se punimet do kryhen ne zone te banuar normalisht del e një rëndësie të veçantë të analizohen ndikimet që do të ketë ajo që nga çasti i nisjes, pra e reabilitm/ndërtimit dhe më tej ende gjatë shfrytëzimit të saj.

Ky kapitull gjithashtu do të paraqesë një analize te hollesishme te ndikimeve te mundshme duke specifikuar edhe masat zbutese qe do te perdoren per te eliminuar apo per te minimizuar ndiki met ne mjedis. Kjo analize kryhet duke u bazuar ne projektin te diskutuar si me lart ne kete raport.

Për të analizuar ndikimet e mundshme ne mjedis gjatë periudhës së ndërtimit te kesaj shkolle rrugor së pari , jane veçuar përbërësit kryesorë të punimeve të ndërtimit.

Më pas, per secilin nga këto përbërës janë saktësuar ndikimet negative apo pozitive mbi mjedi sin si dhe masat e mundshme zbutëse ndaj tyre . Në fund jane pervijuar burimet dhe shkaqet e ndikime ve te mundshme .

5.1.1 –Ndryshimet ne mjedis gjate punimeve te germimit

Ndertimi i ketij kesaj shkolle fillimisht do te kerkoje ngritjen e kantjerit te punimeve sipas percaktimit te vendit qe do te vendoset ne bashkepunim te sipermarresit te punimeve dhe njesise se qeverisjes vendore ne njoftim dhe dijeni te supervizorit te punimeve dhe me pas do te behen germimet e percaktuara ne projekt – preventivin e hartu ar per kete lloj objekti me ane te mjeteve gërmues dhe largimi i materialit do të bëhet nga mjete vetshkarkuese apo kamionë të një tonazhi të caktuar.

Tek punimet e germimeve duhet nga njëra anë të mbrohen njerëzit, të cilët nuk janë të përfshirë në ndërtimin e projektit, e nga ana tjetër duhet të mbrohen njerëzit e inkluadruar në realizimin e projektit. Gjithashtu duhet mbrojtur kantjeri i punes ne menyre te panderprere gjate te gjithë kohes.

Cikli i germimit do te perfshije:

- Germimet e siperfaqeve te demtuara te trupit te shkolles qe do te rigjenerohen .
- Germimet per hapjen e gropes te reja te ketij aksi sipas parashikimeve dhe projektit ne me nyre qe te arrihen standartet .
- Germimet ne thellesite e percaktuar per hapjen e kanaleve te reja ne segmentet e reja te cilat do te behet konform projektit duke zbatuar te gjitha kushtet teknike te projektimit dhe zbatimit.
- Ngarkimin e materialit të gërmuar nëpër kamionë apo largimin e këtij materiali dhe depoziti min e tij në vendet e autorizuar nga njesia vendore
- Kthimin e automjeteve të transportit per ne zonen e ndertimit te projektit.

Mbrojtja e njerëzve të painkuadruar duhet bërë në atë mënyrë që të bëhet rrethimi (me gardh, rrjetë gabiant etj.) i vendeve qe do punohet ne lartesi ose thellesi i cili nuk i lejon ata (sidomos fëmijët) të rrezikohen. Gjithashtu, duhet vendosur tabela paralajmëruese me të cilën ndalohet kalimi i rrethimit nga persona që nuk punojnë në projekt.

Në rast se dheu përmban minerale, të cilat në kontakt me ujin e humbin stabilitetin, atëherë dheu dhe sidomos ledhi duhet të ruhet nga shiu duke e përforcuar me armatura mbajtëse sipas KTZ.

Materiali i përshtatshëm dhe materiali i rimbushur nga punë të përkohshme do të përdoren për rimbushjevetem me miratim dhe pelqim te supervizorit te punimeve .

Çdo material i tepërt do të jetë në dispozicion të mungesave të materialeve të

kërkuara. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishjet, do të kontrollohen më parë nga Supervizori dhe ripërdorimi i tyre do të autorizohet nga ai.

Ndikimet e mundshme gjate procesit te germimit ne menyre tabelore jane si me poshte :

Procesi	Ndikimi
Germimi	Cilesia e ujit
Ngarkim	Ekologjia e ujit
Shkarkim	Zhurma
Transport	Trafiku
	Zhurma, ndotje ajri, mbeturina

5.1.2 –Pritshmerite e ndodhive gjate ndertimit te objektit

Tërësia e proceseve ndërtimore që do të kryhen në këtë shkolle egzistues është ajo që kryhen përgjithësisht në çdo kantier ndërtimi , vendosja e piketave sipas percaktimeve ne projekt – preventivin e ketij objekti , realizimi i punimeve te germimeve dhe largimit te materialeve te dala nga germimi , ndertimi i veprave te artit si dhe nje ure te re ne Gomsiqe,germim për hapje traseje ne piketat te miratuar me pare , betonime të ndryshme , shtrime dhe veshje me pllaka betoni , puni met e kanalizimeve , pu nimet elektrike si dhe punime te tjera te planifikuara dhe te paplanifikuara qe mund et dalin gjate ndertimit te objektit .

Perdorimi i pajisjeve te pershtatshme , pershtatja me rregulloret nderkombetare dhe në pergji thesi zbatimi sipas standarteve dhe teknikave me te mira te ndertimit, jane nje kerkese thelbesore per zgjedhjen e kontraktoreve dhe plotesimin e suksesshem te projektit. Kjo do te sjelle perfitime te duk shme per zbutjen e ndikimit te ndertimeve ne mjedis.

Toka

Ndërtimi dhe përdorimi i vazhdueshëm i shkolles nuk mund të çojë në zhdukjen e tokave bujqësore pasi ky projekt do te zhvillohet ne territorin egzistues dhe nuk kemi prekje te siperfaqes se tokes bujqesore . Ndikim do kemi vetem ne shfrytezimin e tokave kot qe nuk shfrytezohen ne afersi me godinen e re . Ndikimi do të jetë i përhershëm dhe i pakthyeshëm. Megjithatë, ndikimi mund të kufi zohet me ruajtjen e duhur dhe ripërdorimin e dherave për restaurimin përgjatë argjinaturave rrugore dhe të mbushjen e gropave ose për të përmirësuar tokën diku gjetkë. Prandaj, humbja e tokës bujqësore është konsideruar të ketë një ndikim të vogël.

Mbetjet ose derdhjet aksidentale gjatë ndërtimit ose shfrytëzimit (p.sh. lëndë djegëse, vajra, lubrifikante, çimento, etj) kanë potencial për të ndikuar në tokën ekzistuese dhe cilësinë e saj. Megjithatë, metodat e mira të ndërtimit praktikë si të përshkruara në paragrafin e mesiperm mund të përdoret për të shmangur ose kufizuar potencialisht nga ndikimet e tilla. Prandaj, ndikimi i mbetur është konsideruar të jetë i parëndësishme (negativ). Çdo ndikim do të jetë i përkohshëm dhe të ulet me kalimin e kohës.

Ndryshimet në kënde të pjerrëta gjatë ndërtimit të shkolles apo karakteristika të tjera përgjatë rrugës (p.sh. hapja e gropave apo parkingjet) mund të çojë në ndryshime të tokës / stabilitetit të saj dhe mund të shkaktojë erozion . Ndikimet e tilla do të jenë të rëndësishme në një shkallë lokale.

Ndikimet e tilla potenciale mund të shmangen në fazën e projektimit ose të kufizohen përmes përdorimit të masave lehtësuese. Prandaj, ndikimi i mbetur është konsideruar të jetë e parëndësishëm (negativ).Ndikimi do të jetë i përhershëm dhe i pakthyeshëm.

Relievi

Shumë prej ndikimeve të mundshme në reliev në gjurmën e rrugës së propozuar do të ndodhin gjatë fazës së ndërtimit dhe mund të minimizohen përmes projektimit ose mund të zbuten duke ndjekur metoda të mira të ndërtimit në praktikë. Këto masa do të përfshijnë si më poshtë:

→ Kontrolli gjeoteknike dhe procesi i projektimit do të identifikojnë vendet se ku do të jetë e nevojshme të merren masat zbutëse të tilla si mure mbajtëse të shpateve, ose bio-inxhinierike (p.sh., përdorimi i bimëve për të rritur qëndrueshmërinë e tokës)

→ Të gjitha punimet do të ndërmerret në përputhje me standardet e miratuara shqiptare. Në rast të ndonjë rasti specifik (për të cilën ka boshllëk legjislativ), projektuesi mund ti referohet Eurocodeve përkatëse të publikuara.

→ Mund të ketë pjese ku mund të kërkohej dhe për tu përdorur për qëllime të tilla si mbushje anësore ose për rregullim të peisazhit pra në këtë kontekst duhet që dhe të hiqet me kujdes.

→ Të ndërtohet me parametrat e duhur, duke marrë parasysh ngarkesën maksimale dhe kushtet gjeologo- inxhinierike të truallit.

→ Kërkesë e domosdoshme për punimet e ndërtimit të shkollës së re, është transporti dhe depozitimi i dherave të germimeve në terrene të paracaktuara.

→ Kujdes të lartë gjatë manovrimit të automjeteve

→ Të ndërtohet me parametrat e duhur, duke marrë parasysh tjetërsimin e këtyre shkëmbinjve nga faktoret atmosferike.

→ Të ndërtohet me parametrat e duhur, duke marrë parasysh kushtet gjeologo- inxhinierike të truallit; dhe mikrozonimin sizmik të sheshit të ndërtimit dhe më gjerë.

→ Të ruhen themelet e këtyre veprave nga erozioni. Duhet të merret në konsideratë dhe të lihen korrode natyrore dhe të vendosen tombina nën rrugë.

→ Duhet të zbatohen standardet e përshtatshme të kullimit për të zbutur impaktin e mundshëm të erozionit të dherave.

→ Teknikat e mira të ndërtimit në praktikë do të përdoren për parandalimin e ndotjes së tokës si dhe do të përdoren metodat e duhura të largimit të mbetjeve për të zbutur efekte të mundshme të derdhjeve aksidentale apo rrjedhjet e karburantit, naftës ose lubri fikantëve apo shllamit që mund të krijohej nga depozitimi i mbetjeve ose aktiviteteve të trajtimit të ujërave të zeza

→ Metodat më të mira të ndërtimit do të ndiqen përpërdorimin e pajisjeve të përshtatshme personale mbrojtëse (PPM) të cilat do të përdoret për të ndihmuar në zbutjen e rrezikut potencial për shëndetin e njeriut në rast se gjatë ndërtimit mund të hasen materiale ndotëse.

Gjeologjia

Ndërtimi i godinës së shkollës mund të çojë në krijimin e ekspozimeve të reja gjeologjike. Këto mund të kenë potencial arsimor dhe kërkimor. Si të tilla, ndërtimi i rrugës mund të ketë një (të dobishme) ndikim i moderuar. Ky efekt do të jetë i përhershëm dhe i pakthyeshëm.

Trajtimi i tyre me masa mbrojtëse mund të stabilizojë qëndrueshmërinë e shkëmbinjve. Projektimi dhe praktikatat e mira të ndërtimit do të kufizojnë potencialin për këtë gjë. Masat zbutëse do të përdoret gjithashtu për të përmirësuar stabilitetin e shkëmbinjëve, aty ku do të shihet e nevojshme. Prandaj, ajo është konsideruar se ndikimi i në këtë pikë ka të ngjarë të jenë i parëndësishëm (negativ). Çdo mungesa e stabilitetit të shkëmbinjve ka të ngjarë të jetë i përkohshëm, por i pakthyeshëm nëse ndodh ndonjë shkarje.

Në kohën e përgatitjes së këtij raporti nuk ka vende të rëndësishme që janë paracaktuar për rëndësinë e tyre gjeologjike. Prandaj ndërtimi dhe shfrytëzimi i shkollës nuk do të ndryshojë asgjë në këtë drejtim.

Hidrologjia

Shumë nga ndikime të mundshme në mjedis mund të kufizohen përmes projektimit duke ndjekur metoda të mira të ndërtimit në praktikë. Këto masa do të përfshihen si më poshtë:

- Të gjitha punimet do të kryhen në përputhje me standardet e ngjashme të miratuara. Atu ku është e praktikueshme, projektimi i të gjitha strukturave të rrugës do të jetë në përputhje me Eurocodet perkatese të publikuara . Kjo norme dhe standart detyron shume nderhyerje pjesore per nje shmangje nga drejtimi i tanishem me devijime te vogla .

- Aty ku është e mundur të shfrytëzohen guroret ekzistuese që ndodhen në afërsi të rrugës së planifikuar do të shfrytëzohen këto përpara se të krijohen gropa të reja të marrë me qera.

- Për të mos reduktuar burimet që shërbejnë për furnizimin e ujërave nëntokësore apo që mund të sjellin problem në furnizimin me ujë të komuniteteve lokale duhet të merren në konsideratë faktorë si: stina e pranverës (ku këto ujera kanë potencialin më të lartë prurës), ose periudha e verës kur këto burime kanë prurje të ulët; faktorë të cilët të konsiderohen në kohëzgjatjen e punimeve.

- Aty ku reduktimi i sasisë së ujërave është e nevojshëm dhe burimet e ujërave nëntokësore (p.sh. burimet e përdorura për furnizimin me ujë) janë identifikuar në zonën e projektit atëherë mund të merren masat lehtësuese të tillasi kufizimi në kohë apo vëllimi i sasisë së ujit për të reduktuar ndikimin ose mund të kryhen furnizimet alternative të cilat gjithsesi do të kushtëzojnë kohëzgjatjen e punës. Duhet të theksohet se këto aktivitete mund të duhet një leje sipas Ligjit të Burimeve Ujore të Shqipërisë.

- Aty ku përdorimi i ujërave nëntokësore është propozuar për furnizim me ujë gjatë fazave të ndërtimit dhe shfrytëzimit të rrugës, duhet të bëhet vlerësimi i duhur i efekteve të mundshme që mund të ketë ky proces në furnizimin e komuniteteve lokale dhe të ndërmerren dhe masat zbutëse. Aty ku është praktike dhe e arsyeshme, mund të përdoren furnizime alternative të ujit për popullsinë lokale kur pusët lokale apo burime shtrihen brenda korridorit shkolles. Duhet të theksohet se marrjen e ujërave mund të duhet një leje sipas Ligjit të Burimeve Ujore të Shqipërisë.

- Standardet e kullimit të përshtatshme gjatë projektimit dhe gjatë ndërtimit do të zbatohen për të zbutur ndikimin e mundshëm në cilësinë e ujërave nëntokësore nga clirimi i substancave të rrezikshme (p.sh. naftës dhe ndotësve të tjerë);

- Metodot më të mira të ndërtimit në praktikë do të përdoren për parandalimin e ndotjes së tokës si dhe do të përdoren praktikët e duhura të largimit të mbetjeve për të zbutur efektet e mundshme të derdhjeve aksidentale apo rrjedhjet e karburantit, naftës ose lubrifikantëve apo shllamit që mund të krijohet nga depozitimi i mbetjeve ose aktiviteteve të trajtimit të ujërave të zeza;

- Çdo automjetet dhe pajisje e përdorur gjatë ndërtimit do të mirëmbahet dhe të inspektohet rregullisht për rrjedhjet e karburantit, lubrifikantët dhe vaji, dhe pajisjet e duhura do të jenë në dispozicion në kantier për të eliminuar derdhjet të vogla;

- Të gjitha karburantet do të ruhen sipas udhëzimeve të mira të praktikës, duke përfshirë depozitat me një vëllim minimal e ruajtjes së 110% të kapacitetit të depozitës

- Shkarkimet nga çdo mjet apo pas larjes së gomave do të mbledhen dhe riciklohen kur është e mundur dhe jo të shkarkohen në tokë;

- Tepriat e ujit nga larja e makinerive do të depozitohen brenda një zonë nga e cila duhet të hiqen mbetjet apo balta para shkarkimit të ujit.

- Punimet në tokë mund të çojnë në rritjen trupave të ngurtë pezull në ujërat nëntokësore dhe burimet do të minimizohen nga sasia e përgjithshme e tokës së ekspozuar ndaj punimeve të ndërtimit, themeleve etj.

- Të gjitha mbetjet nga prishjet që dalin gjatë ndërtimit do të klasifikohen dhe të eliminohen në përputhje me legjislacionin përkatës;

- Ujërat e zeza që rrjedhin nga çdo WC portative nese do perdoren te tilla të hidhen në konteinerë të vulosura, të cilat duhet të zbrazen periodikisht në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza.
- Duhet të mbahet një rregjistër i vecantë për të gjitha llojet e mbetjeve të gjeneruara.
- Protokollet dhe metoda më të mira të ndërtimit do të ndiqen për përdorimin e pajisjeve të përshtatshme personale mbrojtëse (PPM) të cilat do të përdoret për të ndihmuar në zbutjen e rrezikut potencial për shëndetin e njeriut në rast se gjatë ndërtimit mund të hasen materiale infektive;
- Në kantier do të bëhet një inspektim për të vëzhgurar (nese ka) ndotje të ujërave apo të tokës, kjo në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane;
- Do të bëhet një vlerësim i duhur i rrezikut dhe rehabilitimit për të punësuarit në vende ku mund te konstatohet ujëra apo tokë e ndotur me qëllim marrjen e masave parandaluese.
- Sistemet e kullimit do të jenë të projektuara për të kufizuar depërtimin e vajrave, karburanteve apo trupave e ngurtë pezull, në sistemin e ujërave nëntokësore ose burime. Sigurimi i zonave të punimeve me prita do të kufizojnë ndikimin e mundshëm dhe ndalimin e depërtimit të ndotësve në ujërat nëntokësore dhe tokë.
- Një përdorim sa më i përshtatshëm i herbicideve për të kontrolluar rritjen e bimëve përgjatë autostradës, dhe përdorimin e kripërave të rrugës do të bëhet në minimum.

Aty ku ka potencial për burimet e ujërave nëntokësore (duke përfshirë pusët, kanalet dhe burimet) do të zbatohen të gjitha masat e përmendura më lart. Para ndërtimit dhe të zbutjes së ndikimit, situata bazë (p.sh. cilësia e ujit dhe normat e rrjedhjes) do të përcaktohet përmes monitorimit. Gjatë gjithë ndërtimit, duhet të bëhet mbikqyrja e nevoj shme në mënyrë që të ruhen njëjtat parametra për të siguruar që mos të ndodhë asnjë rënie në cilësinë e ujit ose fluksit të prurjes që shpesh ndodhin si rezultat i zhvillimit të punimeve rrugore. Nëse identifikohet një rënie e fluksit apo cilësisë duhet verifikuar edhe shkaku si edhe të merren masat e duhura zbutëse të vënë në vend situatën.

Në paragrafet e mëposhtme diskutohen parametrat me kuptimplotë dhe masat që janë marrë.

5.2 –Ndikimet në fazën e ndërtimit

Ndërtimi do të bëhet sipas një projekti bashkëkohor dhe që në fazën e projekt idese është konsideruar që do të zbusë ndikimet mjedisore .

Shkolla tanishme , ka qenë në gjendje jo të mirë përse i përket vendqendrimit , dhe gjatë ndërtimit të tij shumë kohe më parë nuk janë marrë parasysh problemet e tanishme dhe këtu kemi parasysh edhe ndërtimin e tyre shumë kohe më parë.

Nepermjet vlerësimit të ndikimit në mjedis i cili nuk është thjesht për të vlerësuar apo karakterizuar mjedisin, por më tepër për të ndikuar në projektim që të bëhen zgjidhjet sa më të mira si edhe për të siguruar që përpjekjet për të zbutur efektet negative të reflektohen në projekt . Kriteri për të arritur në vlerësimin e efekteve mjedisore mund të konsiderohet si një lloj formule.

Në shumicën e rasteve gjenerimi i një vlerësimi të ndikimit në mjedis mundëson raportimin mbi rëndësinë e një ndikimeve të caktuara sipas një shkalle vlerësuese :

Humultime të dhenash	Situata ekonomike -sociale- mjedisore	Fazat e projekti	Raportimi ndikimeve	Përfshirja e miniraportit
Rishikim i rregulloreve	Mbledhja e të dhenave të gjurmës së projektit	Punimet e projektit	Risistemimi(mini raporti)	Përfshirja e Planit Veprimi
Vizita në terren përpara hartimit të projektit	Analizimi dhe krahasimi	Raporti bazë	Plani Veprimi	Monitorimi dhe vlerësimi

Qëllimet	Baza	Vlerësimi i ndikimit	Planet menaxhuese	Implementimi
----------	------	----------------------	-------------------	--------------

Rëndësia e efektit është formuluar si një funksion i receptorit ose ndjeshmërinë ndaj ceshtjeve mjedisore të zonës si edhe madhësisë së ndikimit të projektit në mjedis. Me fjalë të tjera, kriteret të rëndësishme janë përdorur për të raportuar efektin e ndikimit. Përshkruesit dhe kriteret për ndjeshmërinë e mjedisit të aspekteve të mjedisit janë të shënuara në tabele me poshte :

Ndjeshmëria	Përshkrimi
Shume e lartë	Rendësi shume e madhe, në nivel ndërkombëtar dhe potencial i limituar për tu zëvendësuar .
E lartë	Rendësi madhe në nivel kombëtar dhe potencial i limituar për tu zëvendësuar
Mesatare	Rendësi madhe, në nivel rajonal dhe potencial I limituar për tu zëvendësuar.
E ulët	Rendësi mesatare në nivel lokal dhe potencial te limituar për tu zëvendësuar
E parëndësishme	Rendësi e ulet ne nivel lokal

Përshkrimi tipik dhe kriteret që përcaktojnë madhësinë e një ndikim nga një projekt:

Ndjeshmëria	Përshkrimi tip
I madh	Humbja e burimeve mjedisore apo vecoria e tyre; e burimeve; dëmtimi i rëndë i karakteristikave kryesore, apo elementeve të rëndësishëm anësorë
	Nivel i lartë apo përmirësim i madh i cilësisë së burimeve; re-staurimi i gjerë ose përmirësim; përmirësim i madh itributeve cilësorë (të dobishme).
I moderuar	Humbja e burimeve, por nuk që ndikon negativisht në vecoritë e tij; humbja e pjesshme e / dëmtim të karakteristikave kryesore, ose karakteristikave të elementeve (anësore).
	Përfitim për të, ose shtimi të karakteristikave kryesore, apo karakteristikave të elementeve; përmirësimi itributeve të cilësisë (përfitues).
I vogël	Disa ndryshim të matshme ose dobësim të të, një apo më shumë prej karakteristikave kryesore, ose karakteristikave të elementë (negativ).
	Përfitim i vogël për burimin ose shtimi i një apo më shumë të karakteristikave kryesore ose karakteristikave të elementë ndikimi i dobishëm në cilësi ose një rrezik të reduktuar të ndikimit negativ që ndodh ndodh (përfitim)
E parëndësishme	Humbje shumë të vogla ose ndryshim në dëm të një ose më shumë karakteristikave (anësore)
	Përfitime shumë të vogla për të ose shtesa pozitive e një ose më shumë karakteristikave, ose karakteristika të elemente (të dobishme)
Ska ndryshim	Nuk ka humbje ose ndryshim të karakteristikave, ose karakteristika

	të elementeve; asnjë ndikim i dukshëm në asnjë drejtim.
--	---

Shkalla në përcaktimin e rëndësisë së ndikimit duhet të mbështetet në argumentin e arsyetuar , gjykimit profesional dhe duke marrë në konsideratë dhe pikëpamjet e organi zmave përkatës . Për disa zëra, efektet e parashikuara mund të krahasohen me kufijtë sasiorë të nivelit të tyre për shkallën e rëndësisë. Caktimi çdo efekt në një nga pesë kategoritë e shkallës së rëndësisë, mundëson që çështje të ndryshme tematike do të vendosen në të njëjtën shkallë, në mënyrë që të ndihmojë procesin e vendim-marrjes në çfarëdo fazë të projektit në kuadër të të cilit është ky proces. Këto pesë kategori të rëndësisë janë dhënë si me poshte :

Kategoria treguese	Përshkrimi tip i efektit
Shume e gjerë	Vetëm efektet anësore janë të caktuar normalisht këtë nivel të rëndësisë. Ato përfaqësojnë faktorë kyç në procesin e vendim-marrjes. Këto efekte janë të përgjithsme dhe jo detyruesisht të, lidhur me tiparet e rëndësishme ndërkombëtare, kombëtare apo rajonale ku mund të ketë një ndikim të dëmshëm ose humbjen e vecorive të burimit. Megjithatë, ndryshimet e mëdha në një vend apo peisazh me rëndësi lokale mund të hyjnë në këtë kategori
E madhe	Këto efekte të dobishme apo negative konsiderohen si shumë të rëndësishme dhe mund të jenë material për tu marrë në konsideratë në procesin e vendim-marrjes.
E moderuar	Këto efekte të dobishme apo negative mund të jetë të rëndësishëm, por jofaktorë kyç në procesin e vendim-marrjes. Efektet kumulative e faktorëve të tillë mund të ndikojnë në vendim-marrjen vetëm në rast se ato të çojnë në një rritje të efektit të përgjithshëm negativ në një burim të veçantë ose përdoruesit e këtij burimi
I lehtë	Këto efekte të dobishme apo negative mund të ngrihen si faktorë lokalë. Ato nuk ndikojnë në procesin e vendim-marrjes, por janë të rëndësishëm në etapa të mëvonshme të projektit.
Neutral	Nuk ka efekte apo ata që janë nën nivelet e perceptimit, brenda kufijve normalë të normave të lejuara.

Është e rëndësishme të theksohet se kategoritë treguese janë të nevojshme si për efektet pozitive (të dobishme), ashtu dhe ato negative (negative). Pesë kategoritë treguese mundësojnë gjetjen e tetë rezultateve të mundshme. Duke aplikuar formulën, ndjeshmërinë më e madhe e mjedisit apo vlerën e receptorit ose të burimit, si dhe madhësinë e ndikimit, më i saktë do të përcaktohet efekti.

Pasojat e një ndikimi negative në burim do të ketë një efekt shumë të rëndësishëm negativ.

Tendenca për zbutjen e ndikimeve të negative mundshme mjedisore është për ti shmangur ato kudo që të jetë e mundur.

Kjo do të arrihet duke marrë parasysh mënyrat për të parandaluar efektet negative në burim, para se të mendohet për marrjen e masave zbutëse të mëvonshme. Kjo është arritur përmes përzgjedhjes së kujdesshme dhe projektimit të rrugës duke shmangur zonat e ndjeshme mjedisore.

Metodika e zhvilluar në këtë në këtë raport identifikon edhe rrugët dhe mënyrat për përzgjedhjen e masave për parandalimin e fenomeneve si rrëshqitja e dherave, e shpateve etj, duke zhvilluar më tej analizën me qëllim projektimin sa më të mirë të mureve mbajtës vertikalë dhe horizontal për të minimizuar ndikimet negative në mjedis.

Masa të tjera zbutëse do të merren parasysh dhe do të përfshihen në mbrojtjen apo

përmirësimin e karaktersitikave të mjedisit apo në cilësinë e punimeve të tilla si: specifika të veçanta të punime tokësore, të levishmërisë, të shëndetit të njeriut etj .

Variabli i ndikimit

Nuk ndryshon							E parëndësishme	E vogël	E moderuar	E lartë
Vlera mjedisore(ndjeshmëria)	Shume e lartë	Neutral	E lehtë	E moderuar ose e madhe	E madhe ose shumë e madhe	Shumë e madhe				
	E lartë	Neutrale	E lehtë	E lehtë ose e moderuar	E moderuar ose e madhe	E madhe ose shumë e madhe				
	mesme	Neutrale	Neutral ose e lehtë	E lehtë	E moderuar	E moderuar ose e madhe				
	E ulët	Neutrale	Neutral ose e lehtë	Neutrale ose e lehte	E lehtë	E lehtë ose e moderuar				
	E parëndësishme	Neutrale	Neutrale	Neutrale ose e lehtë	Neutrale ose e lehtë	E lehte				

5.2.1–Masa te rekomanduara ne fazen e ndertimit

Per minimizimin e ndikimeve negative mjedisore rekomandohet :

- Të evitohet në maksimum rrjedhja e vajrave nga automjetet dhe mjetet e ndërtimit (ekskavatore, fadroma, vinca, betoniera, etj.)
- Të parashikohen mjete dhe mundësi për mbledhjen e vajrave ne rast derdhjeve aksidentale në toke dhe ne rrjetin e kanaleve kullues e vadites si edhe te kontraktohen subjekte të pocacme të cilat merren me trajtimin e tyre.
- Vendosja e mureve mbajtës apo pritave në zonat ku do të konstatohet rreziku i rreshqitjes së dherave
- Të shtrohen me beton siperfaqet e pastrimit te automjeteve, ato te ndrimin te vajit te tyre si dhe siperfaqet e stokimit te substancave te tjera ndotese.
- Bitumi, bojrat dhe lendet e tjera toksike te perdoren me kujdes, per te mos ndotur token dhe ujrat.
- Marrja e masave për parandalimin e rreshqitjve të dheut, shpateve apo erozionit gjatë fazes së ndërtimit.
- Të evitohet ne maksimum ngjeshja e tokave bujqësore përreth siperfaqes se objektit;
- Punimet e mundshme jashtë gjurmes se objektit, te kryhen në mot të thatë, dhe kur toka nuk eshte e lagur
- Të evitohet ne maksimum rrjedhja e vajrave, karburanteve nga mjetet e ndertimit (ekskavatore, fadroma, vinca, betoniera, etj.)
- Te mblidhen në njëvend te caktuar,në ene të papershkueshme,ne kantierin e ndertimit , mbeturinat e vajrave, grasove, etj.
- Vendi ku mendohet se mundësia e derdhjes pertoke te vajrave dhe grasove, te mbulohet nga një shtresë e papershkueshme nga këto lënde.
- Të mbahen ne gatishmeri produkte qe thithin keta ndotës

Tabela 5.1 Permbledhje e vleresimeve te ndikimit ne mjedis

Parametri mjedisor	Burimi	Vlera e ndikimit		
		E ulet (U)	Mesatare (M)	E Larte (L)
Zhurma	Gjate ndertimit	U		
Mbeturinat	Gjate germimit	U		
	Gjate ndertimit	U		
Ndotja e ajrit	Pajisjet e ndertimit	U		
	Levizjet e makinave		M	
	Levizjet e punetoreve	U		
	Pluhur nga aktivitetet		M	
Ndotja e ujit	Kullimi	U		
	Mbetje te tjera	U		
Ndikimi ne trafik	Levizjet e makinerive		M	
	Levizjet e punonjesve	U		

Makinerite e nevojshme per kete ndertim jane :

- Eskavatore me kove per germim
- Buldozer
- Autobetoniere
- Kamione te tonazheve te ndryeshme
- Sheshues nivelues siperfaqe rrugore
- Asfaltoshtruese
- Bitumatrice
- Makineri dhe pajisje qe mund te kerkohen gjate operacioneve te ndryeshme per perfundimin e plote te rikonstrukcionit te ketij aksi rrugor
- Kontejnere per grumbullimin e mbetjeve ditore .

5.2.2–Peisazhi dhe bukurite natyrore

Ky kapitull paraqet vlerësim e ndikimit në mjedis dhe në bukuritë natyrore i cili mbështetet mbi vëzhgimim në terren dhe studime të pëparshme të zonës ne Qarkun e Krujes . Gjithashtu janë vlerësuar të dhënat e mbledhura nga trashëgimi kulturore dhe bukuritë natyrore të mirënjohura të zonës.

Hapat kryesore në kryerjen e Vlerësimit të Ndikimit në peisazh dhe në bukuritë natyrore janë si më poshtë:

- Mbledhja e të dhënave ,puna në terren dhe studim të literaturës për këtë qëllim
- Përshkrimi i peizazhit bazë
- Klasifikimi peisazhit
- Identifikimi i ndikimeve të mundshme pozitive dhe negative në peisazh dhe në bukuritë natyrore.
- Vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të identifikuara.

Ky raport i përshkruan si vijon:

a.Shkalla e përputhshmërisë me politikat e qeverisë dhe dokumente shtesë që lidhen me peizazhin

- b. Venndodhja e rrugës, ekzistuese në kontekstin i peizazh
- c. Metodologjia e vlerësimit;
- d. Vlerësimi i peizazhit ekzistues karakterit të tij, cilësia dhe ndjeshmëria ndaj rrugës

së propozuar;

e. Ndikimet e mundshme të rrugës në peizazh

f. Ndikimi potencial i rrugës mbi elementët kyç të peizazhit dhe masat e mundshme zbutëse për këtë qëllim.

Ligjet shqiptare përcaktonjë sistemin për mbrojtjen e natyrës dhe krijon kërkesat bazë për ruajtjen e natyrës dhe për përdorimin e saj të qëndrueshëm, në veçanti:

a. Ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës dhe burimeve natyrore të rinovueshme;

b. Restaurimi i zonave të dëmtuara të mbrojtura të natyrës dhe të habitateve të tyre natyrore dhe specieve;

c. Mirëmbajtja dhe restaurimi i ekuilibrit ekologjik të natyrës;

d. Krijimi i sistemit të planifikimit, të menaxhimit, të informacionit dhe të financimit për mbrojtjen e natyrës;

e. Realizimi i qëllimeve të përcaktuara në politikat për mbrojtjen e natyrës;

f. Reduktimi i mbi-përdorimit dhe dëmtimit të specieve të tëra të florës dhe faunës, veçanëri sht llojeve me rëndësi, si dhe habitateve të tyre;

g. E drejta e publikut për informim dhe e drejta e pjesëmarrjes në ruajtjen e natyrës;

h. Të sigurojë të drejtën e qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm, dhe aksesin në bukuritë natyrore për pushim dhe rekreacion;

i. Sigurimin e biodiversitetit përmes ruajtjes së habitateve të rëndësishme natyrore dhe llojeve me rëndësi të florës dhe faunës së egër;

Mbrojtja e peisazhi dhe bukurive natyrore synon të arrijë;

1. Karakteristikat e ekosistemeve dhe llojeve të rralla dhe të rrezikuara;

2. Karakteristikat e peisazhit të promovuar si turistik

3. Vlerat rekreative të peisazhit dhe bukurive natyrore.

Leja mjedisore do të jepet vetëm nëse projekti i propozuar nuk ndikon negativisht mbi karakteristikat natyrore të peizazhit ose të llojeve të rëndësishme të habitateve dhe bukurive natyrore.

Ndikimi negativ, sipas pikës 2 ndodh në qoftë se një projekt i propozuar mund të shkaktojë:

☞ Ndikimi negativ tek një ose më shumë të specieve të rëndësishme ose të llojeve të rëndësishme habitatit; ose

☞ Në qoftë se pritet që të shkaktojë një parregullsi të mëdha në funksionimin e ekosistemit.

Për interesa publike, duke përfshirë dhe ato të sociale apo ekonomike do të bëhet një vlerësim i dyte (Analiza SWOT)

Duke iu referuar propozimeve të rrugës ligji përcakton se:

Autoritetet kompetente do të ndërmarrin hapat e duhura për të shmangur, përkeqësimin e habitateve natyrore dhe habitatet e specieve, si dhe prishjen e zonave me ndjeshëri të lartë.

Çdo projekt i propozuar mund të ketë një efekt të rëndësishëm në menaxhimin e peisazhit të zonës qoftë individualisht apo në kombinim me projekte të tjera duhet të subjekt i vlerësimit të duhur të ndikimit të tij dhe autoritetet kompetente dhe palët e interesuara mund të bien dakord me projektin e propozuar vetëm pasi të jetë konstatuar se projekti nuk do të ndikojë negativisht në integritetin e zonës në fjalë;

Në rast të ndikimeve negative por kur megjithatë duhet projekti të kryhet për arsye të mëdha të interesit publik, duke përfshirë ato të një natyre sociale apo ekonomike, autoriteti kompetent do të kërkojë të marren masat e nevojshme kompensuese për të siguruar koherencën e përgjithshëm të ekosistemit në fjalë.

Shkalla e rendesise per kuptimin e efekteve

Shkalla e rendësisë(për kuptimin e efekteve)	Efektet
E rende	Efektet që do të merren në konsideratë sepse receptori dhe burimi është dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme
E madhe	Efektet që mund të kthehen në çështje që kërkojnë vendimmarrje.
E moderuar	Efektet që kanë mundësi të vogla për t'u bërë çështje dhe që mund ti zgjidhi projekti por ku mund të nevojitet një vlerësim në të ardhmen
E vogel	Efektet janë në nivel të rëndësishëm lokal
E parendesishme	Efektet që janë përtej kriterëve aktual të vlerësimit ose parashikimit ose brenda kapacitetit të peizazhit për të pranuar ndryshimin.

Faktoret qe ndikojne ne peisazhin e zones

- Rrallimi ose zëvendësimi i peizazhit
- Karakteristikat specifike të pamjen së zonës apo peizazhit
- Përdorimi aktual i tokës ekzistuese
- Shkalla dhe konturet e peisazhit
- Pamja dhe shpërndarja e receptorëve vizuale
- Zbutja e peisazhit me këtë zonë
- Cilësi dhe vlera të njohura në peisazhin ose pamjen e qytetit.

Vleresimi i cilesise se peisazhit

Vlerësimi i peisazhit dhe ndikimet vizuale nga godines se propozuar bazohet në dy fazat e zhvillimit : në përfundimin e rrugës dhe pastaj në 15 vjet paspërfundimit. Vlerësimi bazë është supozuar të jenë të këtij viti (2016) dhe përfshin propozime standarde zbutëse.

Në kohën e vlerësimit ndikimet e ndërtimit janë vlerësuar me informacionin e dhënë nga projektuesit e rrugës si edhe nga mbiqyrja e terrenit.

Kjo metodë vlerësimi shërben për të ofruar një nivel më të lartë të të kuptuarit të ndonjë të mundshëm dhe ndikimit në peisazh apo vizual përmes një periudhe kohore dhe konsideron zhvillimin e propozimeve të lehtësimit. Cilësia e peisazhit është vlerësuar në bazë të renditjes në pesë shkallë të caktuar në MNRRU Vëllimi 11, neni 3, Pjesa 5 .

Cilesia Peisazhit	Pershkrim i peisazhit
E lartë	Struktura shumë e fortë peisazhi, model karakteristik
	Kombinim i balancuar i kontureve të tokës dhe mbulesës së tokës;
	Menaxhimit i përshtatshëm për përdorimin e tokës dhe mbulesës së saj;
	Karakteristika shumë të mira të ruajtura
	Vlera unike në vendin e vet;
	Nuk ka karakteristika të hequra

Shumë tërheqës	Strukturë e fortë e peizazhit, modele karakteristike dhe kombinim i balancuar i kontureve të tokës me mbulesën e saj
	Menaxhim i përshtatshëm për përdorimin e tokës dhe mbulesën e saj por me potencial zhvillues
	Peisazh me karakteristika të forta të ruajtura
	Peisazh me ndjeshmëri të fortë;
	Peisazh me ndonje karakteristike të hequr sipas rastit
E mire	Struktura e këndshme peizazhi, modele karakteristike dhe kombinime të kontureve të tokës dhe të mbulesës së saj janë ende evidente;
	Mund të kryhen disa veprime për të përmirësuar menaxhimin mbi përdorimin e tokës dhe mbulesën e saj .
	Disa karakteristika të forta të ruajtura
	Peisazh me ndjeshmëri
	Disa karakteristika të peisazhit të hequra.
E zakonshme	Strukturë e dallueshme peizazhi, modele karakteristike të kontureve të tokës dhe të mbulesës së saj shpesh janë maskuar me përdorimin e tokës;
	Ka vend për të përmirësuar menaxhimin për përdorimin e tokës dhe mbulesën e saj
	Ndonjë tipar i ruajtur
	Karakteristika shpesh të hequra
E varfer	Strukturë e dobët ose degraduar peizazhi, modelet karakteristike të kontureve të tokës dhe mbulesës së saj janë të mbuluara dhe maskuara me përdorimin e tokës;
	Mungesa e menaxhimit dhe ndërhyrjes në peisazh ka rezultuar në degradim.
	Nuk ka tipare të ruajtura
	Karakteristika të shumta janë hequr.

Vlerësimi i peisazhit dhe zonave të ndjeshme

Vlerësimi i shkallës së ndjeshmërisë së peizazhit apo pamjes së zonës së banuar gjatë procesit të ndryshimit reflektohet në shkallën në të cilën peizazhi është në gjendje për tu përshtatur me ndryshimin (për shkak të llojit të zhvillimit apo të ndryshimit të përdorimit të tokës) pa efekte të kundërta mbi karakterin e saj. Kjo mund të ndikohet nga shkalla e kontureve të tokës ekzistuese ose atyre të reja nga vegjetacioni ekzistues ose i mbjelljes së re. Këto dhe faktorë të tjerë përcaktojnë dukshmërinë e zhvillimit të propozuar dhe për këtë arsye mund të ndikojnë në shtrirjen e efektit dhe në karakterin e perceptuar dhe krijimit të një peisazhi komod përreth zonës së banuar. Ndjeshmëria e pamjes dhe peisazhit të zonës së studimit është vlerësuar duke përcaktuar aftësinë e peizazhit / pamjes së zonës për të pranuar ndryshimin si rezultat i zhvillimit të propozuar pa dëmtime të shkallës së lartë apo që mund të dëmtojnë cilësinë e peisazhit.

Faktoret për vlerësim të ndjeshmerisë

Shume e Larte	Kur është shumë tërheqës dhe i rrallë;
	I njohur ndërkombëtarisht nga organizatat ndërkombëtare (trashëgimia botërore)
	Peisazh jo i qëndrueshëm
	Peisazh me cilësi të rralla
E larte	Rendësi e lartë dhe peisazh i rrallë
	I cilësuar nga shkalla kombëtare për nga rëndësia;

	Qëndrueshmëri shume e ulët e peisazhit
	Peisazh shumë tërheqës
Mesatar	Peisazh tipik me vlera të larta
	Peisazh i njohur në shkallë rajonale
	Peisazh me potencial te lartë për ndërhyrje
	Peisazh me cilësi të larta
E ulët	Peisazh monoton ose i degraduar
	I njohur vetëm në shkallë lokale
	Potencial për ndërhyrje
	Peisazh i zakonshëm
	Peisazh i dëmtuar ose i parëndësishëm
	Peisazh ku ka pasur ndërhyrje
	Shkallë lokale
Parendesishem	Cilesi te varfra

Shkalla e ndikimeve mbi peizazh ose në pamjen e zonës mund të jetë e kundërt (negative), e pandryshueshme apo i dobishëm (pozitive). Përcaktimi i shkallës së ndikimit është i bazuar kryesisht mbi natyrën e zhvillimit të propozuar dhe rezulton në përfundimin se si ndryshon peizazhi apo pamja e qytetit, si dhe nga kohëzgjatja e efekteve të ndryshimit (dmth i përhershëm ose i përkohshëm).

Për të vlerësuar madhësinë e ndikimit që rezulton nga opsionet e projektit, direktivat Europiane përcaktojnë standartet krahasuese e cila në thelb është një shkallë zbritëse e ndikimeve duke filluar nga “jo-shumë i madh).

I madh	Jo i favorshëm Propozimet rezultojnë në shtimin e tipareve ose elementet të reja të pazakonta dhe sjell një humbje totale ose një shkallë dëmtimi të rëndë të karakteristikave kryesore, dhe elementeve që kontribuojnë për peizazhi apo pamjen e zonës, dhe efektet janë afatgjatë dhe të pakthyeshëm.
	Idobishëm Propozimet ofrojnë shkallë të madhe apo përmirësim të madh për cilësinë e peizazhit nëpërmjet restaurimit ose zgjerimit të mundësive përmes heqjes së përbërëse jotë zakonta të peizazhit dhe shtimin e tipareve të reja të përshtatshme për karakterin e peizazhit.
E moderuar	Jo i favorshëm Propozimi formon një tipar të ri të dukshëm, të pazakontë ose që rezulton në humbje të pjesshme apo dëmtim të karakteristikave kryesore, elementeve dhe karakteristika që kontribuojnë në peizazhin apo pamjen e zonës, dhe ku dhe ku efektet mund të jenë afatgjatë ose të pakthyeshme.
	Përfitues Propozimet ofrojnë përmirësim të pjesshëm ose të dukshëm në shtimin e, karakteristikave kryesoretë peisazhit, të cilat të rezultojnë në një përmirësim të cilësisë së peizazhit.
	Jo i favorshëm Disa ndryshime të vogla dhe të matshëm kur propozimi përbën një tipar të vogël në peizazhit apo pamjen e zonës dhe rezulton në humbje të vogël ose dëmtim të karakteristikave kyçe, dhe efektet janë afatshkurtër dhe afatmesme.

E ulët	I dobishëm Propozimet ofrojnë përmirësim të lehtë nga restaurimi i karakteristikave të ekzistuesve apo nga heqja e disa karakteristikave të pazakonta dhe shtimin e karakteristikave dhe elementëve kryesorë të peizazhit,
E	Jo I favorshëm Propozime për humbje të vogla të cilësive apo elementëve të peizazhit dhe ku efektet mund të jenë afatshkurtër ose të kthyeshe
	i dobishëm propozime për nderhyrje të lehta që ndikojnë fare pak në karakteristikat e peizazhit
Pa ndryshim	Nuk ka humbje ose shndërrim të karakteristikave ose elementeve të peizazhit apo pamjes së zonës Nuk ka ndikim të dukshëm i të dobishëm ose të kundërt

Rëndësia e ndikimit mbi peisazh

Rëndësia e ndikimit të parashikuar që mund të rezultojë nga zhvillimi i propozuar do të varet nga madhësia e ndikimit dhe ndjeshmërinë e receptorit.

Zona të ndjeshme ku madhësia e ndryshimit është parashikuar që të jetë e vogël mund të rezultojë që të jete më e madhe psh e moderuar.

Duke përdorur madhësinë e ndikimeve dhe vlerësimin e ndjeshmërisë së peizazhit në receptorët vizuale me poshte tregojme se si bëhet një vlerësim fillestar për rëndësinë e efekteve për secilin komponent. Kjo matricë është një mjet që shërben për të kontrolluar për të siguruar që vendimet në lidhje me ndjeshmërinë, madhësinë e ndikimit dhe rëndësinë e efektit janë të balancuara.

Matrica e rendesise se efekteve

ndjeshmëria	Shume e lartë	Neutrale	lehtë	E moderuar ose e madhe	E madhe ose shume e madhe	Shume e madhe
	lartë	Neutrale	Lehtë	E moderuar ose e lehtë	E moderuar ose e madhe	E madhe apo shume e madhe
	mesatare	Neutrale	Neutrale ose e lehtë	Lehtë	Moderate	E moderuar ose e lartë
	ulët	Neutrale	Neutrale ose e lehtë	Neutrale ose e lehtë	Slight	E lehte ose e moderuar
	parëndësishme	Neutrale	Neutral	Neutrale ose e lehtë	Neutrale ose e lehtë	E lehtë
		Ska	parendësishme	E vogël	E moderuar	E madhe
		Madhësia e ndikimit (e demshme apo përfituese)				

Përfitim shume i madh(efekt pozitiv)	Shumë pak propozime, edhe nës ka ndonjë mund ta meritojë këtë vlerësim Sigurimi i një mundësie për zgjerim të madh.
Efektet positive	Mundësi të mëdha të zbutjes së dëmtimeve apo ripërtëritjes së karakteri skave të humbura më anë të ndëryrjes në peisazh Karakteristika të humbura ose të dëmtuara nga bujqësia intensive, mungesa e menaxhimit ose zhvillimit jot ë qëndrueshëm. Propozimet ofrojnë mundësi për të rritur peisazhin sepse: -Ata përshtaten shumë mirë me shkallën, konture e tokës dhe modelin e peizazhit; -Mundësi të mëdha të zbutjes së dëmtimeve apo ripërtëritjes së karakteriskave të humbura nga mungesa e menaxhimit apo zhvillim të qëndrueshëm më anë të ndëryrjes në peisazh -Masa që do të mundësojnë restaurimin ose zgjerimin e vendit, shkallës dhe cilësisë së peizazhit nëpërmjet mbjelljes së projektuar mirë dhe masave zbutëse, të cilat mund të rrisin cilësinë e karakteristikave nëpërmjet përdorimit të materialeve dhe specieve lokale të cilat përshtaten me peizazhin; - Masa që mundësojnë që disa cilësi të peisazhit mund të restaurohen përmes masave përfituese dhe të ndjeshme të peisazhit të hartuara gjatë fazës të projektimit, masa të cilat joanë njohur zyrtarisht. -Objektiva te caktuara ne planet rajonale te qeverise per ripërteritjen e peisazhit
Përfitim i moderuar(efekt pozitiv)	Propozime : -Modelimi mirë në shkallë, në kontureve të tokës dhe të peizazhit; -Integrimi i masave zbutëse për të siguruar se ata do të ndërthuren mirë me peizazhin përreth - Ruajtja ose përmirësimi i karakteristikave të peizazhit ekzistues në një
Efekte neutrale	Propozimet janë të projektuara mire për: -Për të plotësuar shkallën, konturet e tokës dhe modelet e peizazhit; - Për të integruar masa zbutëse që sigurojnë se skemat do të harmonizohen mirë me veçoritë dhe elementët e peisazhit përreth; -Për të shmangur efektet e bezdisshme dhe për të mos pasur efekt negative në nivelin aktual të qetësisë së peizazhit përmes të cilit rruga kalon; - Për të ruajtur karakterin e peizazhit ekzistues në një zonë që nuk është një peizazh të caktuar, që nuk është as me vlera kombëtare apo lokale me cilësi të lartë, që nuk është e ndjeshme apo ta ndryshoje atë. - Për të shmangur konfliktet me institucionet përgjegjëse të mbrojtjes zonës
Humbje e lehte (efekt negative)	<i>Propozime:</i> -Kur nuk përshtaten me mjaft konture të tokës apo modelin e peisazhit -Edhe pse jo shumë vizualisht të bezdisshëm, do të ndikojnë në pikëpa mjet e caktuara në të gjithë zonën; -Prek një sipërfaqe ose cilësinë e njohur të peizazhit; -Nuk mund të zbutet plotësisht për shkak të natyrës së propozimit apo karakterit të peisazhit nëpërmjet të cilave rruga kalon; -Konflikt me politikat e autoriteteve lokale për mbrojtjen e karakterit lokal të peisazhit
Humbje e moderuar (efekt negative)	<i>Propozime:</i> -Kur janë jashtë shkallës së peisazhit ose në kundërshtim me modelin lokal dhe konturet e tokës; -Kur janë vizualisht të bezdisshëm dhe do ndikoni negativisht mbi peizazhin; -Kur është e pamundur për të zbutur plotësisht ndikimin; zbutja nuk

do të parandalojë skemën nga dëmtimi i peisazhit në terma afatgjatë dhe disa nga karakteristikat e peisazhit do të shkatërrohen ose do të reduktohen pjesërisht.

- Kur do të ketë një ndikim negativ në cilësisë të njohura të peisazhit ose mbi karakteristika të prekshme dhe të rëndësishme të tij
- Kur do të ketë një konflikt me politikat lokale dhe kombëtare për të mbrojtur tokën bujqësore.

Humbje e madhe
(efekt negative)

Propozimet janë shumë të dëmshme për peizazhin në këto raste:

- Kur janë në kundërshtim të konsiderueshëm me konturet etokës, shkallës dhe modelit të peizazhit;
- Kur janë vizualisht të bezdisshëm dhe do të ndërpresin fushëpamjet e bukura dhe me vlerë të zonës;
- Kur ka të ngjarë të degradojnë, të pakësojnë ose të shkatërrojnë integritetin e një gamë të karakteristikave karakteristike apo elementeve të zonës me vendosjen e tyre;
- Kur janë të dëmshëm në thelb të një cilësie të lartë apo peisazhi shumë të rrezikuar, duke shkaktuar në të ndryshimin apo pakësuar ndjeshëm cilësinë e tyre
- Kur nuk mund të zbutet në mënyrë adekuate

Humbje shume e madhe
(efekte negative)

Propozimet do të rezultojë në ndikime jashtëzakonisht të rënda negative në peizazhin kur ato:

- Ato janë në kundërshtim të plotë me konturet e tokës, shkallës dhe modelit të peizazhit;
- Ato janë shumë vizuale dhe jashtëzakonisht të bezdisshëm, duke shkatërruar fushëpamjet e bukura dhe me vlerë të dy anët e rrugës dhe të gjithë zonës;
- Ato shoqërohen me dëmtime apo degradime të pakthyeshmeose që mund të shkatërrojnë përfundimisht karakteristikat e peisazhit.
- Ato do të shkaktojë një dëmtim shumë të lartë në cilësinë e peisazhit ose mund ti ndryshojnë ato në mënyrë të pakthyeshme.
- Kur nuk mund të zbutet më dhe kur asnjë masë tjetër nuk mund ta rikuperojë.
- Kur nuk mund të pajtohet me politikën e qeverisë për mbrojtjen e zonave

Vleresimi i ndikimeve pamore

Ndikimi pamor është rezultat i një ndryshimi që mund të vijë nga aplikimi si kemës (rrugës) se propozuar në një receptor të identifikuar. Receptorët tipike përfshijnë; shtepi banimi, ambientet publike, ndërtesat qeveritare.

Receptorët grupohen sipas vendndodhjes së tyre, parashikimit të pamjes dhe llojit dhe ndjeshmëria e receptorëve lidhet kryesisht me tre faktorë:

1. Venndodhja e receptorëve dhe konteksti i këndvështrimi;
2. Veprimtaria apo qëllimi për të cilin është vendosur receptori në një pikë të caktuar.
3. Rëndësia e pamjes (e cila mund të përcaktohet në lidhje me popullaritetin e saj ose numrin e njerëzve të cilët mund të preken direct nga ndikimi i ndryshimit të pamjes).

Duke përdorur këto faktorë receptorët më të ndjeshëm mund të përfshijnë:

- Pronarët e pronave me pamje të prekura nga zhvillimi;
- Përdoruesit e të gjitha objekteve me natyrë rekreative duke përfshirë dhe përdoruesit e rrugës, vëmendja dhe interesi i të cilëve mund të jenë të fokusuar në peizazh.

Receptorët pak të ndjeshme mund të jenë njerëzit në vendin e tyre të punës, apo të angazhuar në aktivitete të ngjashme, vëmendja e të cilëve mund të jenë e fokusuar në punën e tyre dhe, për këtë arsye, janë më pak të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në pamje. Përdoruesit e shkolles janë të përfshirë edhe në këtë kategori, si receptorë kalimtarë.

Vleresimi i madhësisë së ndikimit në pamje ;

Shkalla e ndikimit pamor	Përshkrimi
E madhe	I pafavorshëm Propozimi është shumë i dallueshëm dhe sjell dëmtime të rënda për karakteristikat kryesore, apo karakteristikat e elementëve të tjerë që ndikojnë në pamje, dhe po ashtu që ndikojnë dukshëm në karakteri e përgjithshëm vizual të zonës
	I dobishëm Propozimi është i dallueshëm dhe sjell përmirësim në shkallët e lartë për karakteristikat kryesore të peizazhit, apokarakteristikat e elementëve që kontribuojnë në pamje. Propozimet përmirësojnë dukshëm karakterin e përgjithshëm vizual të zonës.
E moderuar	I pafavorshëm Propozimi formon një tipar të ri të dukshëm dhe që rezultojnë në dëmtim të pjesshëm të karakteristikave kryesore, apo karakteristikave të elementëve që kontribuojnë në pamje. Dallohet një përkeqësim i pamjes ekzistuese
	I dobishëm Propozimi formon një tipar të ri të dukshëm dhe që rezultojnë në përmirësim të pjesshëm të karakteristikave kryesore, apo karakteristikave të elementëve që kontribuojnë në pamje. Një përmirësim i dukshëm në pamjen ekzistuese.
E vogël	I pafavorshëm Disa ndryshim të matshme ose ku propozimi formon një tipar të vogël në peisazhit dhe nuk do të ndryshojë bilancin e përgjithshëm të karakteristikave të peisazhit apo karakteristikave të elementëve që kontribuojnë në pamje. Një përkeqësim i dukshëm që nuk do të ndryshojë bilancin e përgjithshëm të tipareve apo elemente në pamjen ekzistuese.
	I dobishëm Disa ndryshim të matshme ose ku propozimi formon një tipar të vogël në peisazh dhe nuk do të ndryshojë bilancin e përgjithshëm, karakteristikave ose karakteristikave të elementeve që përbëjnë pamjen ekzistuese. Një përmirësim i vogël i dukshëm të karakteristikave kryesore që kontribojnë në pamje.
E parëndësishme	I pafavorshëm propozimi rezultojnë në humbje shumë të vogla në karakteristikat e peisazhit, apo karakteristikat e elementeve që kontribojnë në pamje .Propozimi do të të vlerësohet pak
	I dobishëm propozimet rezultojnë në përmirësim shumë të vogla në karakteristikat e peisazhit, apo karakteristikat e elementeve që kontribuojnë në pamje Propozimi do të të vlerësohet pak
E pandryshueshm	Nuk ka humbje ose ndryshim i karakteristikave ose elemente të cilat kontribuojnë në pamje. Asnjë pjesë e propozimit do të jetë e dukshme

Rëndësia e ndikimit në pamje është llogaritur duke pasur parasysh ndjeshmërinë e receptorit ndaj madhësisë dhe kohëzgjatjes së efektit. Domethënia është arritur duke ndjekur referencat në tabelën e matricës së mëposhtme . Për shembull, rëndësia e ndikimit vizual është më e lartë për receptorët e ndjeshëm ku ka efekte në shkallë të gjerë në një pamje për një periudhë të gjatë

kohore. Tabela e mëposhtme është një udhëzues për mënyrën se si ndikimi vizual i zhvillimit të propozuar është vlerësuar në këtë raport .

5.2.3 – Cilesia e ajrit

Çlirimet e gazrave në ajër që lidhen me ndertimin e vepres mund të ndodhin nga dy burime të pavarura:

→ Çlirime ndotesish nga djegiet e makinave private dhe atyre të ndertimit, me motor me djegie të brendshme.

→ Pluhur që del nga levizja e makinave mbi rruget e pashtuara në sheshin e objektit .

→ Pluhuri që del nga punimet e germimit të puniemve të palnifikuara

Çlirimet e gazrave në ajër që lidhen me ndertimin , për dy tipet e burimeve që u përme ndën , ndryshojnë sipas llojeve të veprimtarive dhe lidhen me fazat e ndryshme tipike të një projekti ndertimi.

Kështu mund të dallohen fazat e mëposhtme të këtyre çlirimeve në projekt e vepres:

- Pergatitja e zonës për ndërtim që përfshin punimet e germimit dhe levizjen me makineri të renda për zhvendosjen e dheut apo masave të shprehullta, ngarkimin e materialeve, trafikun e automjeteve në rrugë të pashtuar të mjedisit;
- Largimi i mbeturinave të pengesave natyrore dhe atyre të krijuara nga dora e njeriut, të cilat mund të përfshijnë hedhjet në erë, shperthimet, heqjet mekanike, ngarkim/shkarkimet e materialeve .
- Ndertimi i pergjithshëm i punimeve të brendshme dhe të jashtme

Çlirimet e gazrave dhe pluhurave në ajër nga keto veprimtari të zakonshme ndertimi përfshijnë:

Normat e lejuara të EU

Ndotësi	aplikimi	Limiti	Matja	Data e arritjes së objektivit
		200 µg/m ³		
Dioksidi i azotit (NO ₂)	Europe	Nuk duhet të kalojë më shumë se 18 herë/vit	Mesatarja në 1 orë	
Oksidi I nitrogjenit (NO _x)	Europe	40 µg/m ³	Mesatare vjetore	
			Mesatare vjetore	

		30 µg/m ³		
		40 µg/m ³	Mesatare vjetore	
Grimcat pezull (PM10)	Europe	Nuk duhet te kalohet më		
		shume se 18 herë/vit		
		50 µg/m ³	Mesatare ne	
			24 orë	

- ⇒ Çlirimet e gazta nga djegiet (COV, NO_x, CO, SO_x, PM10) nga makinerite e renda levizese me dizel apo benzine, paisjet ndihmese portative si dhe automjetet e transportit të punonjesve ,
- ⇒ Pluhurat qe dalin (PM10) nga punimet e prishjes dhe germimi i dheut apo nga shëmbjet e ndryshme që ndodhin në kantier.

Tabela 5.2 Te dhena mbi clirimin e gazeve nga makinerite e ndertimit

Pajisja	CO [gh ⁻¹]	COV [gh ⁻¹]	NO _x [gh ⁻¹]	Sox [gh ⁻¹]	Dust [gh ⁻¹]
Makinë shtrimi, Eskavatorë dhe Buldozerë me rrota gome, Ekskavatorë të vegjël me rrota aktive	259.58	113.17	858.19	82.5	77.9
Autobetoniere, Rul, Autovinç, Kamjon, Traktor me rrota gome Autobot	816.81	86.84	1889.1	206	116
Vinç, Grup gjeneratori, Kompresor ajri, Saldatriçe, Çekiç pilotash	306.37	69.35	767.3	64.7	63.2

Ndonëse dihet që pajisjet e ndertimit çlirojnë ndotësa të mjedisit, ndikimet pritet të jene minimale per disa arsye.

Gjate pergatitjes se zones nuk do kete shembje objektesh sepse sheshi i propozuar i projektit mbi të gjitha është i kufizuar dhe nuk ka nevojë për një nivelim të tij për shkak të vetë gjëndjes momentale të vendndodhjes së sheshit.

Mjetet qe do te perdoren ne ndertim do te mirëmbahen rregullisht gjë qe do te sjelle si pasoje një djegie të mirë te karburantit si dhe çlirime minimale te ndotesve te rastit si :

- monoksidi i karbonit dhe materialet pluhurore si PM10 dhe PM2.5.

- numri i mjeteve të transportit të mallrave apo edhe i punëtorëve do te jete i ulet dhe per rrjedhoje ato nuk do te krijojnë ndikim te ndjeshem negativ. Persa i perket perhapjes se pluhurave , duhet bere kujdes i madh pasi zonat e banuara jane shume afer nga sheshi i propozuar i projektit.

Sidoqofte, perhapja e pluhurit nga rruget dhe sheshi ndertimit mund dhe duhet te eliminohen apo minimizohen duke aplikuar masat e duhura zbutese, si :

- Realizimi sa me shpejt dhe me lagie me uje te rrjedhshem i punimeve te prishjes ne varesi te kushteve atmosferike
- Perdorimi i lagies me uje te materialit te dale nga germimi ne menyre te tille ne perputhje me lageshtiren e momentit qe mos krijohet balte por mos dale pluhur gjate manovrimeve per ngarkim dhe transport jashte sheshit te ndertimit .

- Kufizimi i shpejtesise se mjeteve transportuese
- Perdorimi i hinkave per betonet dhe materialet e tjera qe mund te gjenerojne pluhur

Keto clirime dhe ndikimet e tyre mund te konsiderohen te neglizhueshme, duke pasur parasysh kohezgjatjen e kufizuar te fazes se ndertimit te pontilit te struktures per kontroll automjetesh .

Vleresimi i rrezikut nga pluhuri

Gjurma	Kriteret	Vlerësimi
19 km	Footprint i projektit (65 km)	Rrezik mesatar
	Afersia me receptoret e ndjeshëm (20 to 100 m)	Rrezik
	Shtrirja e punimeve të shkatërrimit	Rrezik i ulet
	Shtrirja e punimeve të gërmimeve (gërmime 75 km)	Rrezik ilartë risk
	Kërkesa për nguljen e pilotave (po)	Rrezik mesatar
	Kërkesa për betonim (po)	Rrezik i lartë
	Zgjatja e punimeve	Rrezik i lartë
	Tipi i kamioneve qe do përdoren	Rrezik mesatar
	Numri i veturave qe do të pëdoren(>100)	Rrezik mesatar
Vlerësimi i rrezikut		Mesatar/I lartë

Në çdo rast, pamvarësisht nga proceset që do të kryhen, cilësia e ajrit nuk do të dëmtohet jasht standarteve të parashikuara. Kështu , ditet me te keqia do te ndodhnin gjate proceseve te zhvendosjes se dherave sidomos kur këto procese do të kryheshin në stinën e thatë të verës.

Ne literaturen teknike jepet vlere reference 0.15-0.30 kg/ m³ muaj per clirimet e pluhurave qe perhapen ne mjedis. Keto çlirime mund te konsiderohen te pranueshme. Rikthimi i pluhurit ne toke, ne fakt, supozohet se do te jete shume i vogel dhe do te ndodhe vetem ne zonen prane sheshit të ndërtimit , keshtu qe nuk do te shkaktoje shqetësime mbetese për zonën rrethëqark .

Tabela 5.3 Standartet e cilesise se ajrit dhe shkarkimet ndotese ne mjedis

Autoriteti	Ndotësi	Vlerat mesatare të elementëve ndotës					
		SO ₂			NO _x		
		Vjetore	24 h MAX	Ditore	Vjetore	24 orë Max	Orare
Banka Boterore		0.10	0.5 (jasht)	1.0 (brenda)	0.05 ppm	-	0.05
SHBA		0.02pp m[a] 0.03pp m[b]	0.1ppm [a] 0.14ppm [b] 0.5ppm [ac]	-	0.05 ppm	-	-
WHO		-	90µg/m ³	-	-	-	190- 320 µg/m ³
UE		80 µg/m ³	-	-	200 µg/m ³	-	-

[a]-Dytësore të bazuara në ndikimet mjedisore

[b]-Parësore të bazuara në ndikimet shendetesore tek njerezit

[c]-Maksimumi prej tre oresh nje here ne vit

IFC ka nxjerrë udhëzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me ndërtimin dhe funksionimin e rrugëve. Udhëzimi përfshin një numër të metodave të mundshme për kontrollin e pluhurave dhe efikasitetin e tyre në kontrollin e pluhurave gjatë fazës së ndërtimit të rrugëve. Udhëzimet e IFC formojnë një orientim eficient për masat zbutëse të propozuara nga praktika për kontrollin e pluhurit gjatë ndërtimit dhe punimeve të mirëmbajtjes.

Të rekomandueshme për tu zbatuar janë ato të detajuara në Tabelën e mëposhtme në të cilat IFC jep masat e përgjithshme për kontrollin e pluhurit

Masat per kontroll	Efienca e kontrollit (%)
Lagia periodike e rrugës	12 deri 98
Ulja e shpejtësisë së qarkullimit	0 deri 80
Ndërtimi i rrugës me sipërfaqe të fortë	85 deri 95
Mbulimi i materialve stok	0 deri 58

Në vlerësimet e cilësisë së ajrit, të dhënat janë siguruar duke marrë faktorë standard të të dhënave të monitorimit për ti përdorur gjatë projektimit; kjo sepse në Shqipëri këto matje kryhen vetëm për qendrat e mëdha urbane ku jetojnë mbi 30% e popullsisë. Për vlerësimi i cilësisë së ajrit për do të shfrytëzohen nivelet e sfondit të matura në 2011 të referuara në Raportin e Mjedisit të Shqipërisë si edhe nga programi EIMS për monitorimin e mjedisit, biodiversitetit, klimës etj.

Metodat standarte me të mira për minimizimin e ngritjes së pluhurave janë :

- Lagje e shpeshtë e sipërfaqeve me pluhur;
- Zbatimi i kufijve të shpejtësisë në zonat nën ndërtim për të ulur sasinë e pluhurit që mund të ngrihet gjatë qarkullimit të tyre
- Mbulimi i materialeve stok
- Mbulimi i automjeteve që transportojnë materialet e ndërtimit
- Ngjeshja sipërfaqeve të rrugëve të ndërtimit aty ku është e mundur.
- Pluhurat e perftuara nga shpimet duhet të sperkaten me ujë të rrjedhshëm
- Punimet të përqendrohen me rradhë në secilen kors, për të eliminuar gjenerimin e lartë të pluhurave
- Nuk duhet të ketë djegie të hapura të materialeve të panevojshme në zonë
- Të gjitha materialet duhen transportuar të mbuluara që të minimizohet përhapja e pluhurave.
- Personeli i ekspozuar gjatë punimeve duhet të mbajë maska kundër pluhurave
- Të përdoren karburante që plotësojnë normat shqiptare lidhur me emetimet e gazrave.
- Të mos mbahen automjetet dhe mjetet e ndërtimit ndezur gjatë kohës kur nuk janë në punë.
- Të mirëmbahen dhe ndryshohen në kohën e duhur filtrat e motoreve të mjeteve të transportit e të ndërtimit.
- Të minimizohet sa më shumë të jetë e mundur përdorimi i gjeneratorëve.
- Të mirëmbahen dhe ndryshohen në kohën e duhur filtrat e motoreve të mjeteve të transportit e të ndërtimit.
- Punetoret të mbajnë maska kundër gazrave.

→ Asfaltimi të kryhet në një kohe sa më të shkurtër dhe mundesisht ne temperatura sa më të ulta.

Duke marrë parasysh se kontrollet për masat zbutëse të pluhurit janë propozuar për fazën e ndërtimit pritet që nivelet e pluhurit pritet të jenë të kontrolluara në mënyrë të vazhduar për të minimizuar ndikimet e pluhurit.

Legjislacioni shqiptar aktualisht nuk ka standarde të pranuar apo kufinj të vendosur për normat e depozitimit pluhurit. Megjithatë, normat ditore mesatare e depozitimit të pluhurit mund të përdo ret për të treguar ndonjë ndikim të mundshëm problematik. Kodi rrugor i Britanisë lejon një normë maksimale prej 200 miligram (mg) në ditë për metër katror pas të cilit depozitimi i pluhurit mund të jetë problematik (mund të shkaktojë aksidente).

Kjo normë jepet sipas tabelës së mëposhtme :

Ndotesi	Vendi i Aplikimit	Vlera Lim	Njesia matese
Pluhur i depozituar	UK	$>200 \text{ mg/m}^2/\text{ditë}$ =problem	Ditore

5.2.4 –Uji siperfaqesor dhe nentokesor

Per te krijuar kushte pune normale, do të jetë e nevojshme largimi i ujit nga gropat e themeleve. Kjo teorikisht mund të çojë në ulje të përkohëshme te nivelit të ujrave nentoke sore ne afersi te zones. Megjithate siç theksohet në studimin hidrogjeologjik të zones se qytetit te Krujes , burimet e ujit nento kesor ne kete zone jane te kufizuara dhe uji nento kesor i ketyre thellesive (thellessise se germimeve) nuk rezulton i ndotur nga komunikimi me ujra te tjera . Per kete arsye, ulja e nivelit të këtyre ujërave per shkak te aktivitetit te germimit nuk pritet të ketë ndonjë ndikim te rendesishem.

Gjatë periudhë së ndërtimit, kontraktori i ndertimit do të realizoje nje plan nivelimi dhe drena zhimi per zonen e sheshit, me qellim qe te manaxhoje rrjedhjen e ujit jashte zones ne nje menyre te përgjegjshme. Për këtë mund dhe duhet te perdoren masa per kontrollimin e sedimenteve dhe për per te minimizuar transportin e sedimenteve jashte zones siç janë rrjeta mbajtese.

Po ashtu mund dhe duhet te merren dhe masa te tilla si mbulime apo gardhe per te minimizuar erozionin e grumbujve te inerteve

Uji qe vjen nga aktivitetet e drenimit ka mundesi te permbaje substanca te ngurta qe rrine pezull. Po ashtu ai mund te permbaje edhe vajra apo graso te shpelara nga derdhjet aksidentale te pakontrolluara te mjeteve levizese ne shesh. Masat qe duhet te merren per te larguar substancat e ngurta para se te shkarkohet uji nga sheshi, perfshin perdorimin e gropave te dekantimit apo struktura te tjera te kontrollit te mbeturinave te ngurta.Çdo njolle e dukshme vaji apo grasoje mund te largohet nga siperfaqja me ane te absorbenteve tensioaktivë.

Derdhjet aksidentale te karburantit apo materialeve te tjera jane nje rrezik i mundshem per ujerat bregdetare apo ato te brendshem. Per kete arsye, do merren masa paraprake per te ndaluar keto derdhje dhe te gjithë punetoret duhen te trajnohen per perballimin e ketyre rasteve. Nga ana tjetër, duhet te pergatitet nje plan kundërveprimi urgjence me shkrim dhe te ruhet ne kantjerin e ndertimit dhe punetoret duhet te trajnohen per te ndjekur procedurat specifike ne rastet e derdhjeve. Punetoret duhen te pajisen me mjetet e pershtatshme per te mbledhur dhe trajtuar derdhjet e naftës apo vajit ne këto raste.

Per te shmangur perhapjen e materialeve te lengshme, te cilat mund te demtojne rezervat ujore siperfaqsores apo nentokesore, duhet te merren masat e meposhtme zbutese:

→ Veçimi i gjithë karburanteve dhe lubrifikanteve që dalin gjatë mirembajtjes së pajisjeve të ndertimit dhe grumbullimi i tyre ne vendet e duhura.

- Ndertimi i pengesave mbajttese rrotull te gjitha çisternave te depozitimit te karburanteve apo mos vendosja e tyre ne territorin ku do te punohet per terminalin
- Ndertimi dhe mirembajtja e fasiliteve per te larguar ujin e shiut nga strukturat mbajttese dytesore dhe largimi i karburanteve nga siperfaqja e materialit te grumbulluar .

Per trajtimin e mbeturinave sanitare, ndonese ne sasi te pakta, mund te perdoret perkohesisht nje kontaktor i jashtem ose nje sistem i vogel per trajtimin e ujrave te zeza. Ne asnje rast, ujrat e zeza te patrajuara nuk do te derdhen ne ujrat rrjedhese lokale ose ne det.

5.2.5 –Zhurmat dhe dridhjet

Zhurma nga aktivitetet e ndertimit mund te jete e rendesishme per nje periudhe te kufizuar kohe. Nivelet e zhurmes te shkaktuara nga aktivitetet e ndertimit mund te ndryshojne shume, ne varesi te fazes se ndertimit dhe detyres specifike qe po kryhet.

Te gjitha pajisjet qe leshojne zhurme do te mirembahen ashtu siç duhet per te minimizuar ndikimin e zhurmes ne zone. Paisjet qe leshojne zhurme duhet te plotesojne standartet e BE rreth zhurmes te shkaktuar ne mjedis.

Duke iu referuar ligjit Nr.7994 , dt.12.07.2007 , ”Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis “ investitori ka marre te gjitha masat per zhurma sa me vogla ne kete aktivitet qe kerkon te zhvilloje nepermjet :

- a) përzgjedhjes dhe përdorimit të pajisjeve që lëshojnë zhurmë të niveleve të ulëta,
- b) përzgjedhjen e vendit, që instalimi dhe funksionimi i mjeteve e pajisjeve që lëshojnë zhurmë të garantojnë nivelin kufi në të gjitha mjediset, të cilat ndikohen prej saj ,
- c) masat parandaluese e zbutëse të zhurmës në pikën e lëshimit , përgjatë rrugëve të përhapjes dhe në mjediset që ndikohen prej saj.

Pajisjet qe do punojne te listuara me siper duhet te jene ne gjendje teknike te mire , te mos perdoren ne oraret e levizjeve pik , jane shume larg zones se banuar dhe ndikimi ne mjedis eshte i ulet .

Kufijte e lejuar te zhurmava te ndertimit :

Kategoria e vleresimit dhe periudha e referuar	Kategoria A vlera e lejuar	Kategoria B vlera e lejuar	Kategoria C, vlera e lejuar
(LAeq)	dB(A)	dB(A)	dB(A)
Gjate natës ora 23.00-07.00	45	50	55
Mbrëmje dhe fundjavë	55	60	65
1900-2300 ditëjave			
1300-2300 Shtune			
0700-2300 djele	65	70	75
Gjatë ditës			
0700-1900 dite te javes			
0700-1300 shtune			

Kodin European thuhet se vlerat e kategorisë A do të përdoren kur nivelet e zhurmave ambientit (rrumbullakosur në më të afërt 5 dB) janë më pak se këto vlera.

Vlerat e kategorisë B janë do të përdoren kur nivelet e zhurmës në ambient (me një tolerance 5 dB) janë të njëjta me vlerat e kategorisë A.

Kategoria vlerat e pragut C janë që do të përdoret kur nivelet e ambientit zhurmës (me një tolerancë 5 dB) janë më të larta sesa vlerat e kategorisë A.

Ku nivelet e zhurmës në ambientit tejkalonjnë vlerat prag të listuara në tabelën e mësipërme atëherë mund të themi që kemi një ndikim të zhurmës nëse niveli total i zhurmës LAeq rritet më shumë se 3 dB për shkak të aktivitetit të ndërtimit.

Lloji objektit	Ditën dB Laeq (06:00-22:00)	Natën dB Laeq (22:00-06:00)
Spitale, shkolla, manastire	57	47
Zona rezidenciale	59	49
Zonat kryesore, zonat rurale, zonat miks	64	54
Zonat tregtare	69	59

Shkalla e krahasimit të zhurmës aktuale me atë të pritshme gjatë punimeve në këto objekte :

Ndryshimi i nivelit të zhurmës dB(A)	Përgjigja subjektive	Shkalla e ndikimit
0 - 0.9	E papërfillshme	Asnjë ndikim (parëndësishme)
1.0 - 2.9	Pak e përfillshme	E lehtë
3.0 - 4.9	E dallueshme	E mesme
5.0 - 9.9	Nga dyfishim ose më të lartë	E konsiderueshme
10.0 ose më shumë	Me shumë se dyfishim deri në shumë të lartë	Ndikime të ndryshme

Për të kategorizuar nivelet e zhurmës në ambient këto zhurma duhet të maten në tre pika të ndryshme dhe të dhënat duhet të rumbullakosen me një vlerë të afërt me 5 dB.

Të dhënat bazë të paraqitura në Tabelat e dhëna janë rumbullakosur në përputhje me rrethanat dhe janë paraqitur më poshtë në tabelat në tabelat përkatëse, së bashku me kategorinë rezultante të vlerësimit të zhurmës të ndërtimit.

Për sa i përket orarit të punës gjatë fazave të ndërtimit është e kuptueshme se ndërhyrjet do të ndodhin zakonisht në orarin 07: 00-18: 00. Në këtë këndvështrim periudha e natës nuk do të merret në konsideratë.

Nivelet e zhurmës të përafëruara pranë qendrave të banuara :

Periudha	Niveli i zhurmës në ambient i rumbullakosur më 5 dB	Vlerësimi i kategorisë-prag të zhurmës nga ndërtimi
----------	---	---

Ditën(07:00-19:00)	50 dB(A)	Kategoria A – 65 dB(A) ditën
Mbrëmje(19:00-23:00)	50 dB(A)	Kategoria A – 55 dB(A) mbrëmje
Natën (23:00-07:00)	50 dB(A)	Kategoria C – 55 dB(A) natën

Nivelet e zhurmës të përafëruara larg qendrave të banuara :

Periudha	Niveli i zhurmës në ambient i rumbullakosur më 5 dB	Vlerësimi i kategorisë-prag të zhurmës nga ndërtimi
Ditën(07:00-19:00)	55 dB(A)	Kategoria A – 65 dB(A) ditën
Mbrëmje(19:00-23:00)	50 dB(A)	Kategoria A – 55 dB(A) mbrëmje
Natën (23:00-07:00)	45 dB(A)	Kategoria C – 55 dB(A) natën

Është projektuar dhe menduar me parë që operacionet e ndërtimit do të ndahet përafërsisht në keto faza si më poshtë:

- ☞ Faza parë e ndërtimit(germim, betonim)
- ☞ Faza e dytë e ndërtimit(mbushje, shtrim me pllaka , ndërtim KUB)
- ☞ Faza e parë e ndërtimit (vendosje e ndricimit , përfundim i punimeve).

Te dhënat e pritshme të Fazës së I-re :

Pajisja	Fuqia në kF	Pesha	Octave Band (Hz)								dBLAeq
			63	125	250	500	1000	2000	4000	8000	
Buldozer	250	35 t	77	86	75	75	82	80	73	67	86
Kamion vetshkarkues	194	25 t	88	90	80	79	76	71	65	61	81
Eskavator	172	35t	76	79	75	75	76	73	70	65	80
Fadrome	364	56 t	91	94	90	86	86	83	77	69	91
Matrapik	100	22 t	85	88	85	89	92	88	86	81	95

Te dhënat e pritshme të Fazës së II-te :

Pajisja	Fuqia në kF	Pesha	Octave Band (Hz)								dBLAeq
			63	125	250	500	1000	2000	4000	8000	
Buldozer	250	35 t	77	86	75	75	82	80	73	67	86
Kamion vetshkarkues	194	25 t	88	90	80	79	76	71	65	61	81
Eskavator	172	35t	76	79	75	75	76	73	70	65	80
Fadrome	364	56 t	91	94	90	86	86	83	77	69	91

Te dhenat e pritshme te Fazes se III-te :

Pajisja	Fuqia ne kF	Pesha	Octave Band (Hz)								dBLAeq
			63	125	250	500	1000	2000	4000	8000	
Rrul ngjeshje	250	35 t	77	86	75	75	82	80	73	67	86
Kamion vetshkarkues	194	25 t	88	90	80	79	76	71	65	61	81
Asfaltoshtruese	172	35t	76	79	75	75	76	73	70	65	80
Bitumatrice	194	25 t	88	90	80	79	76	71	65	61	81

Ka shumë masa që mund të ndërmerren në zonën e punimeve apo në parkun e automjeteve të cilat mund të minimizojnë zhurmat.

Këto janë janë masa të përdorura që përdoren në vendet e BE dhe reflektojnë praktikën më të mirë në fushën e ndërtimit nder te cilat duhet te kene vemendje :

→ Fikja e mjeteve të panevojshme
 → Duke përdorur izolues prej gome(mund te perdoren dhe goma te perdoruara)
 → Minimizimin e rënies nga lartësitë të materialeve;
 → Duke i ndezur makinerite graudausht (njera pas tjetres) jo te gjitha njëkohe
 → Mirëmbajtja e pajisjeve. Për shembull, zhurmat mund të reduktohen nga shtrëngimi i pjesëve të lirshme si edhe duke i puthitur ose fiksuar me material elastik (të tilla si gome) midis sipërfaqeve në kontakt.

→ Zhurma nga pajisjet e ndërtimit mund të reduktohen me modifikimin ose me aplikimin e metodave që reduktojnë nivelin e zhurmave. Megjithatë, modifikimet duhet të kryhet në konsultim me prodhuesit e pajisjeve për të siguruar se siguria për këtë modifikim nuk dëmton pajisjen. Masa të tilla përfshijnë:

→ Për zhurma të vazhdueshme, të tilla si ajo e shkaktuar nga puna e motorëve me naftë, një zgjidhje për reduktim mund të jetë vendosja e një sistemi silenciator ose duke i përshtatur një mburojë akustike dhe duke e vendosur mbi kapakun e motorit .

→ Zhurma të shkaktuara midis pjesëve të ndëryshme të makinerive të cilat krijojnë një rezonancë mund të minimizohen duke modeluar fillimisht pajisjen duke i shtuar një shtresë izoluese ose duke ulur efektin nxitues të motorit.

Në vendet ku nuk është e mundur reduktimi i zhurmës mund të merret në konsideratë dhe distance midis burimit të zhurmës dhe pritësit të saj. Për të patur një ulje maksimale të zhurmës këto faqe mbrojtës duhet të vendosen , sa më afër burimit të jetë të jetë e mundur. Psh:

- Grupimi i ndërtësive në kantier dhe atyre ndihmëse mund të jëtë një pengesë e mirë për zhurmën
- Zonat të cilat janë gërmuar nën nivelin e tokës mund të përdoren për të vendosur pajisje statike si gjeneratorë, kompresorë dhe pompat.
- Vendet e ngritura mbi nivelin e zonës së punimeve të peiazhit apo të ndërtuara mund të shërbejnë për pozicionimin në to të pajisjeve të zhurmshme .

5.2.5.1 –Zona ku mund te perdoren per ndertimin e shkolles

Terreni mund të kërkojë përdorimin e hapjeve me shpërthim të gjurmës së rrugës. Është e kuptueshme që prishja duhet të jetë sa më e kufizuar dhe larg qendrave të banuara. Kur një shpërthim kryhet energjia transmetohet nga faqja e shpërthimit në formën e valëve të presionit të ajrit. Këto valë presion përbëjnë energji me një gamë të gjerë të frekuencave, disa prej të cilave janë më të larta se 20 Hz dhe për këtë arsye janë të perceptueshme si tingull. Shumica janë nën 20 Hz dhe për këtë arsye janë padëgjueshëm por mund të ndihet si tronditje. Kombinim i shpërthimit me tronditjen krijojnë fenomenin që është i njohur si mbipresion ajrit.

Problemi kryesor në këtë rast është marrja në konsideratë e ndërtesave fqinje me faqet e shpërthimit. Dritaret janë përgjithësisht pjesë më e dobët e një strukture dhe eksperimentet kanë treguar se një dritare e montuar dobët mund të thuhet në rreth 150 dB (lin), ndërsa dritaret e montuara mirë fillojnë të plasariten në rreth 170 dB (lin). Dëme strukturore nuk do të pritët në nivele më poshtë 180 dB (lin).

Zhurma nga aktivitetet e ndërtimit mund të jetë e rëndësishme për një periudhë të kufizuar kohe. Nivelet e zhurmës të shkaktuara nga aktivitetet e ndërtimit mund të variojnë shumë, në varësi të fazës së ndërtimit dhe detyrës specifike që po kryhet. Të gjitha paisjet që lëshojnë zhurmë do të mirëmbahen ashtu siç duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmës në zonë.

Paisjet që lëshojnë zhurmë do të jenë sipas standarteve të aplikueshme të BE siç shihet në Direktivën e BE 2000/14/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit të Europës të 8 Majit 2000 mbi njehsimin e ligjeve të Shteteve Anëtare rreth zhurmës të shkaktuar në ambjent nga paisjet e përdorura në mjediset e jashtme.

Në vijim janë raportuar vlerat e fuqisë së zhurmave, të vlerësuara për disa paisje që përdoren zakonisht në fazën e ndërtimit :

- Ekskavatorë me kovë gjermimi 81-90 Leq dB(A) në 15 m;
- kamionë 81-87 Leq dB(A) në 15 m;
- pompa betoni 74-84 Leq dB(A) në 15 m;
- vinça (Derrick) 79-86 Leq dB(A) në 15 m;
- vinça (të lëvizshëm) 80-85 Leq dB(A) në 15 m;
- gjeneratorë 71-87 Leq dB(A) në 15 m;
- çekiça pirun 69-85 Leq dB(A) në 15 m;
- pompa 68-80 Leq dB(A) në 15 m;
- buldozer 77-90 Leq dB(A) në 15 m;
- ngarkues konvejerë 77-90 Leq dB(A) në 15 m;
- sheshues 79-89 Leq dB(A) në 15 m;
- aparat saldimi 66-75 Leq dB(A) në 15 m;
- kompresor ajri 76-89 Leq dB(A) në 15 m

Për çdo rast, nivelet maksimale të zhurmës, të pranueshme në kantier janë:

- E vazhdueshme 1,000 m nga impianti 45 dBA
- E çastit 1,000 m nga impianti 55 dBA

Për sa u përket vibracioneve, gjithashtu në lidhje me faktin se një pjesë e mire e gjurmës së rrugës ndodhet larg nga ndonjë subjekt i ndjeshëm, mund të përjashtohet çdo ndikim në mjedisin rrethues.

Në vendet ku nuk është e mundur reduktimi i zhurmës mund të merret në konsideratë dhe distance midis burimit të zhurmës dhe pritësit të saj. Për të patur një ulje maksimale të zhurmës këto faqe mbrojtës duhet të vendosen , sa më afër burimit të jetë të jetë e mundur. Psh:

- Grupimi i ndërtësive në kantier dhe atyre ndihmëse mund të jëtë një pengesë e mirë për zhurmën
- Zonat të cilat janë gërmuar nën nivelin e tokës mund të përdoren për të vendosur pajisje statike si gjeneratorë, kompresorë dhe pompat.
- Vendet e ngritura mbi nivelin e zonës së punimeve të peiazhit apo të ndërtuara mund të shërbejnë për pozicionimin në to të pasjsijeve të zhurmshme

5.2.5.2 –Ndjeshmeria e receptoreve

Bazuar mbi vlerësimin e madhesisë së ndikimit dhe ndjeshmërinë së receptorëve individualë, matricë e dhënë në Tabelën 8-5 është zhvilluar në mënyrë që të sigurojë një tregues të shkallës së rëndësisë të mundshme të çdo ndikimi paraprak të zhurmës gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit.

Matrice treguese ndikimi ndaj receptorëve me ndjeshmeri të lartë

Shkalla e ndikimit	Receptore me ndjeshmer te lartë
E larte	Madhore
E konsiderueshme	E madhe-e moderuar
Mesatare	E moderuar
E lehte	E ulet
Pa ndikim	Neutral

5.2.7 –Mbeturinat qe krijohen

Gjate periudhës së ndertimit dhe rikonstruksionit te kesaj shkolle do te kete dy burime mbeturinash:

- Materiali i gërmuar për të realizuar infrastrukturën e parashikuar në tokë
- Material i tepërt që do të rezultojë nga punimet e prishjes apo sheshimet apo nivelimet e ndryshme në zonen e shërbimeve dhe pranë aksit rrugor.

Nje pjese e mbeturinave te ngurta te prodhuara gjate punimeve tokesore mund te vije edhe nga amballazhete e materialeve te ndryshme te ndertimit (çimento, dru, plastike, kartona, xham, materiale izoluese, etj.). Keto lloj mbeturinash mund te klasifikohen si ine rte. Vetem vajrat e kulluara mund te klasifikohen si te “rrezikshme”. Punetoreve te nderti mit do t’u kerkohet te mbledhin më vehte llojet e mbeturinave. Te gjitha materialet e largua ra nga sheshi i ndertimit do te menaxhohen sipas ligjeve dhe rregulloreve shqiptare ne fuqi.

Materialet e rrezikshme qe do të përdoren detyrimisht gjate ndertimit, do te ruhen ne zonat e parashikuara me fund të dyfishte. Me këto masa, nuk ka pse të ndodhin ndikime negative te rendesi shme gjate fazes se ndertimit te ketij objekti.

Sasia totale e mbeturinave te gjeneruara nga punetoret ne sheshin e ndertimit vleresohet se do te jetë rreth 24 t. Kjo vlere eshte perlllogaritur duke marre parasysh numrin maksimal te punetoreve te ndertimit ne kohen me intensive, qe do te jete afersisht 20-25 punetore/dite per tre muaj pune te programuar, duke supozuar nje prodhim mbeturinash komunale (komerciale, institucionale dhe mbeturinat e hedhura veç) sa 1/3 e prodhimit mesatar te mbeturinave per fryme (500 kg per fryme në

vit).Per menaxhimin e duhur të këtyre mbeturinave, që nga ana tjetër mund te klasifi kohen si mbeturina familjare, do te duhet të ngrihet një njësi portative e trajtimit të tyre.

Ne baze te ketyre rezultateve, ne menyre qe te parandalohet ndikimi i ndotesave gjate punime ve te germimit, do te jete e nevojshme te largohet material i germuar qe supozohet te dale nga germimet dhe te depozitohet i sigurte si dhe materiale te tjera qe do te rezultojne gjate punimeve te ndertimit . Keto materiale hedhurine do te vendosen ne zona te autorizuar nga pushteti vendor. Firma kontraktuese do te konsiderohet pergjegjes per ndotjen qe do te rezultojne ne zonat e permendura.

Zgjedhja e vendit te grumbullimit te mbeturinave i perket jo vetem firmes proje ktuese por per kete duhet diskutuat me firmen sipermarreses dhe pushtetin vendor.

Vendosja sa me optimale e vendit te depozitimit te mbeturinave, ka për qëllim te minimizojë rrezikun e ndotjes se dheut perqark dhe te ujit nentokesor per shkak te derdhjeve aksidentale të prodhi meve të naftes, dhe duhet te konsiderohet gjithashtu nje zgjidhje shume e mire per te izoluar dheun e ndotur dhe ujrat nentokesore nga mjedisi mbi to. Keshtu qe ndertimi i ketij objekti dhe sistemimi i mjediseseve te sherbimit, jo veten qe nuk do te ndikojë negativisht ne procedurat e perdorimit te tokes, por do të ketë ndikim pozitiv per sa i perket zones se ndotur aktualisht nga materialet hedhurine apo nje pamje aspask e kendshme ne afersi te qendres se qytetit duke ndikuar per momentin ne menyre aspask te kenaqshme .

Nisur nga masat qe do merren , te planifikuara me pare dhe qe do te zbatohen ne vijim nga kontraktori i punimeve jo veten qe nuk do te ndikojë negativisht ne procedurat e perdorimit te tokes , por do të ketë ndikim pozitiv per sa i perket zones se ndotur aktualisht nga materialet hedhurine .

5.3 –Vleresimi i ndikimeve dhe masat zbutese

Kohezgjatja dhe lloji i procesit që do të kryhet, janë faktorët bazë që merren para sysh në vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve potenciale negative te ndertimit te veprave detare . Për të pasur një ide më përmbledhëse të këtyre ndikimeve, në tabelen 5.4 janë përmbledhur parametrat mjedisore dhe burimet e mundshme te ndikimeve te percaktuara më sipër. Per secilin rast, duke marre parasysh madhesine dhe kohezgjatjen e procesit, eshte bere nje vleresim i rendesise se pergjithshme duke perdo rur tre nivele: i Ulët (U), i Mesem (M) dhe i larte (L).

Tabela 5.4 Permbledhje e vleresimeve te ndikimit ne mjedis

Parametri mjedisor	Burimi	Vlera e ndikimit		
		E ulet (U)	Mesatare (M)	E Larte (L)
Perdorimi i resurseve te materialeve te ndertimit	Strukturat e betonit		M	
Ndikimi te drejtperdrejta ne jeten detare dhe habitatine tyre	Germimi per themelet	U		
	Germime te tjera	U		
Ndotja e ajrit	Pajisjet e ndertimit	U		
	Levizjet e makinave		M	
	Levizjet e punetoreve	U		
	Pluhur nga aktivitetet		M	

Ndotja e ujit	Kullimi	U		
	Mbetje te tjera	U		
Ndikimi ne trafik	Levizjet e makinerive		M	
	Levizjet e punonjesve	U		
Mbeturina te ngurta	I gjithë aktiviteti	U		

Perdorimi i burimeve te materialeve te ndertimit

-Ndertimi i ketij objekti , do te kerkoje nje sasi te parashikuar dhe pershkruar me siper materialesh ndertimi që duhen transportuar nga vendi i prodhimit. Nga ana tjetër, për të realizuar ndërtimet përkatëse do të nevojitet një sasi e caktuar çimentoje dhe betoni te gatshem te pershkruar me siper te cilet do te merren nga furnizues te licensuar dhe te certifikuar . Pjesa të caktuara te ketij segmenti rrugor , do të ndërtohen me beton te armuar. Në vija të përgjithshme ndikimi i përgjithshem i kesaj çeshtje vleresohet si "i moderuar".

Ndikimi mbi trafikun/rrugët

-Përsa i përket materialeve te ndertimit, duke iu referuar diskutimit të mësipërm, sasia e tyre mendohet të zvogëlohet në maksimum . Materialet profile celiku mund të sillen nga jasht objektit si lëndë e parë dhe të përpunohen këtu, në kantierët lokalë , brenda sheshit të ndertimit , duke zvogëluar ndjeshëm edhe sasinë e materialit që do të transporto hen për në shesh.

Ndikimi me i madh ne trafikun tokesor do te vije nga transportimi i materialeve të ngurta. Duke marre parasysh sasine e materialeve që do të transportohet dhe kohezgjatjen e furnizimit , ndikimi i kesaj çeshtje konsiderohet "i mesem".

Zbutja e nevojshme e ndikimit të këtij procesi transport dhe depozitim, sheshim, nivelimi, hyn ne kategorine e "Praktikave me te mira te Manaxhimit te Zonave te ndertimit".

Shpejtesia e levizjes se mjeteve te transportit do te kontrollohet rigorozisht ne meny re qe te ulet rreziku i aksidenteve, duke vendosur sinjale rrugore në pikat më “të nxehta” të trafikut (nyje apo kryqëzime problematikë) sidomos ne daljet e rrugeve te kantierit me ato te qytetit.

5.4 –Ndikimi ne ambjentin perreth objektit

Ndikimet e drejtperdrejta ne ambjentin perreth lidhen me prishjet dhe germimet qe do te behen ne sheshin e ndertimi si dhe me mos kontrollimin e reshjeve te rastit qe mund te ndodhin gjate kohes se ketyre germimeve.

Bazuar ne analizen e tipareve biologjike te zones se struktures eshte arritur ne përfundimin qe makro-fauna bentike (benthic) dhe fauna ihtike (ichthyic) jane te varfëra, si pasoje e ndikimeve njerezore intensive te mepareshme. Per kete arsye ndikimi i vete germimit konsiderohet si "i ulet".

Specifikimet kontraktuale duhet te kerkojne teknologjine me te mire ekzistuese dhe proçedura per reduktimin e derdhjeve te ujrave te shiut ne det.

Zhurma-Gjatë ndërtimit të objektit do të jetë e domosdoshme përdorimi makinerive qe leshojne zhurme . Këto paisje do te operojnë per nje periudhe kohe të kufizuar dhe largësia nga zonat e banuara eshte e tille (disa qindra metra) saqe ndikimi konsiderohet i "i ulet". Kete pasqyrim e dhame me siper .

Ndotja e ajrit- Pluhurat qe dalin nga proceset e ndertimit si dhe shkarkimet e gazrave të makina ve janë burimet e mundshme te ndotjes se ajrit, te cilat mund te rrisin perqendrimin e materialeve te imta në të. Me siper pershkruam një liste paisjesh kryesore që përdoren në përgjithësisht në ndertim si dhe kohezgjatja e parashikuar e veprimit të tyre. Pjesa me e madhe e pajisjeve do te operoje ne nje

ambjent të hapur me nje dispersion te madh per shkak te rrymave dhe ererave . Ndikimi ne ndotjen e ajrit pra mund te konsidero het “i ulet”.

Çeshtja qe ka nevojë për masë zbutese është ndotja (pluhurat dhe çlirimet) qe lidhen me kamjonat vete-shkarkues qe transportojne material e ndertimit. Te gjitha pajisjet qe punojne me diezel duhet te mirembahen rregullisht per te minimizuar çlirimet nga skapamentot.

Ndotja e ujit- derdhja e ujrave te larjes se makinerive te germimit apo transportit apo i mbeturinave te naftes dhe të lubrifikanteve te motorrave, mund të krijojnë kushte për ndikime te tjera, objekt i të cilëve të jetë uji nëntokësor.

Ndikimi i ketyre faktorëve është “i vogel”, duke marre ne konsiderate nivelin e pajisjeve te perfshira dhe standartet me te cilat punojne keto tip pajisjesh. Ka disa prova që ujërat sipërfqësore të ujit janë përdorur për furnizimin me ujë të pijshëm.

Diskutimet me banoret në të gjithë zonën e studimit tregojnë se rrjedhat lokale ujore përdoren edhe si ujë për larje. Megjithatë, shqetësimet në lidhje me cilësinë e ujit ka sjellë nevojën e investimeve në sistemin e ujit të pijshëm dhe aksesin e cdo familje për ta pasur atë.

Deri atëherë(pra kur uji të vijë në rrjet) banorët do të vazhdojnë të shfrytëzojnë rrjedhave malore dhe burimet e ujërave nëntokësore si furnizim i ujit për konsum dhe përdorime të brendshme. Në kuadër të këtyre, vlera (ose ndjeshmëri) e ujit për furnizim të brendshëm është i lartë në zonat rurale.

Masat zbutese perfshijne Praktikate me te Mira te Menaxhimit te Ndertimit, te cilat duhet te jene nje nga kerkesat baze te specifikimeve te kontrates.

Me poshte po japim nje permbledhje te ligjeve Europiane per ujin :

Direktiva Evropiane 2000/60 / EC (Direktiva Kuadër e Ujit) u miratua në tetor 2000 me synimin për të siguruar mbrojtjen e burimeve të vlefshme ujit natyral të Evropës. Në terma të thjeshtë, Direktiva vendos një kërkesë mbi shtetet anëtare që të punojnë bashkërisht për të zbatuar masat që në mënyrë proaktive do të lëvizin trupat ujore brenda juridiksionit të tyre drejt arritjes së statusit “ekologjikisht i mirë”.

Neni 1 (Qëllimi) i Direktivës:

Qëllimi i kësaj Direktive është të krijojë një kuadër ligjor për mbrojtjen e ujërave të brendshëm sipërfaqësore, ujërave kalimtare, ujërave bregdetare dhe të ujërave nëntokësore dhe:

a) Të ndalojë përkeqësimin e mëtejshëm, të mbrojë dhe të rrisi statusin e ekosistemeve ujore dhe, në lidhje me nevojat e tyre ujore, ekosistemet tokësore dhe ligatinat direkt në varësi të ekosistemeve ujore;

b) Të promovojë përdorimin e qëndrueshëm të ujit të bazuar në një mbrojtje afatgjatë të burimeve ujore në dispozicion;

c) të bëjë mbrojtjen e zgjeruar dhe përmirësimin e mjedisit ujor, përmes masave specifike për reduktimin progresiv të shkarkimeve, emetimeve dhe humbjeve të substancave prioritare.

d) Siguron reduktimin progresiv të ndotjes së ujërave nëntokësore dhe parandalon ndotjen e mëtejshme të tyre.

e) Kontribuon në zbutjen e efekteve të përmbytjeve dhe thatësirave.

Punimet në tokë mund të çojë në një rritje e përqendrimit të inerteve të depozituar në sipërfaqe si edhe të ndotjes së ujërave nëntokësore. Kjo do të, prandaj, që të minimizohet kjo duhet kufizuar sasia e përgjithshme e ekspozuar në tokë përmes masave si:

- Kryerjen me faza të ndërtimit, duke minimizuar kudo që të jetë e mundur dheun e ekspozuar në terren.

- Mbulimi i dheut ose materialeve stok

- Përdorimin e pengesave përgjatë kufirit të zonës ekspozuar;
- Vendosjen e baltrave larg nga përrrenjtë dhe burimet ujore;
- Karburanti dhe solucionet kimike do të magazinohen, ne zona të siguruar një minimum prej 110% të kapacitetit total të rezervuarit për të siguruar se çdo derdhje nuk do të përfundojë në mjedisin e jashtëm.
- Çdo automjetet apo pajisje tjeter të përdorura gjatë ndërtimit do të mirëmbahen dhe të inspektohen rregullisht për rrjedhjet.
- Rrjedhjet nga pajisjet apo nga larja e rrotave do të mblidhen dhe të riciklohen, duke shmangur depozitimin e tyre në ujërat natyrore apo ato të rrjetit lokal.

Një plan nivelimi dhe drenazhimi për zonën do të kërkohej nga kontraktori i ndërtimit, në mënyrë që të manaxhojë rrjedhjen e ujit jashtë zonës në një mënyrë të përgjegjshme. Mund të përdoren masa për kontrollimin e sedimenteve si rrjeta mbajtëse, sipas nevojës, për të minimizuar transportin e sedimenteve jashtë zonës.

Mund të merren dhe masa të tilla si mbulime apo gardhe për të minimizuar erozionin e grumbujve të inerteve.

Uji që vjen nga aktivitetet e kullimit ka mundësi të përmbajë substance të ngurta ose që rrijnë pezull, vaj apo graso. Masat që duhet të merren për të larguar substancat e ngurta para se të shkaktohet uji nga sheshi përfshijnë përdorimin e gropave të dekantimit apo struktura të tjera të kontrollit të mbeturinave të ngurta. Çdo njollë e dukshme vaji apo grasoje mund të largohet nga sipërfaqja me anë të absorbentëve.

Derdhjet aksidentale të karburantit apo materialeve të tjera janë një rrezik i mundshëm për ujërat e brendshëm. Duhet të merren masa paraprake për të ndaluar derdhjet dhe të gjithë punëtorët duhet të trajnohen për trajtimin, ruajtjen dhe vendosjen e materialeve të rrezikshme apo toksike. Duhet të përgatitet një plan përgjigje urgjence me shkrim dhe të ruhet në kantierin e ndërtimit dhe punëtorët duhet të trajnohen për të ndjekur procedurë specifike në rastet e derdhjeve. Punëtorët duhet të pajisen me mjetet e përshtatshme për të mbledhur dhe trajtuar derdhjet në rastet urgjente.

Për të shmangur përhapjen e materialeve të lëngshme, të cilat mund të dëmtojnë rezervat ujore sipërfaqësore apo nëntokësore, duhet të merren masat e mëposhtme të zbutëse:

- Veçimi i të gjithë karburanteve dhe lubrikantëve që dalin gjatë mirëmbajtjes së pajisjeve të ndërtimit dhe grumbullimi i tyre në vendet e duhura.
- Ndërtimi i argjinaturave mbajtëse për të gjitha çisternat e depozitimit.
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e fasiliteve për të larguar ujin e shiut nga strukturat mbajtëse dytësore dhe largimi i karburanteve nga sipërfaqja e materia lit të grumbulluar.

5.5 –Ndikimi ne mjedis gjate shfrytezimit te objektit

Me masat që do të merren dhe kujdesin e duhur ky ndikim negativ mendojme të mos merret në konsideratë.

Siç mund të shihet burimet kryesore të ndikimeve të mundshme mjedisore që mund të rezultojnë nga shfrytëzimi i kësaj godine përfshijnë ndikimet në zhurma në cilësinë e ajrit dhe trajtimin e ujërave të bardha .

Burime të tjera të mundshme të ndikimeve në mjedis përfshijnë rrjedhjet e karburantit të mjeteve si dhe gjenerimi i një volumi të vogël mbeturinash të ngurta .

Ndikimet e mundshme për t'u vlerësuar në këtë rast janë:

- zhurmat, tymrat dhe çlirimet nga levizja e mjeteve
- ujrë të shkarkimeve dhe ato sipërfaqësore .

Ndotjet konsiderohen ne nivele minimale ne te gjitha aspektet duke vecuar ndonje avari te mundshme .

Sistemet e kullimit të jashtme do të jetë kusht për të kapur dhe veçuar flukset që rrjedhin nga pjesët e sipërme të terrenit ose anash rruges dhe ti devijojnë në rrjetin e shkarki meve te planifikuara dhe projektuar me pare . Disa modifikime të regjimit ekzistues të rrjedhjes mund të priten megjithatë për shkak të përshpejtimin e rrjedhjes brenda sistemit të drenazhimit. Ndikimi i mbetur mbi mjedisin e ujit për këtë arsye është konsideruar të jetë i vogël (negativ). Ky ndikim do të jetë i përhershëm dhe i pakthyeshem.

Lëvizja e trafikut në rrugë do të rezultojë në depozitim të ndotësve në sipërfaqe rrugore duke përfshirë pluhura, vajra, graso apo karburant si edhe metalet e rënda . Pas reshjeve , këto ndotës mund të rrjedhin në drejtim të rrymës deri në ujërat pritëse (dmth përrenj lokale, sisteme kanalizimesh etj). Sistemi i brendshëm kullimit do të përshtasë praktikën e qëndrueshme të kullimit për të bërë një trajtim paraprak të këtyre ndotësve para se të shkarkohen në mjedisin pritës. Ndikimi i mbetur mbi mjedisin e ujit për këtë arsye është konsideruar të jetë i papërfillshëm (negativ). Çdo ndikim në rrjedhat lokale do të jetë i përkohshëm dhe i kthyeshem.

Sistemi i kullimit të brendshëm do të miratojë praktika të qëndrueshme të kullimit për të kapur, trajtuar dhe ruajtur përkohësisht rrjedhën, për të pakësuar shkallën e vëllimit që kalon në drejtim të rrymës. Ndikimi i mbetur mbi mjedi sin e ujit për këtë arsye është konsideruar të jetë i papërfillshëm (negativ). Çdo ndikon në rrjedhat lokale do të jetë i përkohshëm dhe i kthyeshem.

Rreziku potencial nga rrjedhjet e mëdha përgjatë rrugës është vlerësuar në përputhje me Manualin e Projektimit për Rrugët dhe Urat (DMRB) Vëllimi 11 (Vlerësimi i Mjedisit) Seksioni 3, (Teknikat e Vlerësimit Mjedisit). Kjo metodologji merr në konsideratë faktorët si më poshtë:

- Gjatësia e rrugës
- Natyra dhe vendndodhja e kryqëzimeve
- Njësia e kohës që do të duhet për shërbimeve emergjente për të arritur në një derdhje ndotëse
- Parashikimi i vëllimeve të trafikut
- Përqindja e automjeteve të transportit të mallrave të rënda (ATR) që do të përbëjnë trafikun rrugor.

Mbi këtë bazë, është përcaktuar se rreziku potencial i një ndotje të madh është më pak se 0.5%, dhe për këtë arsye nuk ka nevojë për masë shtesë zbutëse. Madhësia e ndikimit të derdhjet e mundshme mbi mjedisin e ujit për këtë arsye është i papërfillshëm (negativ).

Ndërtimi i godines do të rezultojë në ekspozimin e tokës të zhveshur ne dy segmente ne te cilat do behet nderhyerje e cila pas reshjeve të shiut, do të sjellë një rritje në përqendrimin e lëndëve pezull të cilat do të derdhen në rrumat ujore (lumenj, përrenj). Praktikën më të mira të ndërtimit do të miratohet gjatë fazës së ndërtimit dhe do të aplikohen në praktikë për të minimizuar humbjen e dherave të ekspozuar gjatë reshjeve, dhe për të ndaluar largimin e tyre para se të kalojnë në drejtim të rrymës së ujit. Ndikimi i mbetur mbi mjedisin e ujit për këtë arsye është konsideruar të jetë i vogël (negativ).

Ky ndikim do të jetë i përkohshëm dhe i kthyeshem.

Lëvizja dhe mirëmbajtjen e pajisjeve në kantier gjatë fazës së ndërtimit do të paraqesë një rrezik potencial të rrjedhjeve apo derdhjeve(p.sh. vajrave, grasos dhe karburanteve). Metodën më të mirë do të ndiqen në praktikë duke përfshirë edhe mirëmbajtjen proaktive të automjeteve si dhe ndarjen e zonave të larjes së automjeteve për të parandaluar rrjedhjen e ndotësve të kalojnë në drejtim të rrymës. Ndikimi i mbetur mbi mjedisin e ujit për këtë arsye është konsideruar të jetë i papërfillshëm (negativ).

Ky ndikim do të jetë i përkohshëm dhe i kthyeshëm.

Ruajtja e karburantit dhe kimikateve në kantier gjatë fazës së ndërtimit do të paraqesë një rrezik potencial të rrjedhjeve apo derdhjeve. Metodën më të mirë do të aplikohen në praktikë duke përfshirë rrethimin dhe izolimin e zonave të magazinimit dhe duke i mbajtur larg nga receptorët e ndjeshëm (ujit në këtë rast) si dhe gjetjen dhe asgjësimin e sigurt të mbeturjeve (p.sh. të zeza). Ndikimi i mbetur mbi mjedisin e ujit për këtë arsye është konsideruar të jetë i papërfillshëm (negativ).

Ky ndikim do të jetë i përkohshëm dhe i kthyeshëm.

Perdorimi i energjis elektrike :

Pika e lidhjes me tensionin e mesëm përcaktohet nga Ndërmarrja e Elektrikut që mbulon rrjetin shpërndarës të zonës, ku do të ndërtohet objekti dhe varet nga :pozicioni i objektit;nga linjat e tensionit të mesëm që kalojnë pranë objektit dhe nga ngarkesa që do të furnizohet me energji elektrike . Nga ana e përfituesit duhet të paraqitet pranë ndërmarrjes efektive, projekti elektrik i objektit së bashku me kërkesën për fuqinë e instaluar të tij.

Në pikën e lidhjes duhet vendosur një ndarës tensioni për linjën e re dhe në rast se pika e lidhjes është në një shtyllë, pra në ambientin e jashtëm, duhet që të bëhet tokëzimi i të gjitha pjesëve metalike (konstrukcioni mbajtës i ndarësit, sistemi i hapjes së ndarësit etj.) si dhe të bëhet mbrojtja atmosferike e saj.

Të dhënat teknike të ndarësit duhet të përcaktohen nga Inxhinieri Elektrik projektues në bazë të linjës ekzistuese ku do të bëhet lidhja, të ngarkesës që do të furnizojë kjo linjë, si dhe të gjatësisë së linjës së re.

Tabela 5.5 Permbledhje e vleresimeve te ndikimit ne mjedis gjate shfrytezimit

Parametri mjedisor	Burimi	Vlera e ndikimit		
		E ulet (U)	Mesatare (M)	E Larte (L)
Ndotja e ajrit	Motorrat e makinave	U		
	Pluhur nga levizja makinave	U		
Ndotja e ujit	Kullimi	U		
	Mbetje te tjera	U		
Ndikimi ne trafik	Levizjet e makinerive	U		
	Levizjet e punonjesve	U		
Mbeturina te ngurta	I gjithë aktiviteti	U		

Mbeturinat :

Problemi i prodhimit te mbeturinave nuk do te jete aq i rendesishem sa në periudhën e ndërtimit , sepse ndërtimi i këtij objekti mund te prodhoje mbeturina kryesisht të karakterit urban ne sasi te vogla . Keto mbeturina nuk jane te rrezikshme dhe llojet, sasite, data dhe menyra e largimit te te gjithë mbeturinave do te jene objekt i koordinimit me sektore te tjere afer struktures .

Menaxhimi efektiv i kullimit përgjatë rrugës gjatë fazës së shfrytëzimit është thelbësor për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe cilësisë së ujit. Projektimi i kanaleve të kullimit është bërë dhe normalisht do te zbatohet gjate ndertimit duke e konsideruar këtë kanal si korridor natyror.

Kullimet e jashtme (dmth ato nga zonat natyrore ujëmbledhëse përreth) do të mbli dhen në sistemet e vecanta të kullimit dhe të shmangen nga rruga;

Kullimi i brendshëm (dmth largimi nga sipërfaqja e rrugës) do të trajtohen në këtë mënyrë:

Teknika të qëndrueshme të kullimit do të përdoren kudo në praktike;

Sistemet e kullimit të hapur do të përdoren duke zevendësuar tubat aty ku është e mundur. Në zonat me vlerë të lartë ekologjike një shtresë e dytë e trajtimit do të përdoret në formën e një ”end of the line” për sedimentin e pellgut (në zonat me vlerë të moderuar ekologjike) ose ligatinave të ndërtuara (në zona me vlerë relativisht të lartë ekologjike).

5.5.1 –Tokat me bimesi

Ndikimet Forca dhe shtrirja në kohë e ndikimit

Zhurmët gjatë ditës dhe ndikimet vizuale (p.sh. lëvizja e automjeteve dhe të njerëzve) si edhe ndikimit e ndricimit nga dritat e automjeteve gjatë natës mund të ulin mundësinë e përshtatshmërisë për gjitarët apo shpendët që mund të ndodhen në afërsi të rrugës. Këto ndikime do të jenë të larta për zonën ngjitur me rrugën dhe më të ulta larg saj. Të gjitha këto ndikime do të ulin numrin e gjitarëve apo shpendëve në zonat pranë rrugës.

Ndikimi tjetër është sepse mbyllja e korridoreve natyrore do të sjell aksidente dhe demtime të gjitarëve që do të përpiqen të kalojnë rrugën.

Kohëzgjatje e ndikimeve

Ndikimet vizuale (lëvizja e automjeteve dhe të njerëzve) do të jenë të theksuara gjatë ditës. Ndikimet në specie të tilla si shpendë dhe gjitarëve do të jetë më të madh gjatë sezonit të shtimit.

Kthyeshmëria

Këto ndikime nuk janë të kthyeshme pasi ato do të zgjasin për aq kohë sa rruga është në përdorim.

Koha dhe Frekuenca

Ndikimet e ndriçimit do të ndodhin vetëm natën. Ndikimet vizuale (lëvizja e automjeteve dhe të njerëzve) do të jenë më të larta gjatë ditës. Ndikimet të shpendëve do të jenë më të mëdha gjatë sezonit të shtimit të shpendëve. Duke marrë parasysh ndikimet e mundshme mbi shpendët dhe gjitarëve të vegjël është konsideruar se ndikimi në tokat bimore do të jetë **negativ**.

5.5.2 –Habitatet

Koha dhe frekuenca e ndikimit

Një sere ndikimesh të rëndësishme të vazhdueshme janë parashikuar nga ndotja aksidentale të tilla si clirimi i hidrokarbureve, kripë rrugore, rrjedhje të tjera në habitatet ujore. Ndotje aksidentale mund të jetë shumë e dëmshme për mjedisin ujor. Ndotja aksidentale zakonisht është e kthyeshme me masa të përshtatshme kohë, dhe në varësi nga shkalla e ndotjes.

Kohëzgjatja

Ndikimet mund të ndodhin gjatë gjithë jetës së rrugës.

Kthyeshmëria

Efektet e ndotjes dhe çrregullimeve fizike në faunë janë të kthyeshëm brenda një periudhe normale (p.sh. brenda 1 deri në 2 vjet) edhe pse kjo do të varet nga lëvizshmërinë e faunës në zonat ujore të prekura. Ajo ka tendencë të jetë afatgjatë, vetëm kur ndodh një ndotje e cila çon në reduktime afatgjatë të biodiversitetit në lumenj. Një ngjarje diskrete ndotjes, gjithsesi mund të ketë pasojë të rënda në drejtim të rrymës nga vendin e ndotjes.

Koha dhe Frekuenca

Ndikimet e ndotjes mund të ndodhë në çdo kohë. Rreziku i ndotjes nga trafiku për faunën do

të jetë më e lartë gjatë sezonit të shtimit. Gjatë funksionimit të rrugës mund të ketë ndikime të rëndësishme në faunën ujore si rrjedhojë e ndotjes aksidentale dhe nga rritja e rrezikut të përplasjes. Prandaj është konsideruar se ndikimi në rrjedhat e ujit dhe të habitateve bregore të korridorëve do të jetë i moderuar.

5.5.3 –Reptilet

Forca dhe shtrirja në kohë e ndikimit

Rruga e propozuar mund të rezultojë të shkaktojë shtypje të mëdha prej atutomjeteve të zvarra nikëve që do të përpiqen të kalojnë rrugën e zakonshme të tyre. Speciet që do të preken drejtpërdrejt përfshijnë breshkën ,hardhucën e gjelbër Evropian, gjarpërinjtë dhe nëpërkat që jetojnë në këtë habitat . Studimet kanë treguar për shtypjen nga automjetet dhe vdekshmërisë 100% të breshkave që përpiqen të kalojnë një rrugë me shumë dy korsi). Hapja e disa korridoreve natyrore do të sillte një ulje të këtij raporti.

Kohëzgjatja

Pa marrë masat zbutjese ndikimi mund të jetë shumë afatgjatë mbi statusin e ruajtjes së specieve.

Kthyeshmëria

Individët e specieve mund të zëvendësohen nëpërmjet proceseve natyrore të shtimit dhe të shpërndarjes; megjithatë nëse ndikimi është shumë i lartë, popullsia nuk mund të jetë kurrë në gjendje të mbulojë të madhësisë origjinale të popullsisë fillestare dhe kjo do të ishte e pakthyeshme.

Koha dhe Frekuenca

Ndikimet do të jetë më e lartë gjatë sezonit të shtimit kur zvarranikët janë shumë aktive, por mund të ndodhë edhe në fund të dimrit kur individët lëvizin nga vendet e tyre të shtimit drejt vendeve të gjumit letargjik.

6 –Plani i menaxhimit të mjedisit

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marrëdhënie me mjedisin , duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM) , qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet në rastin tone të ndërtimit të këtij objekti rrugor .

Tabela 6.1 Praktika e menaxhimit të mbetjeve në teresi

Nr	Lloji i mbetjes	Riciklim/Riperdorim	Djegje	Groposje	Depozitim
1	Mbeturina ndërtimi	☼		☼	☼
2	Mbetje drusore	☼	☼		
3	Mbetje plastike	☼			
4	Ene boshe	☼		☼	
5	Copa të ngurta betoni			☼	☼
6	Mbeturina leckash		☼		
7	Mbeturina letre , kartoni	☼	☼		
8	Mbetje tubash plastike	☼			

Objekti i përgjithshëm është që të minimizohet ndikimi i mbetjeve që prodhohen gjatë fazës së ndërtimit nëpërmjet masave të mëposhtme:

- të minimizohet sasia e mbetjeve që prodhohen
- të rritet në maksimum sasia e mbetjeve që përdoren për riciklim – përfshirë veçimin e mbetjeve të riciklueshme në burim
- të minimizohet sasia e mbetjeve që depozitohet në vendin për groposjen e mbetjeve
- të garantohet që çdo mbetje e rrezikshme (p.sh. vajra të etj) janë magazinuar në mënyrë të sigurtë dhe janë transferuar në ambientet e përshtatshme
- të shmangen ndikimet e pluhurit nga trajtimi i mbetjeve të ndërtimit
- të garantohet që të gjitha mbetjet mbahen , etiketohen dhe asgjësohen si duhet , në përputhje me rregulloret lokale , dhe
- të garantohet që mbetjet asgjësohen në përputhje me hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve.

Çështjet e mëposhtme janë pjesë përbërëse e PMM dhe bazohen në praktikën më të mirë ndërkombëtare për menaxhimin e mbetjeve dhe në përputhje me direktivën e BE dhe legjislacionin shqiptar.

Qëllimi i gjerë i PMMS është:

- ☞ Të ofrojë një mekanizëm për të siguruar se masat e propozuara për zbutjen e ndikimeve negative mjedisore janë marrë në konsideratë ose zbatuar
- ☞ Të sigurojë që standardet e praktikave të mira të ndërtimit janë aplikuar gjatë ndërtimit të rrugës
- ☞ Të ofrojë një kornizë për zbutjen e ndikimeve që mund të jenë të papara shikuara ose i paidentifikuar që mund të ndodhin apo rastisin gjatë procesit të ndërtimit.
- ☞ Për të ngritur siç është e nevojshme, një ndërveprim që do të ndihmojë palët e treta të kuptojnë kontekstin dhe qëllimin e këtij projekti në përmbushjen e kërkesave mjedisore
- ☞ Të ofrojë një kornizë për monitorimin e pajtueshmërisë për të treguar se si performanca mjedisore në këtë projekt është duke u përmbushur.

PMMS do të zhvillohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. Kontraktori duhet të reflektojë në të gjitha proceset e punës rekomandimet e planit. Është përgjegjësi e kontraktorit për të siguruar që PMMS është zbatuar.

Planet e Menaxhimit mjedisor, identifikojnë legjislacionin që duhet respektuar gjatë zbatimit të projektit, analizojnë karakteristikat mjedisore të zonës, duke përshkruar mjediset sociale dhe ato natyrore. Plan i menaxhimit mjedisor për segmentin rrugor është i përqëndruar në të dy fazat, fazën e punimeve dhe të shfrytëzimit. Ky plan përbëhet nga plani i masave zbutëse të ndikimit në mjedis dhe program i monitorimit Agjensitë zbatuese të Planit të Menaxhimit do të jenë kontraktori i projektit, Autoriteti Kontraktor, Drejtoria Rajonale Mjedisit e Qarkut Durrës , Bashkia Kruje .

Kontraktori do të sigurojë në masën e mundshme që të gjitha komponentët mjedisore të menaxhohen në përputhje me legjislacionin e Shqipërisë dhe angazhimet e tjera mjedisore sipas rastit. Kontraktori do të paraqesë në vijim:

- ⇒ Menaxhimin e mjedisit, sigurinë në punë dhe shëndetin gjatë operacioneve të ndërtimit
- ⇒ Komunikim të hapur dhe bashkëpunim me subjektet e përfshira në punimet e ndërtimit, duke përfshirë punonjësit, grupet e interesit në lidhje me menaxhimin e mjedisit, sigurinë dhe shëndetin
- ⇒ Zbatimi efektiv të politikave dhe planeve të mbrojtjes së mjedisit, sigurisë dhe shëndetit;
- ⇒ Rishikim i rregullt i këtyre politikave dhe planeve nëse do të nevojitet
- ⇒ Direktiva të qarta për stafin që do të menaxhojë planin e mjedisit, sigurisë dhe shëndetit.
- ⇒ Alokimi i burimeve për implementimin dhe mbarëmbajtjen e planit mjedisor, të sigurisë dhe të shëndetit si edhe të aktiviteteve që mund të zhvillohen për këto çështje;

⇒ Caktimi i përgjegjësisë dhe përgjegjshmëria për zbatimin e planit mjedisor, të sigurisë dhe shëndetsor;

⇒ Komunikime të vazhdueshme të lidhura më çështjet mjedisore me autoritetin kontraktual (ARRSH)

⇒ Mbështetja dhe pjesëmarrja për të ruajtur një mjedis të sigurt;

Projekti do të përputhet me legjislacionin përkatës udhëzimet dhe miratimet e Qeverisë së Shqipërisë për ndërtimin dhe fazat operative të projektit.

6.1 –Rekomandime per minimizimin e ndikimeve negative

Rekomnadamet e VNM per kete projekt :

Ndikimi ne mjedis	Faza e ndikimit	Vendndodhja	Masat zbutese	Pergjegjesia
Toka dhe Gjeologjia				
Zbulim i tokës së ndotur gjatëfazës së ndërtimit	Gjatë ndërtimit	Në kantier(zonën e ndërtimit)	-Vezhgimi I tokës për ndonjë ndotje të mundshme gjatë fazës së ndërtimit conform ligjeve -Nëse evidentohet ndotje, duhen marre mostrat e ne terren dhe të bëhen analizat e nevojshme -Të bëhet një vlerësim i duhur i rrezikut për të parë nëse ka rrezik për punonjësit -Punonjësit të vishen me rroba të përshtatshme për të parandaluar ndotjet e rrezikshme	Kontraktori
Heqja e dherave	Gjatë ndërtimit	Në kantier	-Përdorimi I guroreve pranë kantierit përpara hapjes te guroreve të reja apo marrjes me qera të tyre -Heqje me kujdes e shtresës së tokës për të mundësuar pasterinë maksimale të saj me qëllim përdorimin e mëvonshëm për	Projektuesi Kontraktori
Ndotja e truallit	Gjatë ndërtimit	Në kantier	-Asnjë nga materialet të parashikuar për restaurim nuk duhet të përdorën pa qene të certifikuara na ana e cilësië. -Përzgjedhja e standarteve më të mira të projektimit të sistemit të drenazhimit	Projektuesi Kontraktori
Hidrologjia				
Ndikimi në ujërat nëntokësorë	Gjatë ndërtimit	Në kantier	-Përdorimi i guroreve aktuale në mënyrë sa më eficiente të jetë e mundur me qëllim moshapjen e të rejave të cilat mund të ndikojnë në ujërat nëntokësorë. -Të kufizohet koha e punimeve në rastin kur ujërat nëntokësore apo burimet që mund te hasen gjatë ndërtimit të rrugës shërbejnë si furnizues të burimeve të ujit të pijshëm	Projektues i Kontraktor i

Ndikimi në ujërat nëntokësore	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Në kantier	-Projektim shumë i mirë i sistemit të drenaxhimit me qëllim moslejimin e ndotesve në ujërat nëntokësore në raste aksidentesh. -Mirëmbajtja dhe kontrolli periodik i automjeteve që do të punojnë në kantier -Ruajtja dhe magazinimi shume i mirë i lendeve djegëse dhe atyre kimike duke ruajtur dhe rezervën prej 110 % kapacitetit magazinues. -Rrjedhjet që mund të ndodhin në kantier duhet të pastrohen përpara se të depërtojnë në tokë -Tepëricat e ujit nga larja e makinerive do të depozitohen brenda një zone nga e cila duhet të hiqen mbetjet apo balta para shkarkimit të ujit. -Limitim i ndikimit në mbulesën e tokës gjatë punimeve -Ujërat e zeza që rrjedhin nga çdo WC portative të hidhen në konteinerë të vulosura, të cilat duhet të zbrazen periodikisht në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza. -Zbatimi i standarteve më të mira për të zbutur ndikimin e mundshëm të cilësisë ujërave nëntokësore nga cilrimi i substancave të rrezikshme -Parashikimi i mirëmbajtjes së rrugëve për të eliminuar ndotjet nga vajrat apo rënia e baltës gjatë shfrytëzimit të rrugës -Përdorimi sipas normave të herbecideve	Kontraktori
-------------------------------	----------------------------------	------------	---	-------------

Cilesia e ajrit bazuar ne praktikatat me te mira :

Emetimet nga makineritë dhe pajisjet	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Në zonën e kantierit të ndërtimit, zonat përreth tij, si edhe në rrugët ku automjetet e ndërtimit do të qarkullojnë	-Kujdes në mbulimin e automjeteve gjatë transportit të dherave -Kontrolli teknik dhe mirëmbajtja e automjeteve dhe pajisjeve -Përdorimi dhe makinerive dhe i pajisjeve sa më të mira të mundshme nga ana e parametereve mjedisore -Marrja në konsideratë e karburanteve bio -Monitorim periodik i proceseve të punës së këtyre pajisjeve	Kontraktori
Pluhuri nga ngarkimet dhe shkarkimet e ndryshme	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	-Minimizimi i shkarkimit nga lartësia e materialeve të ndërtimit dhe dherave	Kontraktori
Pluhuri nga transporti i materialeve	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Në zonën e kantierit të ndërtimit, zonat përreth tij, si edhe në rrugët ku automjetet e ndërtimit do të qarkullojnë	-Kontrolli i shpejtesive; mokolimi i shpejtesive limit -Mosngarkimi sipër normave të automjeteve të transportit të materialeve të ndërtimit dhe dherave dhe mbulimi i tyre kur është i detyruar -Kontrolli i lagës së rrugës si masë për eliminimin e pluhurit -Kur uji është pa efekt në largimin e pluhurit, mund të përdoren co- polimere që bëjnë pluhurin jo aktiv. -Instalimi i një pasjise për larjen e gomave kur dilet nga kantieri. -Projektim i mirë i akteve ndihmëse të transportit për të shkaktuar sa më pak ndotje gjatë ndërtimit të rrugës.	Kontraktori

Pluhuri i shkaktuar nga era mbi sipërfaqet e prekura nga erozioni	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	-Kontrolli i lagështirës dhe presionit të saj -Mbulimi i materialve stok; -Rivegjetimi i zonave të zhveshura aty ku është e mundur	Kontraktori
Zhurma				
Zhurma që do të ndihet gjatë punimeve të ndërtimit si pasojë e makinerive, oproceseve të punës etj.	Gjatë ndërtimit	Në kantier dhe perreth tij	-Shmangni punën e panevijshme të makinerive dhe fikini kur nuk kerkoni që ata të kryejnë një punë të caktuar -Ndizni pajisjet gradualisht dhe jo njeherësh -Mirëmbajtje dhe inspektim i mjeteve dhe makineri ve në kantier -Puna vetëm në orare të caktuara të pajisjeve që gjenerojnë zhurma që mund të ndikojnë të receptorët -Në rast të zhurmave të mëdha të përdoret sistemi paralajmërues -Përdorimi i pajisjeve silencuese aty ku do të kërkohet sipas niveit të gjobnruar të zhurmës -Pajisjet e zhurmshme si pompa, gjenertorë të vendosen sa më larg të jetë e mundur nga receptorët; -Izolimi i zhurmave kur këto do të gjenerohen pranë zonave të banuara, shkollave, kopshteve spitaleve; vendosja e pajisjeve izoluese për të të qëllim.	Projektuesi Kontraktori
Zhurma gjatë funksionimit të rrugës	Projektim dhe shfrytëzim	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	-Minimizimi i rënies nga lartësitë e materialeve -Sa të jete e mundur afrohini me njëra tjetren pajisjet zhurme gjeneruese; -Përdorimi i shtresave mbrojtëse -Projektim i mirë i rrugës -Parashikimi i masave shtese izoluese për zhurmat nëse kjo do të shihet e arsyeshme -Prerjet dhe përforcimet e ndryshme -Mbulim i plotë ose i pjesshëm i amnienteve të ndryshme -Instalimi i dritareve më izolues ndaj zhurmave nëse do të kërkohet; -Përmirësimi dhe izolimi ndaj zhurmave të cative nëse do të kërkohet	Projektuesi klienti
Ekologjia				

Shqetësimet në ekologji	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Në kantier	• Zbatimi i të gjitha ligjeve lidhur me biodiversitetin dhe specie e mbrojtura • Marrja parasysh e efekteve direkte dhe indirekte që mund të ketë ndricimi, sinjalistika në ekologjinë e zonës • Shmangia apo minimizimi sa më shumë të jetë e mundur i prerjes së pemëve • Kujdes gjatë punimeve në sezonin e shtimit të shpendëve • Sipas rregullave kufizimi i ndricimit në zonat e ndjeshme • Vendosje dhe pozicionim i mirë i makinerive në kantier • Shmangia e dëmtimeve në rrjedhat ujore • Aplikimi i metodave më të mira në ndërtim për të minimizuar sasinë e pluhurit të depozituar • Pëllgje të vecante për balancimin e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore • Parashikimi i hapësirave të reja të mbjella me peme dhe shukurre të zonës apo sipërfaqeve të gjelbra aty ku është e mundur;	Projektuesi Kontraktori Klienti
Shqetësimi i breshkave nga humbja e habitatit	Gjatë ndërtimit	Ndërtim në kantier, si edhe në zonën përreth	• Të bëhet evidentimi i breshkave dhe të bëhet rrethimi i tyre në mënyrë që të eliminohet aksidenti për ngordhjen e tyre . • Siç kërkohet hapja e tuneleve nëntokësore ose tombinove të cilat do të shërbejnë si korridore natyrore për kalimin e sigurt të breshkave apo gjitarëve të tjerë. • Punimet do të monitorohen sipas ligjeve shqiptare	Projektuesi Kontraktori Klienti
Humbja e habitateve	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Ndërtim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	• Mbjelljen e vegjetacionit për të krijuar kushte të mira dhe për të inkurajuar krijimin e habitateve të reja në zonë • Ku është e mundur forcimi i korridoreve natyrore në të dyja anët e rrugës • Shtyllat e habitateve të ndërtohen me material e riciklueshme të mbetura nga pemët që do të priten sepse në këtë mënyrë parandalohet përdorimi i materialeve të reja por janë edhe më komode për zvarranikët • Karakteristikat e ujit që do të kalojnë nëpër drena zhe të jetë në kushte të mira mjedisore që të shërbejë si habitat dhe për specie e ndryshme ujore duke krijuar dhe kushtet për shumimin e tyre • Ndërtimi i tombinove të reja për të shërbyer si korridore natyrore hyrese-dalëse për specie e	Projektuesi Kontraktori Klienti
Humbja e habitateve	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Ndërtim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	• Zëvendësimi i habitateve me të reja kryesisht në zonat e ndotura • Specifikisht në habitatet pyjore mbjellje e pemeve tradicionale të zonës • Habitatet e thata të shndërrohen në lidhave të gjelbra ruara • Në habitate e demtura me shkurre të mbillen të mbillen shkurre me karakteristika të njëjta; • Në habitatet e tokës se punueshme ose të një toke të ndotur(në varësi të largësisë me)	Projektuesi Kontraktori Klienti
Peisazhi				

Humbja e vlerave të peisazhit	Gjatë ndërtimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	•Mbrotjtja e bimësisë së vlefshme dhe pemëve aty ky është e mundur (pranë gjumës së rrugës); •Mbajtjen e bimësisë lokale dhe sipërfaqeve të gjelbëra aty ku është e mundur •Aty ku është e mundur të bëhet mbulimi me bimësi I anëve të rrugës për tu përshtatur sa më mirë me peisazhin lokal; •Mbjellja e bimësisë lokale në zonat e ndotura për të kompensuar humbjen e bimësisë nga gjurma e rrugës •Mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella aty ku është e mundur për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. •Aty ku është e mundur të bëhet projektimi i duhur në mënyrë që tranzicioni midis peisazhit aktual dhe atij që do të formohet pas ndërtimit të rrugës të jetë sa më i lehtë. •Projektimi i strukturave mbajtëse si ura,tombino	Projektue si Kontraktori Klienti
Hidrologjia				
Ndërhyrjet në tokë mund të sjellin rritjen e përqendrimit të pluhurit në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.	Gjatë ndërtimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	•Minimizimi dherave të ekspozuar •Minimizimi sa me shume të jete e mundur i kohezgjatjes së dherave të zbuluar •Mbulimi si prioritet gjate provecece te punimeve •Përdorimi i rrethimeve mbrojtës ne vendet e ekso zuara (dhera, material ndërtimi retj); •Vendosja e dherave te larguar gjate ndërtimit në vend sa më larg burimeve apo rrymave ujore	Kontraktori
Ndotja e sipërfaqeve ujore nga substance kimike dhe ndotës të tjerë	Gjatë ndërtimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	•Mirëmbajtja dhe kontrolli periodik i automjeteve që do të punojnë në kantier •Ruajtja dhe magazinimi shume i mirë i lendeve djegëse dhe atyre kimike duke ruajtur dhe rezerven prej 110 % kapacitetit •Të mbahen pajisjet e nevojshme për eliminimin e menjehershëm te rrjedhjeve të vogla •Rrjedhat nga kantieri apo larja e gomave duhet të grumbullohen në menyrë që të mos përfundojnë në ujërat sipërfaqësorë; and •Rrjedhjet nga ujërat e zeza duhet të grumbullohen në depozita të vecanta dhe të zbrazen periodikisht në vendet e përcaktuara	Kontraktori
Largimi nga rruga i substancave ndotëse dhe marrja e masave për mosderdhjen e tyre në ujërat nëntokësorë	Gjatë ndërtimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	•Aty ku është e mundur drenazhet e jashtme të grumbullohen në sisteme të vecanta të kullimit për ti shmangur nga rruga •Kalimet e rredhave duhet të projektohen në mënyrë të tillë që rrjedhta mesatare ditore të mos pengojnë kalimin mbi to •Largimi i ujit nga rruga të bëhet me system të hapur drenazhimi ndersa në zonat e ndjeshme ky largim të bëhet me systemin e trajtimit fundor të sedimenteve.	Projektuesi Klienti
Kendveshtimi social-ekonomik				

Shpronësimet	Projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	•Përcaktimi i saktë i sipërfaqeve të shpronësimit sipas ligjeve në fuqi •Zbatimi i ligjeve shqiptare per shpronësimin meinters publik •Nje plan social ekonomik për banorët e shpronësuar; •Zhvillimi i një plani monitorimi sipas praktikave më të mira ndërkombëtare	Qeveria e Shqipërisë.
--------------	--------------------------------------	---	---	-----------------------

6.2 –Vleresimi i efekteve ne menyre permbledhese

Efektet përmblendhëse do të jenë një kombimin e të gjithë efekteve të komponentëve mjedisorë. Ndikimi nga një ndërhyrje mund të mos jetë shumë i rëndësishëm por në kompleks ato mund të jenë shumë të rëndësishëm.

Efekti përfundimtar i një aktiviteti që mund të ndikojë në cilësinë e mjedisit mund të përkufizohet si:

"Ndikimet që rezultojnë nga ndryshimet në rritje të shkaktuara nga e kaluara, veprimet aktuale dhe ato të parashikuara në të ardhmen që do të shoqërojnë një projekt të caktuar"

Matrica përmblendhëse e ndikimeve është një procedurë sistematike që shërben për identifikimin, vlerësimin dhe rëndësinë e efekteve nga ndërhyrjet e parashikuara. Qëllimi i saj në nivel projekti është marrja në konsideratë e efekteve në rritje të cilat mund të shkaktojnë projektin i cili është fokusi i këtij Raporti Mjedisor së bashku me ndikime nga aktivitete të tjera.

Vlerësimi i efekteve përmblendhëse është i nevojshëm në nivel projektesh në VNM-së përcaktohet nga Direktiva Evropiane të Komunitetit "vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin" (85/337 / EEC) si amenduar nga Direktiva e Këshillit 97 / 11 / EC.

6.2.1 –Metodologjia e vleresimit

Ka metodologji të shumta për vlerësimin e efekteve përmblendhëse përfshirë aplikimin e modeleve, matricat dhe analiza të pragut. Metodologjia e adoptuar në këtë vlerësim është përqëndruar në identifikimin dhe vlerësimin e receptorëve kyçe të ndjeshëm të identifikuar përmes procesit të VNM.

Vlerësimi i efekteve indirekte dhe përmblendhëse duhet të jetë një proces i hapur dhe rezultatet e procesit të vlerësimit duhet të integrohen në hartimin e projektit dhe aplikimin e masave lehtësuese. Metodologjia e miratuar përfshin tre faza:

Faza 1: Përcaktimi i parametrave të vlerësimit, identifikimin e receptorëve kyçe të ndjeshme dhe përmblendhjen e ndikimeve të mundshme mbi receptorët e ndjeshmërisë

Faza 2: Identifikimi i natyrës dhe madhësisë së ndikimit;

Faza 3: Rekomandimet për masat zbutëse.

Faza e parë e vlerësimit është identifikimi i parametrave të vlerësimit dhe përcaktimi i të dhënave bazë të mjedisit ku një projekt do të aplikohet.

Të dhënat bazë

Të dhënat mjedisore bazë të zonës së studimit sigurojnë kontekstin për vlerësimin e ndikimeve të mundshme të një projekti. Ky vlerësim ka shfrytëzuar të dhënat bazë të siguruar nga literatura, konsultim me ekspertë të tjerë si dhe humultimi në terren i ndërmarrë gjatë përgatitjes së këtij RP.

Kufijtë hapësinore të zonës së projektit

Përcaktimi i kufijve gjeografike të projektit është një pikë kyçe për të siguruar se projekti është

vlerësuar sa duhet. Ky kufi është përcaktuar duke pasur parasysh karakteristikat e projektit dhe gjurmët e tij si edhe duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Disponueshmëria e të dhënave bazë;
- Gjetja e shkallës më të përshtatshme gjeografike për vlerësimin I ndikimit (psh për vlerësimin e peisazhit).

Faza 1:

Fokusi i këtij vlerësimi është identifikimi i receptorëve kyçe të ndjeshëm në kuadër të mjedisit pritës të cilët mund të ndikohen nga projekti. Receptorët janë identifikuar fillimisht nga ekspertët e mjedisit dhe përmes konsultimeve janë përgjedhur receptorët kyc si më poshtë:

- Ndikimi në çështjet social-ekonomike
- Çështjet e peisazhit
- Karakteri lokal i peisazhit
- Habitatet e mbrojtura
- Specie e mbrojtura
- Kryqëzimet rrugore
- Parashikimi i transportit publik
- Kapaciteti i nevojshëm i rrugës dhe parashikimi
- Rreziku i përmbytjeve
- Cilësia e ujërave sipërfaqësorë të larguar
- Gjendja e ujërave nënoksore dhe rreziku nga ndotja
- Ndikimi i zhurmës
- Trashëgimia kulturore dhe burimet arkeologjike
- Toka dhe agrikultura

Zhvillime te ngjashme

Nuk parashikohet ndonje zhvillim tjetër i ndonjë projekti të ngjashëm rrugor në këtë zonë. Si rrjedhojë të gjitha vlerësimet do të bëhen sipas kushteve aktuale dhe ndikimet do të llogariten edhe për fazën e shfrytëzimit.

Faza 2

Faza 2 e vlerësimit vlerëson natyrën dhe shkallën e ndikimeve të mundshme të identifikuara në fazën 1.

Natyra e Ndikimeve

Natyra ose lloji i ndikimit të identifikuar nga konsultimi me ekspertë të tjerë si edhe humul timi në terren për këtë projekt. Kjo fazë përqendrohet në mënyrë të veçantë në identifikimin e tipit të ndikimit “të cilat mund të rrisin rëndësinë e përgjithshme të një ndikimi në një receptor të ndjeshëm kur konsiderohen së bashku .

Vlerësimi i ndikimeve

Efektet e mundshme të ndikimit të projektit, janë vlerësuar në secilën prej seksioneve teknike brenda këtij PM.

Faza 3

Masat zbutëse të përshkruara në këtë fazë dhe te përfshirë në hartimin e projektit tregon se për shumicën e efekteve potencialisht të rëndësishme të parashikuara, efektet e mbetura janë të papërfill shme dhe gjithashtu identifikon efektet e Zhvillimit të Propozuar mbi receptorët e ndjeshëm të përshkr uar më lart.

Efektet e identifikuara nga receptorët e ndjeshëm

Receptoret e ndjeshëm	Efektet e mbetura
Efektet social-ekonomike	↗
Peizashi	↘
Karakter i paisazhit lokal	↘
Bimesia e mbrojtur	Ø
Fuana e mbrojtur	Ø
Rruga dhe kapaciteti mbajtes	Ø
Parashikimi i transportit publik	↗
Rreziku nga permbytjet	↗
Ndotja e ujerave siperfaqesore	Ø
Ndotja e ujerave nentokesore	Ø
Ndikimi i zhurmave	↘
Arkeologjia dhe trashegimia kulturore	Ø
Toka dhe agrikultura	↘
Total	↗

↗-ndikim pozitiv ↘- ndikim negativ Ø-neutral

Nuk parashikohen ndikime negative nga rezultati i vlerësimit përmblendhës të projektit . Asnjë masë zbutëse shtesë nuk do të kërkohej mbi ato të identifikuar në këtë raport dhe të integruara tashmë si pjesë e projektit.

Ky vlerësim përmblendhës i efekteve ka shqyrtuar kontributin në rritje të projektit të propozuar së bashku me ndikimet e mundshme nga zhvillime të tjera të afërta.

Vlerësimi është fokusuar në mënyrë të veçantë mbi receptorët e ndjeshëm të identifikuar përmes Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projektit si edhe duke shqyrtuar natyrën dhe rëndësinë e çdo ndikimi të mundshëm që mund të lindin në këto receptorë. Përmblendhja e vlerësimit të efekteve është konsideruar gjatë gjithë procesit të VNM dhe si i tillë, shumë prej ndikimeve të përmendura janë përfshirë në masat zbutëse të propozuara.

Parimet e minimizimit të mbetjeve

Sistemet e menaxhimit të inventarit do të azhurnohen për të përcaktuar konsumin e produkteve, për të siguruar të dhëna të dokumentuara për çdo fazë të procesit zinxhir të mbetjeve dhe për të identifikuar humbjet e mundshme dhe konsumin e tepërt.

Do të ruhet një inventar për të gjitha mbetjet që janë prodhuar dhe asgjësuar (lloji dhe volumi) , në bazë të inventarit të rishikimit periodik.

Ndarja e mbetjeve të ngurta sipas klasifikimit të përcaktuar

Mbetjet që prodhohen gjatë fazës së ndërtimit kanë mundësi që të klasifikohen në katër kategori për tu asgjësuar:

- inerte (dhe, mbetje ndërtimi, materiale ndërtimi të papërdorura, etj.),
- konsumatore ,
- me vaj & të rrezikshme dhe të lëngshme.

- Konteinerët/koshat metalikë do të kombinohen me llojet e mbetjeve (karton, plastik, copa metalesh, me vaj, të rrezikshme nëse ka, etj.), me qëllim që të mundësohet ndarja/veçimi.

Mbeturinat do të ndahen nga punonjësit e kampit dhe punonjësit që do të trajtojnë mbetjet do të trajnohen. Nëpërmjet “procedurave” do të instruktohen punonjësit për trajtimin e mbetjeve në kantieret e ndërtimit dhe në kampe. Kompanitë që ofrojnë shërbime do të kalojnë përmes një procesi kualifikimi dhe do të kontrollohen gjatë periudhës që ofrojnë shërbim.

Depot e mbetjeve të ngurta

Në kantierin e ndërtimit do të krijohet një hapësirë për ruajtjen e mbetjeve ditore, e përbërë nga konteinerë/kosha metalikë. Në fund të ditës së punës mbeturinat në koshat metalikë do të transportohen në zonën e kampit dhe do të futen në depo.

Depoja do të jetë në kamp dhe e mbuluar pjesërisht me çati. Koshat metalikë për mbetjet me vaj ose mbetje të tjera të rrezikshme do të jenë të papërshkueshëm nga uji.

Procedurat për mbushjen e serbatorëve të makinave dhe trajtimin e mbetjeve/materialeve të rrezikshme do të përcaktohen përpara fillimit të ndërtimit.

Ripërdorimi i mbetjeve/mundësitë e riciklimit

Mbetjet do të ndahen sipas rregulloreve lokale dhe materialeve ricikluese që përpunohen në Shqipëri. Materialet ricikluese do të grumbullohen rregullisht nga kompanitë lokale, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave).

Pjesa më e madhe e dheut të gërmuar do të përdoret për të rimbushur kanalet.

Ekziston mundësia që dheu i tepërt të shpërndahet dhe konturohet përgjatë gjurmës së rruges. Argjila bentonite e përdorur në metodën e kalimit pa gërmuar kanal (GDH) do të riciklohet.

Transferimi i mbetjeve

Trasferimi i mbetjeve do të kryhet nga kompani të certifikuara; automjetet do të kenë të gjitha pajisjet, duke marrë parasysh llojin e mbetjeve që do të transportohen. Nuk është parashikuar eksporti i mbetjeve.

Asgjësimi përfundimtar i mbetjeve

Vetëm kompanitë e certifikuara nga autoritetet përkatëse (Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave) do të përdoren për asgjësimin e mbetjeve; është siguruar një listë e kompanive të certifikuara për menaxhimin e mbetjeve nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, e cila konfirmon se do të jetë e mundur që të menaxhohen dhe asgjësohen të gjitha mbetjet e mundshme të ndërtimit dhe funksionimit në ambientet brenda Shqipërisë. Ky proces do të koordinohet plotësisht me autoritetet përgjegjëse.

Mbetjet inerte, të cilat nuk paraqesin rrezik për ndotje, do të asgjësohen në një zonë të kontrolluar për asgjësimin. Mbetjet të tjera do të transportohen në një zonë të caktuar nga bashkia për asgjësimin e mbetjeve.

Mbetjet me vaj dhe ato të rrezikshme do të asgjësohen nga firma kontraktore të specializuara në hapësira që janë pajisur dhe aprovuar për mbetje të tilla.

Mbetjet e lëngshme do të grumbullohen nëpërmjet një sistemi të veçantë shkarkimi të ujërave të zeza në zonat e portit dhe do të drejtohen për sistemin publik të ujërave të zeza.

Specifikat e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme

Me qëllim që të sigurohet mbrojtje për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve, grumbullimi, transportimi dhe magazinimi i mbetjeve të rrezikshme do të përfshijë masa për të siguruar të dhëna të dokumentuar për çdo fazë të procesit zinxhir të mbetjeve që nga zona ku prodhohen (kryesisht në kantierin e ndërtimit) deri në zonën përfundimtare ku do të asgjësohen.

Transporti i mbetjeve të rrezikshme duhet të kryhet vetëm me automjete që :

1) kanë pajisjet e përshtatshme për llojin dhe sasinë e mbetjeve të rrezikshme që duhet të transportohen

2) janë të sigurta për tu përdorur në rrugë dhe

3) janë regjistruar më parë për këtë qëllim tek autoritetet përkatëse.

Procesi i regjistrimit të mbetjeve

Të gjitha mbetjet do të regjistrohen pas çdo faze të këtij plani të menaxhimit: ndarjes/veçimit, magazinimit, transferimit dhe pranimi në zonën e asgjësimit.

Kontraktori do të krijojë mundësi që sigurojë të dhëna të dokumentuara për çdo fazë të procesit zinxhir, sidomos për mbetjet e rrezikshme.

Do të rritet në maksimum menaxhimi i mbetjeve në një proces të vazhdueshëm dhe ky plan do të rishikohet në mënyrë periodike gjatë të gjithë fazës së ndërtimit.

Përfundimisht, plani do të përfshijë dispozita për trajnimin e të gjithë punonjësve se si ta përdorin

PMM dhe do të përfshijë procedura në lidhje me komunikimin me palët e interesuar dhe mundësi për përmirësimin e kushteve të komunitetit.

7–Plani i masave te mbrojtjes se mjedisit

7.1–Plani i reagimit ndaj emergjencave (PRE)

Plani i Reagimit ndaj Emergjencave (PRE) përshkruan në një dokument veprimet dhe procedurat sipas zonës specifike, të cilat duhet të ndërmerren në situata emergjence që ndodhin gjatë ndërtimit dhe funksionimit.

Objekti i PRE është për të qenë të përgatitur për të reaguar ndaj çrregullimeve, situatave aksidentale dhe të emergjencës në një mënyrë të përshtatshme për rreziqet operacionale dhe për të parandaluar pasojat e tyre të mundshme negative. Shoqëria ndertuese do të zbatojë kërkesat e strategjisë së BERZH-it (paragrafët 18–22 të KP4) për të identifikuar rreziqet e aksidenteve të mëdha, për të parandaluar aksidente të mëdha dhe për të kufizuar pasojat e tyre mbi njerëzit dhe mjedisin, me synimin për të garantuar nivele të larta të mbrojtjes në një mënyrë konstante dhe efektive.

PRE do të paraqesë në mënyrë të qartë dallimin ndërmjet të gjitha fazave të projektit, duke qenë se masat që duhet të ndërmerren do të jenë të ndryshme gjatë ndërtimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes (nxjerrja nga përdorimi do të kryhet humë vite më pas dhe për këtë arsye do të hartohet një PRE i veçantë, në përputhje me kërkesat përkatëse në atë periudhë).

PRE do të trajtojë incidentet në tokë dhe në det dhe skenarët përkatës të reagimit ndaj tyre.

Përmbajtja e PRE mund të përmbledhet si vijon:

- Dispozitat e legjislacionit shqiptar për emergjencat civile
- Zbulimi i rreziqeve përkatëse (d.m.th. fatkeqësive natyrore, trazirave civile, shkarjeve të tokës, zjarrit ose shpërthimeve, keqfunksionimit të pajisjeve gjatë proceseve, problemet e presionit, etj.) në lidhje me ndërtimin e struktureve se mbyllyr dhe infrastrukturën e instalimit dhe funksionimit si dhe ndikimin e mundshëm mbi mjedisin dhe shëndetin
- Identifikimin e autoriteteve qeveritare, medias dhe palëve të tjera përkatëse të interesuara që duhen njoftuar dhe procedurat e komunikimit me ta
- Masat e nevojshme për të kufizuar pasojat mbi njerëzit dhe mjedisin që kanë lidhje me aksidentet e ndërtim/rikostruksionit te ketij aksi ; bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve vendore dhe qëndrore, si dhe strukturave rajonale dhe komuniteteve lokale, siç përshkru

het në Ligjin për emergjencat civile si dhe mbështetur në praktikat më të mira ndërkom bëtare;

- Të përshkruhen masat e sigurisë teknike si dhe masat e përshtatshme për të mbrojtur publikun ose pasurinë nga rreziqet e mundshme; metodat e mësimave të nxjerra nga aksidentet e gazsjellësit
- Përshkrimi paraprak i strukturës organizative dhe të shpjegohet ndërveprimi me projektin dhe procedurat operacionale
- Identifikimi paraprak i sistemit dhe procedurave për të ofruar strehim në një vend të sigurtë, evakuimin, shpëtimin, trajtimin mjekësor dhe riatdhesimin e personelit , dhe
- Përshkrimi paraprak i aktiviteteve të trajnimit dhe i masave për trajnimin e ekipeve të reagimit dhe për të testuar sistemet dhe procedurat e emergjencave.

Përfundimisht, plani duhet të përfshijë dispozita për trajnimin e punëtorëve mbi procedurat e reagimit ndaj emergjencave dhe do të sigurojë informacion në lidhje me ndërlidhjen e brendshme dhe të jashtme gjatë reagimit ndaj një emergjence.

7.2–Plani i masave social ekonomike

Zvogëlimi i ndikimeve social ekonomike nga projekti i ndërtimit të këtij segmenti rrugor nga ne hyrje te qytetit dhe rruget e brendshme te Krujes përfshin përpjekjet për shmangien e keqkuptimeve për punësim afatgjatë të punëtorëve lokalë, edukimin e popullatës mbi natyrën jo spekulative të ndërtimit të projektit në fjalë, shmangien e konflikteve me pronarët e tokës duke patur parasysh kompensimin si dhe trajtimin me respekt të banorëve të zonës.

Autoriteti kompetent për dhenien e kësaj leje ndërtimi do të bejë dhe po vazhdon të bëjë një punë të planifikuar dhe të kujdesshme, duke identifikuar sipërfaqet do të shtrihet sheshi i veprimtarisë së projektit si dhe vlerat reale të tyre nga regjistri hipotekor i zonës.

Për çdo të papritur që mund të ndodhë gjatë zbatimit të projektit, operatori do të marrë masa të lajmërojnë autoritetet e pushtetit vendor dhe të veprojnë në përputhje me ligjin Shqiptar në fuqi.

Në të kaluarën, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis ka qenë i fokusuar në ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta biofizike të zhvillimeve të propozuara (p.sh. ndikimet e aktiviteteve të zhvillimit ndaj ujit, ajrit, tokës, të florës dhe faunës.

Në vitet e fundit, rëndësi ka marrë edhe ndikimet e zhvillimit social, kulturor dhe ekonomik duke pasur të njëjtën rëndësi me ndikimet e tjera.

Çështjet sociale dhe ekonomike janë një komponent i rëndësishëm i analizës sistematike të përdorura gjatë VNMS për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet e mundshme social-ekonomike të një zhvillimi të propozuar mbi jetën dhe aktualitetin e njerëzve, familjet e tyre dhe komuniteteve në përgjithësi pra nëse këto ndikime të mundshme janë të rëndësishme ose jo. Vlerësimi i Ndikimit Social (VNS) mund të ndihmojë zhvilluesit apo palët e tjera të përshira në projekt të gjejnë mënyra për të parandaluar, minimizuar apo larguar ndikimet negative nëse do të ndodhin. VNS mund të identifikojë dhe të dallojë ndikimet e shumta të matshme të një zhvillimi të propozuar por jo çdo ndikim mund të jetë i rëndësishëm.

Njerëzit mund të ndikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi, kanë një rol ose nëse projekte kti ndikon në komponentët me social-ekonomike. Pra VNS ka tendencën të përqendrohet në shmangien e ndikimeve negative dhe gjithashtu ofron një mundësi për planifikimin dhe maksimizimin e ndikimeve të dobishme të një zhvillimi të propozuar.

Ndikimet e dobishme mund të përfshijnë:

-Një standard më të mirë jetese për shkak të rritjes së aksesit në punësim, mundësive të biznesit,

trajnitimit dhe edukimit;

-Shkurtim të distancave

-Rritja e financimit për përmirësimin e infrastrukturës sociale dhe programeve të kulturore.

Hapat e rëndësishëm të VNS janë dhe përcaktimi specifik i ndikimeve që projekti sjell në rajon. VNS shqyrton komponentët social-ekonomike me vlerë para projektit dhe se si këto komponente mund të ndërveprojnë me komponentet e një zhvillimi të propozuar. Për shembull një ndikim social-ekonomik është kur komunitetet e prekur drejtpërdrejt nga një projekti i cili kërkon shpronësime të tokës ti mundësohet largimi në banesa dhe prona të përshtatshme.

Këto procese mund të përshpejtohen ose të ulin ndikimin duke marrë në konsideratë masat e mëposhtme:

-Duke pasur kampe të mëdha të punës pranë komuniteteve të prekura nga shpronësimet

-Duke punësuar banorë të zonave pranë të cilave shtrihet projekti

-Shtimin e të ardhurave për komunitetin

-Ndërthurja e kulturave të ndryshme.

7.2.1 –Plani i menaxhimit social ekonomike

Qëllimi i një plani të menaxhimit social-ekonomik (SMP) është për të zhvilluar masat e mundshme dhe me kosto efektive sa më të ulët në mënyrë që të zvogëlohen ndikimet negative social-ekonomike të identifikuara në nivele të pranueshme. Një vlerësim i studimit është një mjet i rëndësishëm për të kapur dhe përfshirë konsideratat që mund të kenë efekte të rëndësishme në zhvillimet e projektit. Ai siguron kornizën për studime të thelluara të një VNM dhe masat për zbatimin e ndikimeve.

Këto plane të menaxhimit do të trajtojnë ndikimet specifike të identifikuara. Ato do të përfshijë buxhetet, rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e tij të plotë dhe do të përfshijnë temat kryesore si:

- Asistencë ndaj grupeve të prekura nga ndikimi
- Mekanizmat e ankimimit
- Fluksi i planit të menaxhimit
- Monitorimi dhe planet e vlerësimit
- Planet e ndërgjegjësimit të komunitetit
- Komunikimi i përditshëm për aktivitetet e planit
- Plani i veprimtimit për zhvendosje (nëse do të ketë të tilla)

Çdo zhvillim infrastrukturor mund të kërkojë dhe shpronësimin e tokës dhe në gjurmën e projektit mund të ketë të tilla dhe do të përfshijë sasi të vogla të tokës në pronësi / apo në përdorim nga shumë njerëz. Deri më sot procesi i shpronësimit ka kon sistuar vetëm duke i paguar për humbjen e tokës në bazë të madhësisë së saj.

Gjatë fazës së ndërtimit por edhe të shfrytëzimit mund të ketë disa ndikime jo të drejtpërdrejta por që gjithsesi duhen marrë në konsideratë. Në këtë kontekst, një plan i menaxhimit shëndetsor duhet hartuar. Të përbledhura në një ky plan do të përfshijë komponentët e mëposhtëm.

Ceshtjet e shëndetit	Rregulloret dhe standartet per tu zbatuar	Veprimet për planin shëndetsor
Cilesia e ajrit nga ndotja dhe zhurma e mjeteve të qarkullimit	Normat ndërkombetare të pranuar për llojet e ndetjes	Te specifikuar në kapitujt përkatës
Ndertimi i infrastrukturës së menaxhimit të trafikut	Standartet e BB/IFC	Analizimi i trafikut, marrja e masave normalizuese kur është e mundur.
Korsite e emergjencës	Të gjitha rruget duhet të kene infratrstrukturën e nevojshme per nduihmën e shpejtë	Specifikimet e nevojshme të projektit
Krahu i punës	Udhëzimet dhe këshillat e Bankes Boterore	Kontraktoret dhe nenkontraktot për të zbatuar rregullat kombëtare të shendetësisë
Siguria e trafikut	Banka Botërore, Kodi rrogor Shqiptar	Plan i detajuar për ambulancat, sjelljen e shoferëve në trafik, shërbimet e emergjences, shpejtësitë e lejuara etj
Parashikimi I emergjencave	Banka Botërore	Plane te detajuara me policine dhe institucione te tjera për rastet kur parashikohet transporti I mbetjeve te rrezikshme apo slëndëve shpërthyes apo levizjen e
Koha e mbërritjes së ambulancës	Praktika të ndryshme	Koha e përcaktuar në kodin rrugor të Shqipërisë.
Paralajërimi	Praktika botërore	Ëork shop për edukimin e mbi respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor

7.2.2 –Qëllimi i vleresimit social ekonomike

Qëllimi kryesor i VSE është identifikimi i ndikimeve si edhe gjetja e rrugëve për zbutjen e tyre. Tre faktorët kryesorë në që opërcaktojnë ndikimet në situatën social-ekonomike të një zhvillimi të propozuar gjatë VNMS janë:

- Niveli deri në cfarë stadi do të kryhet studimi i VNMS
- Natyra dhe shkalla e zhvillimit të propozuar;
- Konteksti social-ekonomik i zhvillimit të propozuar.

Praktika ndërkombëtare cilëson 6 etapa për një process të saktë të analizës social-ekonomike:

1. Studimi

Një analizë paraprake që identifikon prioritet, merr informacionin e kërkuar dhe i integron në hartimin e VNMS. Studimi paraprak dhe efektive ngushton fokusin e VNMS në çështjet me rëndësi më të madhe.

2. Profilizimi i kushteve bazë

Fokusohet në mbledhjen e informacionit në lidhje me mjedisin social- ekonomik në kontekstin

e zhvillimit të propozuar. Kjo mund të përfshijë përcaktimin e treguesve të matshëm e komponentëve me vlerë social-ekonomikë.

3. Ndikim i parashikuar

Bazohet në analizën e informacionit të mbledhur nga skanimi i profileve bazë dhe përvojat e ndërkombëtare për të parashikuar ndikimet e mundshme social –ekonomike. Identifikimi i raportit midis ndikimeve negative dhe pozitive të një zhvillimi të propozuar është pjesë e kësaj analize.

4. Identifikimi i rrugëve të zbutjes së ndikimit.

Ndikimet negative të parashikuara kërkojnë zbutjen. Zbutjen përfshijnë strategjitë, planet dhe programet për të reduktuar, për të shmangur ose për të menaxhuar sa më mirë ndikimet e mundshme.

5. Vlerësim i rëndësisë së ndikimit

Përfshin përcaktimin nëse një zhvillim i propozuar ka premisa të shkaktojë ndikime të rëndësishme negative mbi komponentët socioekonomike me vlerë. Nëse masat e përshtatshme zbutëse nuk mund të identifikohen, zhvillim i propozuar nuk mund të miratohet.

6. Aplikimi i zbutjes dhe monitorimi i masave zbutëse

Rruga më e mirë për zbutjen e ndikimeve social-ekonomike kërkon programe të mira të monitorimit për të siguruar zbutja e ndikimeve është duke funksionuar në mënyrë efektive dhe kur është e nevojshme, masat zbutëse mund të përshtaten ashtu siç kërkohet.

7.2.3 –Masat e rekomanduara social ekonomike dhe te shendetit

- Prioritet për punësimin banorët e zonës me qëllim uljen e papunësisë dhe shtimit të të ardhurave
- Kontraktim me kompanitë e zonës të fushës së ndërtimit për mundësi bashkpunimi
- Bashkëpunim me zyrën rajonale të punës për lehtësinë në gjetjen e karhut të përshatshëm të punës
- Punësim të banorëve vendas me qëllim uljen e kostos së transportit apo akomodimit
- Prioritet përdorimi i produkteve të zonës për ushqim, gjë e cila mund të shërbejë edhe si një marketim i mirë i zonës dhe të shtojë të ardhurat për banorët e saj.

Masat e rekomanduara në aspektin e shëndetit:

- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe trainim i punetoreve dhe stafit të ndermarrjes mbi sigurinë në punë.
- Mbajtja në gatishmëri e një këndi të ndihmes se shpejte dhe mjeteve përkatëse për këtë qëllim.
- Mbajtja e detyruar e kaskes dhe mjeteve të tjera të duhura, sipas vendit dhe proceseve të punës
- Numrat e kontaktit të urgjencës duhen publikuar në vende të dukshme në territorin e punës.
- Sinjalizues të pershtatshëm për lajmerimin e rreziqeve duhen vendosur në vendet ku ekzistojnë rreziqet për aksidente. Këto territore duhen rrethuar edhe me pengesa lehtësisht të dallueshme.
- Punonjësit do të punësohen në respekt të ligjeve shqiptare, dhe kontraktori duhet të respektojë kërkesat për kushte optimale higjieno-sanitare të specifikuara nga legjislacioni. Punëdhënësi duhet të garantojë sigurimet shëndetsore

Çdo zhvillim infrastrukturor mund të kërkojë dhe shpronësimin e tokës, dhe në gjurmën e projektit mund të ketë të tilla dhe do të përfshijë sasi të vogla të tokës në pronësi / apo në përdorim nga shumë njerëz.

Deri më sot, procesi i shpronësimit ka konsistuar vetëm duke i paguar për humbjen e tokës në bazë të madhësisë së saj.

Investitori detyrohet te ngrëjë sistemin e parandalimit dhe te kontrollit te aksidenteve, për te shmangur pasojat për jetën, shëndetin e njeriut dhe për mjedisin . Per realizimin e ketij detyrimi investitori do te marre masa efektive si :

- ⇒ Sigurimin e vendit te punes sipas rregullave teknike ne fuqi .
- ⇒ Zbatimin e kohes normale orare te punes dhe pushimin ne menyre qe punonjesi te mos humbase vemendjen .
- ⇒ Punimin ne ambjente te zhurmes me kohe te kufizuar me qellim mosdemtimin e punonjesve qe punojne nen keto efekte.
- ⇒ Pajisjet nen tension do te jene te izoluara , punonjesit qe do te punojne ne keto pajisje si dhe ne pajisjet nen presion duhet te jete te instruktuar me pare dhe te veshur me rroba te caktuara te posacme .
- ⇒ Per garantimin e mbrojtjes se jetes dhe aktivitetit nga zjarri gjate procesit te zhvillimit te aktivitetit eshte projektuar te vendosen fikset e zjarrit ne cdo ambient dhe do ndertohet sistemi i pavarur i mbrojtjes nga zjarri ne rast nevojë ne perputhje me Kushtet e Mbrojtjes nga Zjarri te miratuara me pare si dhe eshte bere instruktimi i duhur i punonjesve qe do te punojne ne aparaturat elektrike dhe pasjisjet e tjera nga personi pergjegjes .

Megjithetkete , egziston mundesia per rast aksidenti , sepse :

- ▲ nga humbja e vemendjes se punonjesit mund te ndodhe zjarr .
- ▲ nga pakujdesia ne perdorimin e makinerive te punes gjate ndertimit mund te aksidentohen punonjesit nga gjymtyret .
- ▲ gjate punimit me makinerine ngritese te automjeteve neuren metalike elektrike duhet vemendje e larte dhe kujdes i madh pasi punonjesit mund te aksidentohen si pasoje e humbjes se vemendjes gjate kohes se punes .
- ▲ gjate transportit te mbeturinave si atyre te ngurta edhe te atyre te lengeta duhet siguruar ngarkesa me kujdes ne menyre qe te mos kete rrjedhje ose renie te ngarkeses nga makina e transportit per shkak te gabariteve te vogla te detaleve .

Duhet te eliminohen rreziqet e mundshme te shkaktuara nga agjentet kimik vajra , karburante etj. ose te zvoglohen ne minimum nepermjet masave te meposhtme:

- a) projektimi dhe organizmi i sistemeve te punimeve ne vendin e punes;
- b) furnizimi me mjetet e pershtatshme per punet specifike dhe procedurat perkatese te mirembajtje
- c) zvoglimi ne minimum i numrit te punetoreve qe jane ose mund te jene te ekspozuar;
- d) zvoglimi ne minimum i kohezgjatjes dhe i intensitetit te ekspozimit;
- e) masat higjenike te duhura;

Masat e marra dhe qe do zbatohen nga investitori jane te mjaftueshme per te zvogluar rrezikun e mundshem .

Qëllimi kryesor i vleresimit social–ekonomik (VSE) është identifikimi i ndikime ve si edhe gjetja e rrugëve për zbutjen e tyre.

Të tre faktorët kryesorë në që përcaktojnë ndikimet në situatën social-ekonomike të një zhvillimi të propozuar gjatë VNMS janë:

- Niveli deri në çfarë stadi do të kryhet studimi i VNMS
- Natyra dhe shkalla e zhvillimit të propozuar;
- Konteksti socio-ekonomik i zhvillimit të propozuar.

Praktika ndërkombëtare cilëson 6 etapa për një process të saktë të analizës social-ekonomike:

- 1) Studimi

Një analizë paraprake që identifikon prioritetet , merr informacionin e kërkuar dhe i integron në hartimin e VNMS. Studimi paraprak dhe efektive ngushton fokusin e VNMS në çështjet me rëndësi më të madhe.

2) Profilizimi i kushteve bazë

Fokusohet në mbledhjen e informacionit në lidhje me mjedisin social-ekonomik në kon tekstin e zhvillimit të propozuar. Kjo mund të përfshijë përcaktimin e treguesve të matshëm të komponentëve me vlerë social- ekonomikë.

3) Ndikim i parashikuar

Bazohet në analizën e informacionit të mbledhur nga skanimit i profileve bazë dhe përvojat e ndërkombëtare për të parashikuar ndikimet e mundshme social-ekonomike. Identifikimi i raportit midis ndikimeve negative dhe pozitive të një zhvillimi të propozuar është pjesë e kësaj analize.

4) Identifikimi i rrugëve të zbutjes së ndikimit.

Ndikimet negative të parashikuara kërkojnë zbutjen. Zbutjen përfshijnë strategjitë, planet dhe programet për të reduktuar, për të shmangur ose për të menaxhuar sa më mirë ndikimet e mundshme.

5) Vlerësim i rëndësisë së ndikimit

Përfshin përcaktimin nëse një zhvillim i propozuar ka premisa të shkaktojë ndikime të rëndësishme negative mbi komponentët socio-ekonomike me vlerë. Nëse masat e përshtatshme zbutëse nuk mund të identifikohen, zhvillim i propozuar nuk mund të miratohet.

6) Aplikimi i zbutjes dhe monitorimi i masave zbutëse

Rruga më e mirë për zbutjen e ndikimeve social-ekonomike kërkon programe të mira të monitorimit (e njohur edhe si folloë-up) për të siguruar zbutja e ndikimeve është duke funksionuar në mënyrë efektive, dhe kur është e nevojshme, masat zbutëse mund të përshtaten ashtu siç kërkohet.

Masat e rekomanduara në aspektin social ekonomik gjatë ndërtimit :

- ☞ Prioritet për punësimin banorët e zonës me qëllim uljen e papunësisë dhe shtimit të të ardhurave
- ☞ Kontraktim me kompanitë e zonës të fushës së ndërtimit për mundësi bashkpunimi
- ☞ Bashkëpunim me zyrën rajonale të punës për lehtësinë në gjetjen e karhut të përshatshëm të punës
- ☞ Punësim të banorëve vendas me qëllim uljen e kostos së transportit apo akomodimit
- ☞ Prioritet përdorimi i produkteve të zonës për ushqim, gjë e cila mund të shërbejë edhe si një marketim i mirë i zonës dhe të shtojë të ardhurat për banorët e saj.
- ☞ Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe training i punetoreve dhe stafit të ndërmarrjes mbi sigurinë në punë.
- ☞ Mbajtja në gatishmëri e një këndi të ndihmes se shpejte dhe mjeteve përkatëse për këtë qëllim.
- ☞ Mbajtja e detyruar e kaskes dhe mjeteve të tjera të duhura, sipas vendit dhe proceseve të punës
- ☞ Numrat e kontaktit të urgjencës duhen publikuar në vende të dukshme në territorin e punës.
- ☞ Sinjalizues të përshtatshëm për lajmerimin e rreziqeve duhen vendosur në vendet ku ekzistojnë rreziqet për aksidente. Keto territore duhen rrethuar edhe me pengesa lehtësisht të dallueshme.
- ☞ Punonjësit do të punësohen në respekt të ligjeve shqiptare dhe kontraktori duhet të respektojë kërkesat për kushte optimale higjeno- sanitare të specifikuar nga legjislacioni.
- ☞ Punëdhënësi duhet të garantojë sigurimet shëndetsore

Për mbarevajtjen e funksionimit normal të këtij aktiviteti në mënyrë që puna të ecë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në shërbim bashkëkohor , si e vetmja mënyrë egzistente , del e domosdoshme sigurimi teknik i punonjesve dhe specialisteve sipas rregulloreve në fuqi si dhe sigurimi shëndetësor dhe shoqëror i tyre. Pa realizimin e këtyre detyrave funksionimi i objektit nuk mund të kuptohet. Për këtë arsye rekomandojmë që instruktimi teknik të bëhet sipas rregulloreve në fuqi .

Duke u kujdesur per minimizimin e efekteve negative dhe rritjen e efekteve pozitive , investitori do te zhvilloje aktivitetin e ndertimit te ketij objekti duke permiresuar kushtet e punes dhe konkretisht :

- Per mbrojtjen e vendeve te punes dhe mjedisit nga pluhurat qe krijohen gjate punes jane marre te gjitha masat per minimizimin e tyre .
- Per ujrane ndotura dhe me mbetje ne sheshet dhe rruget lidhese te sherbimit do te realizohet kullimi i ujrave siperfaqesore ne kanalet e hapura per kete qellim dhe shkarkohen ne kanaline e caktuar te objektit ose ne ate anesor sipas lejes qe do te merret per kete qellim .
- Per eliminimin e rreziqeve gjate furnizimit me energji elektrike te gjithave pajisjeve qe punojne nen tension i’u eshte bere tokezimimi .

7.3–Permbledhje e masave zbutese , kompensimi dhe rritja e masave

Ne identifikimin e masave zbutese, theksi eshte vene ne teknikat e parandalimit te ndotjes te cilat perfshijne teknologji me te pastra dhe minimizim te mbeturinave.

Teknologjite e identifikuarane jane pjese e nje game te gjere teknologjish te perdorura qe konsiderohen te jene praktikane me te mira aktuale per qellimet e vendosjes te vleres kufi te clirimeve te gazeve apo pluhurave ndotes. Gjithashtu do te ndermerren masa te tjera dhe praktika te permiresuara te perpunimit dhe depozitimit te materialeve ne menyre qe te reduktohen clirimet e gazrave. Menaxhimi dhe kontrolli i mjedisit do te fokusohet ne permiresime te vazhdueshme te procedurave me qellim parandalimin, eliminimin dhe /ose reduktimin progresiv te ndikimeve negative ne mjedis.

Objektivat kryesore te zbutjes ekologjike jane per te marre masa per te shmangur ose minimizuar ndikimet negative te skemes mbi vleren ekzistuese per mbrojtjen e natyres se zones si gjate fazes se ndertimit ashtu dhe funksionimit. Aty ku ndikimet negative nuk mund te shmangen ose zvogelohen, do te jete e nevojshme per te permirësuar vleren e natyres permes krijimit te habitateve kompensuese te pershtatshme per lokalitetin.

Prodhimi i shkallës së vlerësimit është të përcaktojë rëndësinë e efekteve të mbetura në karakteristika të ndryshme.

E pasigurt mbetet vendndodhja e tokës në dispozicion për masat e kompensimit vetëm me parimet e krijimit të habitatit të cilat janë të përshkruara për të kompensuar humbjen e habitatit. Vendet ku duhet të bëhet nuk mund të premtohen pa marrë garancitë e nevojshme financiare.

Si parim i përgjithshëm per arritjen e zbutjes dhe kompensimit është propozuar:

7.3.1–Gjitaret

Llojeve të gjitarëve të pranishëm dhe vlera ekologjike e tyre përcatohen ne Direktivat Europiane të Habitave dhe Shpendëve

Direktiva e Habitave EC

Në vitin 1992, Komuniteti Evropian miratoi Direktivën e Këshillit 92/43 / EEC mbi Ruajtjen e habitave natyrore dhe të faunës dhe florës së egër (Direktiva Habitatet EC). Ky është mjeti me të cilin Komuniteti i plotëson detyrimet e veta si nënshkruese e Konventës për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habitave Natyrore Evropiane (Konventa e Bernës). Dispozitat e Direktivës kërkojnë shtetet anëtare të integrojnë një sërë masash duke përfshirë mbrojtjen e specieve për të ndërmarrë mbikqyrjen e habitave dhe specieve dhe për të prodhuar një raport çdo gjashtë vjet për zbatimin e Direktivës.

Direktiva e Shpendëve EC

Në 1979, Komuniteti Evropian miratoi Direktivën e Këshillit 79/409 / EEC mbi ruajtjen e zogjve të egër, në përgjigje të Konventës së Bernës 1979 mbi ruajtjen e habitateve dhe specieve evropiane. Direktiva siguron një kornizë për ruajtjen dhe menaxhimin e shpendëve të egër në Europë. Ai vendos objektiva të gjera për një gamë të gjerë të aktiviteteve megjithëse mekanizmat e sakta ligjore për arritjen e tyre janë në përgjegjësinë e secilit shtet anëtar.

Shkalla e Ndikimit

Për të vlerësuar madhësinë e ndikimit të skemës, nga Agjencia Ndërkombëtare e rrugëve janë përcaktuar kushtet analitike që shërbejnë si standarde mbi shkallën e ndikimeve, nga “pa ndikim” deri në “ndryshim të madh”. Këto kritere marrin parasysh humbjet e drejtpërdrejta të habitateve dhe karakteristikave ekologjike që ndodhin nga marrja e tokës për rrugë dhe ndikimet e perceptuara të tërthorta si ndotja dhe fragmentimi i habitateve.

Karakteristikat dhe arsyeja e vleresimit

Karakteristika	Karakteristikat e rëndësishme të përfshira në	Speciet e rëndësishme e pranishëm në këtë habitat	Vlera
Pyjet gjethegjerë	Aneksi i Direktives EU për habitatet	Anekset I dhe IV Direktives EU për habitata tet Breshkat, lakuriqi i natës, Qukapiku etj	Shume e lartë
Shkurret	Habitatet e rëndësishme në nivel lokal	Aneksi I i Direktives Europiane për shpendët- zogjte e fushave Anekset II and IV të Direktives EU për habitatet dhe specie e listes se kuqe - Gjarpërinjtë jo helmues	Mesatare
Fushat e gjelbra	Important Habitat ëithin the LSA	Anekset II and IV të Direktives EU për Habitatet Breshka Aneksi I i Direktives Europiane për shpendët- Skifteri, zogjte shtegtarë	E ulët
Rrjedhat ujrore qe sherbejne dhe si korridore	Korridor i rëndësishëm përgjatë gjurmës së rrugës	Anekset II and IV të Direktives EU për Habitatet Turtulli, zhabat apo specie të tjera qe përdorin korridoret natyrale Anekset II and IV të Direktives EU për habitatet- breshka, turtulli	Shume e lartë
Zvarranikët	Pyjet shkurret, pellgjet ujore	Annex IV of E.U. Habitats Directive: Balkan green lizard zhapiqet speciet e listes se kuqe gjarpërinjtë jo- helmues	Mesatare
Gjitarët	Pyje	Aneksi II të Direktives EU për habitatet- kaprolli, lepuri (gjithashtu në aneksin V)	Mesatare

Kriteret për përcaktimin e shkallës së ndikimit

Shkalla e ndikimit	Pershkrimi
E Larte negative	Propozimi mund të ndikojë negativisht në integritetin dhe funksionin, në aspektin e koherencës së strukturës ekologjike dhe funksionimit në gjithë zonën, ose të përbërësve mbështetës të habitatit, ose që bie ndesh me intresat e komunitetit

Mesatare	Integriteti i zonës nuk do të ndikohet negativisht por efekti në funksionet e saj mund të jetë i rëndësishëm në aspektin e objektivave të saj ekologjike. Në se nuk përcaktohet qartë ky ndikim edhe pse mund të kemi të dhëna të plota atëherë ky ndikim do të cilësohet si negativ i madh .
E ulët negative	Kur asnjë nga shkallët e mësipërme nuk aplikohet dhe kur ka ndikime të vogla në ekologji
E përmesueshme	Ndikime shumë të vogla
Pa ndryshim	Ska ndryshim të vlerave ekologjike

Masa zbutese ne projektin :

Karakteristike	Masa zbutese per projektin
Breshka,zvarranike, gjitare të vegjël	Tuba ose tunele që do të instalohen si pjesë e shkollës së re që të jenë të përshtatshme për kalimin breshkave, zvarraniket dhe gjitarëve të vegjël për të ulur numrin e vdekjeve të tyre

Vete zbatimi praktik i masave zbutese i përmbledhur ne tabelën me poshte kerkon veprimet meposhteme:

Tabela 6.2 Masat zbutese gjate ndertimit te objektit

Veprimtaria	Ndikimet e mundshme	Masat zbutese
Punimet ne toke . Hedhja e mbeturinave te lengshme .	Ndotje e mundshme e ujit	Trajtimi i mbeturinave te lengshme ne vend . Nuk do lejohet derdhja e ketyre mbeturinave
Punime te ndryshme ndertimore ne toke Kullim uji	Depertim i sedimenteve , vajit dhe grasos ne rrjedhjet ujore te aferta	Uji i ndotur me vaj duhet te drejtohet ne ujendares(OES) brend aimpiantit.Vecimi i gjithë mbeturinave vajore dhe lubrifikanteve qe dalin nga mirembajtja e pajisjeve te ndertimit dhe largimi i tyre ne menyren e duhur .Ndertimi dhe mirembajtja e pajisjeve per te la rguar ujin e shiut nga strukturat mbajtese dytesore dhe largimin e naftes nga siperfaqja e materialit te akumuluar .
	Clirime te pluhurave nga pajisjet e ndertimiti	Lagia e rrugeve dhe shesheve te levizjes se automjeteve

Pergatitja e shesheve dhe strukturave te tij	Clirimi i tymrave te djegies nga pajisjet	Mirembajtja e rregullt e mjeteve te ndertimit dhe perdorimi me nr te kufizuar te tyre .
Punimet ne toke , shperndarja e pajisjeve dhe materialeve	Trafik i ngarkuar dhe pluhur i shtuar	Mbulim i ngarkeses se mjeteve , lagje e sheve dhe rrugeve te kalimit , perdorim i nr kufizuar mjetesh .
Pergatitja e shesheve dhe aktivitetet te ndryshme ne ndertim	Zhurmat dhe pajisjet	Mirembajtje e rregullt e mjeteve , te synohet te punohet ditën dhe te perdoren pajisje sipas normativave .

- Ceshtjet e mjedisit do te perbejne objektin e nje seksioni me karakter zbatimi per kompanine ndertuese dhe administratorit te objektit gjate shfrytezimit te kesaj godine
- Specifikimet Teknike te Zbatimit do te perfshijne te gjitha referencat enevojshme per Praktikat me te Mira te Manaxhimit te Zones se Ndertimit te permendura ne tabelën 6.2. Specifikimet do te mbulojne parametrat respektivenga kendveshtrimi ambjental si p.sh. kufiri i derdhjes per punimet e germimit , karakteristikat e materia lit çakull, metodat e ndertimit, kerkesat per pajisje etj
- Dokumentat e mesiperme duhet te jene pjese e dokumentave kontraktuale dhe do te ndiqen me korrektesi nga kontraktuesi i zgjedhur
- Mbikqyrja e punimeve do te kryhet nga nje personel me eksperience nemyre qe te monito rohet perputhja me specifikimet e kerkuara

7.3.2–Vleresimi rendesise se efekteve dhe parimet zbutese

Një vlerësim i rëndësisë së efekteve të zbutëse të skemës është kryer për çdo funksion të rëndësishëm ekologjik (mbi të cilat ekziston një potencial i mundshëm për të gjeneruar një ndikim), për të mundësuar një vlerësim që do të ndërmerret, për rëndësinë e efekteve në burime ekologjike në tërësi. Vlerësimi fillestar duke llogaritur dhe masat zbutëse është përmbledhur në Tabelën më poshtë.

Karakteristika ekologjike	Vlera/ndjeshmëria e burimit	Shkalla e ndikimit te skemës në burim	Domethënia e efektit
Pyjet gjethegjere	Shume e larte	E moderuar	E madhe negative
Shkurret	Mesatare	E vogël	E lehte negative
Fushat e gjelbëra	E ulët	E vogël	E lehte negative
Rrjedhat ujoredhe korridoret natyrale	Shume e larte	E moderuar	E madhe negative
Zvarraniket	Mesatare	E madhe	E madhe negative
Gjitarët	Mesatare	E madhe	Negative e moderuar

Speciet-specifike

Masat zbutëse që kërkohen për të përmbushur kërkesat e ligjeve janë të detyrueshme.

Breshka .Duhet të konsiderohet që para fillimit të ndërtimit, breshkat që jetojnë në vendndodhjen e rruges se propozuar duhet të mbliidhen dhe mbahen në një mur gjysmë natyror në afërsi të kantierit përpara se të fillojë puna për hapjen e tij në mënyrë që të parandalohet vdekshmërinë gjatë ndërtimit. Pas ndërtimit të kantierit këto mund të lëshohen përsëri.

Komponenti ekologjik	Vlera/ndjeshmëria e burimit	Shkalla e ndikimit të skemës në burim	Përshkrimi efekteve
Pyll gjethegjërë	Shume e lartë	E ulët	I moderuar (negativ)
Shkurre	Mesatare	E ulët	I lehte(negative)
Livadhe	E ulët	E ulët	I lehte(negative)
Rrjedha ujore apo korridore ujore	Shumë e lartë	E ulët	I moderuar(negativ)
Zvarraniket	Mesatare	Moderate	I moderuar(negativ)
Gjitarët	Mesatare	E ulët	I lehte(negative)

Mbjellja e bimësisë vendase dhe sigurimi i habitateve për specie e rëndësishme duhet të konsiderohet mbjellja e bimësisë përgjatë aksit të rruges siç e specifikuar në kapitullin e peisazhit.

Rekomandime shtesë masat e mëposhtme ekologjike do të mund të zbatohet:

-Mbjellja e vegjetacionit duhet të lejojë krijimin e hapësirave të duhura për të inkurajuar zhvillimin e një florës tokësore dhe të ofrojë habitate të përshtatshme për një numër të llojeve të faunës; prandaj mbjellja nuk duhet të jetë shumë e dendur dhe disa zona brenda një zonë pyjore apo shkurreve duhet të lihet të pambyllja .Ku është e mundur, zonat e mbjelljes duhet të lidhen për të formuar korridoret natyrore që do të drejtojnë kafshët e egra larg nga rruga kryesore .

Vendosja e shtyllave prej druri .Për të siguruar ngjitjen e zvarranikëve dhe brejtësve të vegjël në faqet e pjerrta duhet të vendosen disa shtylla prej druri të cilat mund të prodhohen nga materialet që mbeten si pasojë e shpyllëzimeve të mundshme nga hapaja e gjurmës së rrugës.

Kanalët anësorë të rrjedhjes së ujërave duhet të projektohen në mënyrë që të jenë sa më miqësore me mjedisin për të krijuar mundësinë e shtimit të vegjetacionit dhe faunës ujore si edhe për të mundësuar burimet ujore të përshtatshme për gjitarët e zonës.

Kalimet nënrrugore ose tombinot duhet të të jenë sa më të përshtatshme si edhe të lejojnë kalimet e ujërave në mënyrë që të sigurojnë levizjen e gjitarëve duke u përshtatur si korridore natyrore. Të gjitha mbjelljet e reja duhet të jenë bimë autoktone në mënyrë që të përshtaten sa më mirë me peisazhin.

Krijimi i habitateve shtesë . Kjo nënkupton kompensimin total të sipërfaqes së shpyllëzuar në një habitat të ri por kjo duhet të ndodhë kur të kryhen verifikimet e nevojshme të sipërfaqes dhe bimësisë së dëmtuar dhe gjetja e truallit të përhstashëm për të tërë proces. Ky habitat duhet të jetë i përbërës : tokëbimore, sipërfaqe të pyllëzuar, toke të papunuara. Po kështu mund të ndodhë dhe krijimi i ligatinave nga mbjellja e shkurreve dhe krijimi i habitateve natyrore.

7.3.3–Parimet zbutese ne sistemet ekologjike

Nder parimet kryesore zbutese per sistemet ekologjike mund te permendim :

- Respektimi i të gjitha ligjeve shqiptare dhe të ruajtës së specieve të zonës

- Shqyrtim i kujdesshëm i vendndodhjen së strukturave të reja, për të shmangur efektet direkte dhe indirekte mbi karakteristikat të vlerave ekologjike të zonës.
- Shmangia dhe minimizimin i prerjes së përtej shtrirjes aktuale e rrugës gjatëprocesit të pastrimit të vegjetacionit gjatë punimeve të ndërtimit.
- Shmangia e punimeve për prerjen e bimësisë gjatë sezonit të shtimit, si edhe mizimin e zhurma ve gjatë kësaj periudhe .
- Shmangia e përdorimit të ndricimit të fortë gjatë natës për mosdemtimin e speciave apo gjitarëve të natës.
- Instalimin i strukturave të posacme per levizjen normale të zvarranikëve
- Ndërtimi i kanaleve të thatë nëntokësorë për kalimin e gjitarëve nën rrugë
- Vendosje e kujdesshme dhe sa me pak zhurme e gjeneruar nga pajisjet në kantier
- Shmangien e ndotjes së ujerave sipërfaqësore nga ndotës të rrezikshem (hidro karbure, kripëra, lende kimike)
- Aplikimi i udhëzimeve më të mira të ndërtimit gjatë ndërtimit të rrugës, të tilla si :përdorimi i rrulave për të shtypur pluhurin gjatë muajve të thata të verës, zbatimin e kufijve të shpejtësisë në vendet e ndërtimit, për të zvogëluar ndikimet që vijnë nga depozitimi e pluhurit.
- Ballancimi i sistemeve te kullimit për ndarjen sa me të mirë te sipërfaqes ujore me atë tokësore.
- Sigurimi i zonave të reja për mbjelljen e pemëve dhe shkurreve aty ku rruga e lejon në bashkëpunim me propozime të menaxhimit të peizazhit
- Marrja në konsideratë e identifikimit të mundësive më të gjera të kompensimit të tilla si ofrimi i zonave të reja të habitatit për specie e rëndësishme.
- Monitorimi i zonave ku janë aplikuar masat zbutëse për të vlerësuar suksesin e tyre dhe menaxhimin e drejtë në të ardhmen

7.4–Plani i menaxhimit te trafikut

Një Plan i Menaxhimit të Trafikut (PMT) do të hartohet për të menaxhuar trafikun që gjenerohet gjatë fazës së ndërtimit të projektit, për të minimizuar çrregullimet në trafik dhe vonesat e përdoruesve të rrugës dhe për të ofruar një siguri të vazhdueshme për përdoruesit e rrugës, përfshirë këmbësorët dhe çiklistët. Të gjitha ndikimet në lidhje me trafikun që janë përshkruar më parë mund të zbuten në mënyrë shumë efektive duke zbatuar praktikën më të mira standarte në lidhje me kontrollet mjedisore dhe praktikën e menaxhimit gjatë ndërtimit. Këto masa do të paraqiten të detajuara në PMT, i cili do të përshkruajë në detaje masat që do të zbatojë kontraktori gjatë fazës së ndërtimit të projektit.

Kontraktori duhet të azhurnojë rregullisht Planin e tij për Menaxhimin e Trafikut, ndërkohë që harton metodën e ndërtimit dhe identifikon në detaje kërkesat për lëvizjen e automjeteve.

Një PMT është i rëndësishëm për të garantuar sigurinë e personelit të ndërtimit dhe të punonjësve të kantierit . Synimi është që PMT të jetë një dokument ‘i gjallë’ dhe parimet e tij të menaxhimit të trafikut do të përbëjnë bazën për masat e detajuara që do të merren në vijim ndërmjet kontraktorit dhe autoriteteve që menaxhojnë autostradën për menaxhimin e trafikut të mjeteve të ndërtimit, sipas dhe kur të caktohet kontrata për kantierin e ndërtimit.

PMT do të përfshijë kërkesat minimale të mëposhtme:

- Nivelet e zhvillimit në lidhje me mjetet e ndërtimit që do të përdorin rrjetin rrugor.
- Masat në zonë për të hyrë në korridorin e punimeve dhe brenda korridorit të punimeve.
- Identifikimin e elementëve kryesorë të ndjeshëm përgjatë rrugëve të propozuara që të çojnë në zonë.

- Identifikimin, caktimin e kufijve dhe ndërtimin e të gjitha rrugëve që të çojnë në kantierin e ndërtimit.
- Masat për të minimizuar rrëmujën gjatë ndërtimit të infrastrukturës së re ose të ndryshuar rrugore (p.sh. koha kur do të kryhen, punimet në një korsi, tërësia e tabelave në rrugë, devijimet e rrugës dhe publikimi i njoftimeve paraprake për devijimin e rrugës).
- Masat për të ofruar siguri të vazhdueshme për përdoruesit e rrugës, përfshirë këmbësorët dhe ciklistët.
- Kërkesat e trajnimit për shoferët e automjeteve të projektit në lidhje me sigurinë në rrugë dhe mjedisin.
- Kalendari i aktiviteteve të Projektit.
- Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e PMT.
- Masat për të ndaluar drejtimin e mjeteve “në rrugë të pashtruara”.
- Kufizimet e shpejtësisë dhe metodat e zbatimit të tyre.
- Mjetet për të informuar komunitetin mbi rreziqet e trafikut.
- Pajisjet e automjeteve.
- Mirëmbajtja e automjeteve dhe vendet për furnizimin me karburant.
- Inspektimi, kontrolli dhe raportimi.
- Aftësitë e drejtuesve të automjeteve.

Për të përmbushur kërkesat minimale të PMT kontraktori do:

- ⇒ Të caktojë mjetet e rënda të ndërtimit që të lëvizin në rrugë të përshtatshme për në dhe nga zona ku kryhen punime.
- ⇒ Të kontrollojë dhe mbikqyrë mbërritjen dhe nisjen e mjeteve të ndërtimit nga hyrja e kantierit.
- ⇒ Të identifikojë personat e ngarkuar për kryerjen dhe menaxhimin e procedurave.

8–Plani i Monitorimit te ndikimit ne mjedis

Aktivitetet monitoruese do te kene te bejne vetem me fazen e ndertimit, meqe ne veprim nje nga ndikimet e mundshme ne mjedis nuk do e perkeqesoje situaten e tanishme.

Aktivitetet do te fillojne gjate fazes se mobilizimit, para fillimit te punimeve apo ndonje aktiviteti real punimesh , ne menyre qe te kemi vlere baze per t'i krahasuar me vlerat e marra gjate fazes se ndertimit.

Aktivitetet do te vazhdojne gjithashtu edhe pas perfundimit te punimeve, per te verifikuar qe ndonje ndikim gjate fazes se ndertimit nuk eshte me.

Percaktimi me detaje i aktiviteteve do te behet si prioritar para pergatitjes se zones se projektit, dhe do te paraqitet e diskutohet me autoritetet kompetente per miratim.

Te njejtat autoritete pritet te japin direktiva mbi vlerat fillestare per parametrat e monitoruar, ne menyre qe te percaktoje nevojshmerine e masave lehtesuese te parashikuara ne kapitullin e meparshem.

Në bashkërendim të plotë me Kontraktorin e ndërtimit do të hartohet nje plan i kualifikimit të të gjithë personelit që do të impenjohet në sheshin e projektit gjatë kohës së ndërtimit të Struktures .

Trainimi do të përmbajë njohjen me kushtet ekzistuese të mjedisit, ndikimet potenciale në mjedis nga projekti i ndërtimit, implementimin e masave lehtësuese specifike ne minimizimin ose eliminimin e ndikimeve negative dhe masat e përgjithshme mbrojtese për mjedisin.

Ky plan parashikon masat e përgjithshme mbrojtese për mjedisin, pra për gjithshka që mund të ndodhë rastësisht apo qëllimisht brënda sheshit qe do të perbeje kantierin e ndërtimit te terminalit.

Nje plan monitorimi eshte planifikuar te behet per te monitoruar operacionel e germimit dhe depo zitim te materialeve te ketij germimi nese do te jete e nevojshme ndonje mbushje ashtu edhe jasht ketij territori qe duhet bere vertet ne kushte te rrepta monitorimi.

Të specifikuara kërkesat dhe mënyrat e monitorimit janë dhënë me siper në të cilin për cdo komponent janë dhënë masat lehtësuese si edhe fazat e monitorimit në mënyrë që të jetë sa më të qarta në këtë raport. Përkatesisht mënyrat e monitorimit gjenden në kapitullin e lartpërmendur të listuara si më poshtë vijon:

Komponenti mjedisor	Metoda	Vendndodhja e pikave të matjes/vëzhgimit	Frekuenca e marrjes së mostrave	Përgjegjësia
Ujërat nëntoksor	Marrje mostrash në rrjedhat ujore dhe analizat fiziko-kimike të	Rrjeti piezometrik në vendndodhje të përcaktuara	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Kontraktuesi Klienti DRM
Cilësia e ajrit (pluhuri)	Matja e emetimeve	Rrjeti i monitorimit të pluhurit	Sipas ligjeve shqiptare	Kontraktuesi Klienti
Cilësia e ajrit	Sensorët e gazrave	Rrjeti i monitorimit të emetimeve dhe monitorimi i zonave të ndjeshme rreth kantierit	Rregullisht gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Kontraktuesi Klienti DRM
Zhurma	Monitorimi i zhurmës dhe vibrimeve	Pika të përzgjedhura midis burimit të zhurmës/vibrimit dhe receptorëve	Rregullisht për të parë nesë ka tejkallim të normave Monitorim pas hapjes së rrugës (pas 3,6 dhe 9 muajsh).	Kontraktuesi Klienti DRM
Ekologjia	Survejim	Habitatet e reja të sapokrijuara	2 herë në vit në pranverë dhe në dimër për të parë fazën e shtimit të specive në habitatet e reja dhe bimësinë.	Klienti DRM
Peisazhi	Survejim	Zonat e reja të mbjella	Monitorim sipas rastit për të vëzhguar nëse gjithcka ka shkuar sipas parashikimeve	Kontraktuesi Klienti

Qellimi i ketij plani monitorimi eshte te dokumentoje kushtet mjedisore aktuale si dhe te operacionet e germimit dhe depozitimit te materialeve nga nje kendveshtrim teknik dhe mjedisor. Si minimum ky plan monitorimi, duhet te adresojë vlersimin e kushteve mjedisore aktuale, shperberjen e sedimenteve, analizave mjedisore te mostrave te materialeve te germuara, te kualifikoje stafin e programit te monitorimit dhe pergjegjesite e ketij stafi. Ne identifikimin e masave zbutese, theksi eshte vene ne teknikat e parandalimit te ndotjes, te cilat perfshijne teknologji me te pastra dhe minimizim te mbeturinave qe gjenerohen. Teknologjite e identifikuar jane pjese e nje game te gjere teknologjish te perdorura qe konsiderohen te jene praktikate me te mira aktuale per qellimet e vendosjes te vleres kufi te cilimeve të gazrave apo pluhurave ndotës.

Programi i monitorimit mjedisor eshte fokusuar në elementet e mëposhtem:

- ☞ Respektimin e orientimeve të planit të menaxhimit;
- ☞ Respektimin e specifikimeve teknike;
- ☞ Respektimin e legjislacionit Shqiptar dhe Udhëzuesve të Bankes Botërore për

ruajtjen e mirëqenies dhe shëndetit të punëtorëve dhe banorëve, sigurimin e tyre etj;

- ☞ Ruajtjen e jetes së punetorëve dhe banorëve;
- ☞ Respektimin e normave të shkarkimit ne mjedis.

Masat zbutese gjate ndertimit te objekti

Veprimtaria	Ndikimet e mundshme	Masat zbutese
Punime te ndryshme ndertimore ne toke. Hedhja e mbetjeve te lengshme	Ndotje e mundshme e ujit	Trajtimi i mbeturinave te lengshme ne vend . Nuk do lejohet derdhja e ketyre mbeturinave
Punime te ndryshme ndertimore ne toke . Kullim uji	Depertim i sedimenteve , vajit dhe grasos ne rrjedhjet ujore te aferta	Uji i ndotur me vaj duhet te dre jtohet ne ujendares(OES) brend aimpiantit.Vecimi i gjithe mbeturi nave vajore dhe lubrifika nteve qe dalin nga mirembajtja e pajisjeve te ndertimit dhe largimi i tyre ne menyren e duhur .Ndertimi dhe mirembajtja e pajisjeve per te la rguar ujin e shiut nga strukturat mbajtese dytesore dhe largimin e naftes nga siperfaqja e materialit te akumuluar .
Pergatitja e shesheve dhe strukturave te tij	Clirimi i tymrave te djegies nga pajisjet	Mirembajtja e rregullt e mjeteve te ndertimit dhe perdorimi me nr te kufizuar te tyre .
Levizja e mjeteve per transportimin e materialeve te ndertimit	Trafik i ngarkuar dhe pluhur i shtuar	Mbulim i ngarkeses se mjeteve , lagie e sheve dhe rrugeve te kalimit , perdorim i nr kufizuar mjetesesh sipas nje grafiku te perpiluar me pare
Punimet ne toke , shperndarja e pajisjeve dhe materialeve te ndertimit	Pluhuri , zhurmat dhe trafik i shtuar	Mirembajtje e rregullt e mjeteve , te synohet te punohet ditën dhe te perdoren pajisje sipas normativave .
Perfundimi i punimeve	Pamje estetike	Rregullim , kthim ne gjendje te meparshme dhe gjelberim

☞ Dokumentat e mesiperme do te jene pjese e dokumentave kontraktuale dhe do te ndiqen me korrektesi nga kontraktuesi i zgjedhur

☞ Mbikqyrja e punimeve do te kryhet nga nje personel me eksperience ne menyre qe te monitorohet perputhja me specifikimet e kërkuara.

Faktori mjedisor	Treguesi i monitorimit	Metoda e matjes	Vendodhja e pikave të matjes	Frekuenca e matjes	Autoriteti pergjegjës
Cilësia e ujerave	●COD, BOD, (O₂ mg/l), te tjera (sipas ligjeve shqiptare dhe normave europiane ne fuqi), ●sasia e ujit per tu perdorur gjate ndertimit dhe funksionimit (m3).	Marrje manuale e mostrave analizat fiziko- kimike te ujit	Rrjeti piezometrik I ngritur per këtë qëllim	●sipas ligjeve ne fuqi, sa here qe ka dyshime per ndotje, ose askidente teknologjike	Kontraktori, Klienti, DRM
Cilësia e ajrit	●Clirim gazrash (NO, CO, SO_x); (sipas ligjeve shqiptare dhe normave europiane ne fuqi) ●Clirim pluhuri (PM₁₀); (sipas ligjeve shqiptare dhe normave europiane ne fuqi)	Matja e emetimeve, sensorët e gazrave	Sistemi i monitorimit te pluhurave, monitorimi i emetimeve ne zonat e ndjeshme	regullisht gjatë ndertimit dhe funksionimit sipas ligjeve shqiptare dhe direktivave te BE	Kontraktori, Klienti, DRM
Zhurmat dhe vibrimet	Niveli i zhurmave dB(A), ne varesi te largesis nga sheshi i objektit dhe sektoreve te vecante brenda tij; (sipas ligjeve shqiptare dhe normave europiane ne fuqi).	Monitorim i zhurmave dhe vibrimeve	Ne pika kyçe midis burimit te zhurmes dhe receptorwve	monotorim here pas here si edhe gjate punes me kapacitet te plote te pajisjeve te zhurmshme.	Kontraktori, Klienti, DRM
Biodiversiteti	Hektare dhe tipi i vegjetacionit; hektare dhe tipi i siperfaqeve te rrezikuara; numri, tipi dhe dendesia ; numri i kafsheve; dendesia e trafikut; numri i aksidenteve dhe raporti midis tyre e numrit te kafsheve e dendesise se trafikut.	Monitorim here pas here	Prane kantierit të ndërtimit	monitorim here pas here sipas ligjeve	Kontraktori, Klienti, DRM
Toka bujqësore	●Hektare te zena nga ndertimet; tone/hektare e mbuleses se tokes se zhvendosur per hapjen e sheshit te ndertimit. ●Planifikimi urban i zones ●Leja e nderθmit ●Rruget e kalimit per ne objekt ●Planet e perdorimit te tokes gjate ndertmit dhe punes se objekt ●Plani i rehabilitmit te mjedisit pas fazes se ndertmit	Monitorim here pas here	Prane kantierit të ndërtimit	monitorim here pas here sipas ligjeve per te pare perdorimin e tokes sipas projektit	Kontraktori, Klienti, DRM
Siguria në pune	●Masa per sigurine ne pune; ●Vendosje tabelash, muresh e gardhesh mbrojtjes, etj. ●Trainimi i punonjesve.	Monitorimi perditshem	Prane kantierit të ndërtimit	Sipas ligjeve dhe rregulloreve te sigurimit teknik	Kontraktori,
Trashëgimia kulturore	Gjendja fizike e tyre	Vezhgime here pas here	Prane kantierit të ndërtimit	Gjatw ndertimit dhe shfrytezimit	Bashki , DRM
bASHKI	Gjendja fizike e peisazhit	Vezhgime here pas here	Prane kantierit të ndërtimit	Gjatw ndertimit dhe shfrytezimit	Bashki, DRM

8.1 –Permbajtja e Planeve te Monitorimit te ndikimit ne mjedis

Per te realizuar nje veprimtari ndertuese dhe shfrytezuese plotesisht te kontrolluar, per te parandaluar ndikimet e mundshme negative ne mjedis si dhe per te marre masat e nevojshme te menjanimit te pasojave te ketyre ndikimeve del e nevojshme dhe e domosdoshme monitorimi i :

- ✓ procesit te shembjeve dhe germimit per themelet e kesaj godine
- ✓ ndotjes së terrenit në sipërfaqen ndarëse të veprimtarisë së struktures me subjektet e tjera privatë juridikë apo edhe te vete portit,
- ✓ ujërave që do të rrjedhin në sheshet e ndertimit.
- ✓ zhurmave te mjeteve te germimit, sheshimit, ngarkimit dhe transportit qe do te punojne ne kantier.

Marrjen e masave të përgjithshme mbrojtese për mjedisin

Komponenti	Problematika në mirëmbajtje	Avantazhet	Disavantazhet	Kosto kapitale	Kosto e mirëmbajtjes	Mjedis
1 Drenazhim me tuba Pa trajtim fundor	•Nuk kerkohet mirëmbajtje periodike •Sistemi duhet të monitorohet periodikisht një here në vit.	•Kërkohet shumë pak mirëmbajtje •Kërkohet pak toke për ndërtimin e tyre •Parandalon depërtimin në mjedisin e ujërave nëntokësore.	•Nuk bëhet trajtimi i ujërave përpara duke rritur mundësin e ndotjes në mjedis No eater quality treatment before •Nuk bëhet ngadalsim apo pakësim i rrjedhes së ujit; e gjithë sasia shkon në destinacion përfundimtar. •Kosto e lartë e ndërtimit			
2 Drenazhim me tuba Me trajtim	•Kerkohet një mirembatje e moderuar për të funksionuar ne rregull •Kërkohet largim periodic i sedimenteve në bazë	•Ul përqindjen dhe volumin e rrjedhës në mjedisin e jashtëm pritës •Ul përqindjen e ndotësve në mjedisin e jashtëm pritës •Parandalon ndotjen e ujërave nëntokësore	•Kërkohet një mirëmbajtje mesatare •Ul ndotjen vetem kur bëhet trajtimi për cilësinë e ujit •Kosto e lartë ndërtimi			
3 Drenazhim me tuba Trajtim fundor (ligatina)	•Kërkohet mirëmbajtje peridike për të mbajtur funksionim normal •Largimi periodic i sedimenteve dhe pastrim i shpeshtë	•Ul përqindjen dhe volumin e rrjedhjes së ujit mjedis (pak a shume si ato para zhvillimit të zonës) •Ul sasinë e ndotësve në mjedis	•Kërkohet mirëmbajtje periodike •Kosto e lartë ndërtimi			

Ky monitorimi i veprimtarisë së ndertimit dhe shfrytëzimit të Struktures se mbyllur te kontrollit te automjeteve duhet të paraprihet me :

- ❖ Kualifikimin e të gjithë personelit që do të impenjohet në sheshin e projektit gjatë gjatë ndertimit dhe shfrytëzimit të tij
 - ❖ Trainimin e vazhdueshëm të këtij përsonei për përditësimin e tij me informa cionet më të reja të dobishme de të domosdoshme për mbarëvajtjen e shfrytëzimit të ketij aksi rrugor
- Identifikimi i masave zbutese konsiston në:

- ⇒ teknikat e parandalimit te ndotjes nëpërmjet marrjes së masave praktike konkrete të sigurisë te cilat perfshijne teknologji me minimizim te mbeturinave.
- ⇒ Zbatimi i Teknologjive te pastra që jane pjese e nje game te gjere teknologjish te perdorura dhe qe konsiderohen te jene praktikate me te mira aktuale per qellimet e vendosjes te vleres kufi te clirimeve të gazrave apo pluhurave ndotës dhe qe ne zhargonin teknik quhen “teknologji mike te mjedisit”.

Monitorimi, duhet kryer jo vetem me marrjen e mostrave ne territorin ku do te hidhen, por te planilikohen edhe marrje mostrash mjedisore dhe survejime nga ekspertet edhe ne territorin perreth,

sidomos ne drejtnin e levizjes se rryrave te ajrit per te kapur kufijte e spostimeve te mundshme te pluhurave . Monitorimi duhet te zgjase te pakten edhe nje bere me sume nga periudha e depozitimit te mbetjeve per te krijuar nje ide te qarte te efekteve te ketij depozitimi, ndoshta edhe per pasoje te zbatimit io te perpike te kushteve teknike per izolimin e materialit, ne nje periudhe kohore qe justifikon levizjet e sedimenteve te hedhura edhe gjate eventeve natyrore (meteorologjike etj.) qe mund te ndodhin ne dy stinet e ardhshme mbas fillimit te punimeve.

Ne procesin e monitorimit, eshte mire qe te perfshihen eksperte mjedisore individuale te vendit (te pavarur), si dhe institucionet kerkimore shkencore qe angazhohen ne kete drejtim pa lene jasht loje labororet e licencuar apo aq edhe te akredituar nga institucionet kombetare dhe nderkombetare.

Sedimentologe me eksperience duhet te jene nder ekspertet e pare qe do te vezhgojne ndryshi me ne relief dhe drejtimet e shperndarjes se sedimenteve pas depozitimit, per te percaktuar modalitetet e marrjes se mostrave si vendet, shpeshesine e marrjes si dhe kohen perkates te marrjes se mostrave . Perdorimi i GPS me saktesi te larte per percaktimin e koordinatave te ketyre pikave, do te ndihmonte pa dyshim jo vetem ne permiresimin e punes se marrjes se mostrave por ceshte me e rendesishme edhe ecurine e ndryshimeve ne kohe te ketyre depozitimeve, perfshire ketu edhe vezhgimet biofizike.

Nga ana tjeter, ndotjet inorganike dhe ato organike ne sedimentet siperfaqesore, do te jene nje nder objektivat e monitorimit jo vetem gjate funksionimit te kantierit por edhe me pas, kur te filloje shfrytezimin i zakonshem jketij aksi rrugor .

Monitorimi i hedhjes se materialit te germuar ne zonen ne objekt ne segmentet e caktuara (nese do te zgjidhet kjo alternative), per vete procesin e izolimit te tij, duhet te kryhet nga eksperte ne inxhinierine e ndertimit, ne gjeologjine inxhimierike dhe ate te mjedisit, gjate gjith procedureve te punes.

Para izolimit te materialit te ndotur eshte mire te perseriten edhe nje here analizat mjedisore per ndotesit organike dhe inorganike ne zonen e depozitimit, per te verifikuar gjendjen e ndotjes ne krahasim me periudhen kur u kryen analizat per statusin mjedisor . Gjithashtu sic u permend me lart, monitorimin e nevojshem biologjik duhet shoqeruar edhe me filmimet perkatese per ta bere procesin jo vetem me te kontrollueshem por ne menyre qe te nxirren perfundime sa me te drejta dhe te frytshme ne veprimtari te tjera te ketij lloji ne te ardhmen qe do te kene vend pa dyshim ne territorin e njesise vendore te mesiperme

Gjithashtu rekomandohet te monitorohet ndotja e ujrave siperfaqesore te drenimit apo edhe te reshjeve para se te derdhen ne kolektoret kryesore apo kanalizime te tjera nga lendet organike (nafta dhe nenproduktet e saj), gjate gjith procesit te germimit dhe tran sportimit te sedimentit te germuar. Kjo thjesht per arsye te rrjedhjeve te mundshme aksidentale nga mjetet e germimit dhe mjetet e tjera qe do te punojne ne port. Ndjekja direkte e punimeve dhe kushteve teknike qe ofrojne mjetet nga pikeparnja mjedisore, prej inspektorit te mjedisit te APD, do te ishte nje monitorim parandalues deri ne nje fare mase qe do te ndihmonte shume ne minimizimin dhe ndoshta edhe ne menjanimin e ndotjeve te mundshme.

Eshte pikerisht Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit qe ne bashkepunim me ekspertizat autoritare te vendit, do te aprovoje apo percaktoje frekuencat, llojin, menyren dhe teknologjine e procedureve te monitorimit, tipet e vzhgimeve dhe analizave, etj

Raste aksidentale :

Investitori detyrohet te ngrejë sistemin e parandalimit dhe te kontrollit te aksidenteve, për te shmangur pasojat për jetën, shëndetin e njeriut dhe për mjedisin . Per realizimin e ketij detyrimi investitori do te marre masa efektive si :

⇒ Sigurimin e vendit te punes sipas rregullave teknike ne fuqi .

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis per Objektin :
“Rikonstrukcion dhe ndertim palestre, ne shkollen 9-vjeçare Thumane Kruje “

Ndikimi në mjedis	Faza e ndikimit	Venndodhja e ndikimit	Masat zbutëse	Përgjegjësia
Zbulim i tokës së ndotur gjatë fazës së ndërtimit	Gjatë ndërtimit	Në kantier(zonën e ndërtimit)	• Vezhgimi i tokës për ndonjë ndotje të mundshme gjatë fazës së ndërtimit conform ligjeve	
			• Nëse evidentohet ndotje, duhen marre mostrat e ne terren dhe të bëhen analizat e nevojshme	
			• Të bëhet një vlerësim i duhur i rrezikut për të parë nëse ka rrezik për punonjësit	
			• Punonjësit të vishen me rroba të përshtatshme për të parandaluar ndotjet e rrezikshme	Kontraktori
Heqja e dherave	Gjatë ndërtimit	Në kantier	• Përdorimi i gurove pranë kantierit përpara hapjes te guroveve të reja apo marrjes me qera të tyre	
			• Heqje me kujdes e shtresës së tokës për të mundësuar pasterinë maksimale të saj me qëllim përdorimin e mëvonshëm për rehabilitimin e peisazht	
			• Projektimi i rrugës për të sigura që rezervat në material të jene në kohë sa më të gjatë	ProjektuesiKontraktori
Ndotja e truallit	Gjatë ndërtimit	Në kantier	• Asnjë nga materialet të parashikuar për restaurim nuk duhet të përdorën pa qene të certifikuara na ana e cilësië.	
			• Përzgjedhja e standarteve më të mira të projektimit të sistemit të drenazhimit me qëllim zbutjen e erozionit të tokës dhe largimin e ujerave të tepërt.;	Projektuesi
			• Masat parandaluese teknike për parandalimin e mbejeve dhe trajtimit përrundimtar të tyre	Kontraktori
Ndikimi në ujërat nëntokësorë	Gjatë ndërtimit	Në kantier	• Përdorimi i gurove aktuale në mënyrë sa më eficiente të jetë e mundur me qëllim moshapjen e të rejave të cilat mund të ndikojnë në ujërat nëntokësorë.	ProjektuesiKontraktori
			• Të kufizohet koha e punimeve në rastin kur ujërat nëntokësore apo burimet që mund të hasen gjatë ndërtimit të rrugës shërbejnë si furnizues të burimeve të ujit të pijshëm	
			• Marrja e lejeve të duhura për punimet ku uji është i pranishëm	
Ndikimi në ujërat nëntokësorë	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Në kantier	• Projektim shumë i mirë i sistemit të drenazhimit me qëllim moslejimin e ndotesve në ujërat nëntokësore në raste aksidentesh.	Projektuesi Kontraktori Klienti
			• Mirëmbajtja dhe kontrolli periodik i automjeteve që do të punojnë në kantier	
			• Ruajtja dhe magazinimi shume i mirë i lendeve djegëse dhe atyre kimike duke ruajtur dhe rezerven prej 110	
			% kapacitetit magazinues.	
			• Rrjedhjet që mund te ndodhin ne kantier duhet të pastrohen përpara se të depërtojnë në tokë	
			• Tepçicat e ujit nga larja e makinerive do të depozitohen brenda një zonë nga e cila duhet të hiqen mbetjet apo balta para shkarkimit të ujit.	
			• Limitim i ndikimit në mbulesën e tokës gjatë punimeve	
			• Ujërat e zeza që rrjedhin nga çdo ËC portative të hidhen në konteinerë të vulosura, të cilat duhet të zbrazen periodikisht në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza.	
			• Parashikimi i mirëmbajtjeve së rrugëve për të eliminura ndotjet nga vajrat apo rënia e baltës gjatë shfrytëzimit të rrugës	
			• Përdorimi sipas normave i herbicideve për të ndaluar rritjen e bimesisë në trupin e rrugës në minimum	
Emetimet nga makineritë dhe pajisjet	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Në zonën e kantierit të ndërtimit, zonat përreth tij, si edhe ne rruget ku	• Kujdes në mbulimin e automjeteve gjatë transportit të dherave	Kontraktori
			• Kontrolli teknik dhe mirëmbajtja e automjeteve dhe pajisjeve	

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis per Objektin :
“Rikonstrukcion dhe ndertim palestre, ne shkollen 9-vjeçare Thumane Kruje “

		automjetet e ndërtimit do të qarkullojnë	• Përdorimi dhe makinerive dhe i pajisjeve sa më të mira të mundshme nga ana e parametrave mjedisore • Marrja në considerate e karburanteve bio • Monitorim periodic i proceseve të punës së këtyre pajisjeve	
Pluhuri nga ngarkimet dhe shkarkimet e ndryshme	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	• Minimizimi i shkarkimit nga lartësiti e materialeve të ndërtimit dhe dherave	Kontraktori
Pluhuri nga transporti i materialeve	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Në zonën e kantierit të ndërtimit, zonat përreth tij, si edhe ne rruget ku automjetet e ndërtimit do të qarkullojnë	• Kontrolli i shpejtësive; mokalimi i shpejtësive limit • Mosngarkimi siper normave i automjeteve të transportit të materialeve të ndërtimit dhe dherave dhe mbulimi i tyre kur është i detyruar • Kontrolli i lagës së rrugës si masë për eleminimin e pluhurit • Kur uji është pa efekt ne largimin e pluhurit, mund të përdoren co-polimere qe e bejne pluhurin jo aktiv. • Instalimi i nje pasjise për larjen e gomave kur dilet nga kantieri. • Projektim i mire i akseve ndihmëse të transportit për të shkaktuar sa më pak ndotje gjate ndërtimit të rrugës.	Kontraktori
Pluhuri i shkaktuar nga era mbi sipërfaqet e prekura nga erozioni	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	• Kontrolli i lagështirës dhe presionit të saj • Mbulimi i materialve stok; • Ri-vegjetimi i zonave të zhveshura aty ku është e mundur	Kontraktori
Zhurma që do të ndihet gjatë punimeve të ndërtimit si pasojë e makinerive, oproceseve të punës etj.	Gjatë ndërtimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	• Shmangni punen e panevijshme të makinerive dhe fikini kur nuk kerkoni qe ata të kryejnë një punë të caktuar • Ndizni pajisjet gradualisht dhe jo njeherësh • Mirëmbajtje dhe inspektim i mjeteve dhe makinerive ne kantier • Puna vetëm në orare të caktuara të pajisjeve qe gjenerojne zhurma që mund të ndikojne të receptorët • Në rast të zhurmave të mëdha të përdoret sistemi paralajmërues • Përdorimi i pajisjeve silencuese aty ku do të kërkohet sipas niveit të gjobnruar të zhurmës • Pajisjet e zhurmshme si pompa, gjenertorë të vendosen sa më larg të jetë e mundur nga receptorët; • Izolimi i zhurmave kur këto do të gjenerohen pranë zonave të banuara, shkollave, kopshteve spitaleve; • vendosja e pajisjeve izoluese për të të qëllim. • Përdorimi i shtresave të gomës për izolimin e zhurmave	Kontraktori
Zhurma gjatë funksionimit të rrugës	Projektimit dhe shfrytëzimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	• Minimizimi i rënies nga lartësiti e materialeve • Sa të jete e mundur afrohini me njëra tjetren pajisjet zhurme gjeneruese; • Përdorimi i shtresave mbrojtëse për rrethimin e pajisjeve që gjenerojnë zhurma. • Projektim i mire i rrugës • Parashikimi i masave shtese izoluse për zhurmat nesë kjo do të shihet e arsyeshme • Prerjet dhe përforcimet e ndryshme • Mbulim i plotë ose i pjesshëm i amnienteve të ndryshme • Instalimi i dritareve më izolues ndaj zhurmave nesë do të kërkohet; • Përmirësimi dhe izolimi ndaj zhurmave i cative nëse do të kërkohet	ProjektuesiKlienti

Vleresimi i Ndikimit në Mjedis për Objektin :
“Rikonstruktion dhe ndertim palestre, ne shkollen 9-vjeçare Thumane Kruje “

Shqetësimet në ekologji	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Në kantier	• Zbatimi i të gjitha ligjeve lidhur me biodiversitetin dhe specie e mbrojtura • Marrja parasysh e efekteve direkte dhe indirekte që mund të ketë ndricimi, sinjalistika në ekologjinë e zonës • Shmangia apo minimizmi sa më shumë të jetë e mundur i prerjes së pemëve • Kujdes gjatë punimeve në sezonin e shtimit të shpendëve • Sipas rregullave kufizimi i ndricimit në zonat e ndjeshme • Vendosje dhe pozicionim i mirë i makinerive në kantier • Shmangie e dëmtimeve në rrjedhat ujore • Aplikimi i metodave më të mira në ndërtim për të minimizuar sasinë e pluhurit të depozituar • Pëllgje të vecante për balancimin e ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësore • Parashikimi i hapësirave të reja të mbjella me peme dhe shukurre të zonës apo sipërfaqeve të gjelbra aty ku është e mundur; • Të merren parasysh habitatet kompensuese për specie që mund të fillojnë të jetojnë aty pas punimeve • Kujdes ndaj receporëve të ndjeshëm • Angazhuimi i strukturave që merren me monitorime të ekologjisë në zone; • Monitorimet e nevojshme sipas ligjit	Projektuesi Kontraktori Klienti
Shqetësimi i breshkave nga humbja e habitatit	Gjatë ndërtimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	• Sic kërkohet, grumbullimi i breshkave para punës, strehimi i tyre për të humbur vdekshmërinë e tyre • Sic kërkohet vendosja e pengesave për të ndaluar hyrjen e tyre në rrugë • Sic kërkohet hapja e tuneleve nëntokësorë ose tobinove të cilat do të shërbejnë si korridore natyrore për kalimin e sigurt të breshkave apo gjitarëve të tjerë. • punimet do të monitorohen sipas ligjeve shqiptare	Projektuesi Kontraktori Klienti
Humbja e habitateve	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	• mbjelljen e vegjetacionit për të krijuar kushte të mira dhe për të inkurajuar krijimin e habitateve të reja në zonë • ku është e mundur forcimi i korridoreve natyrore në të dyja anët e rrugës • shtyllat e habitateve të ndërtohen me material e riciklueshme të mbetura nga pemët që do të priten sepse në këtë mënyrë parandalohet përdorimi i materialeve të reja por janë edhe më komode për zvarranikët • karakteristikat e ujit që do të kalojnë nëpër drenazhe të jetë në mkushte të mira mjedisore që të shërbejë si habitat dhe për specie e ndryshme ujore duke krijuar dhe kushtet për shumimin e tyre • ndërtimi i tobinove të reja për të shërbyer si korridore natyrore hyrese-dalëse për specie e ndryshme; • përmët e mbjella duhet të jenë të zonës lokale	Projektuesi Kontraktori Klienti
Humbja e habitateve	Gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit	Ndikim në kantier, si edhe në zonën përreth tij	• kompensimi i habitateve duke krijuar habitate të reja kryesisht në zonat e ndotura • specifikisht në habitatet pyjore mbjellje e pemeve tradicionale të zonës • Habitatet e thata të shndërrohen në lidhave të gjelberuara • Në habitate e demtura me shkurre të mbillen të mbillen shkurre me karakteristika të njëjta; • Në habitatet e tokës se punueshme ose të një toke të ndotur(në varësi të largësisë me rrugen) të mbillet bimësia e zonës	Projektuesi Kontraktori Klienti

⇒ Zbatimin e kohes normale orare te punes dhe pushimin ne menyre qe punonjesi te mos humbase vemendjen .

⇒ Punimin ne ambiente te zhurmes me kohe te kufizuar me qellim mosdemtimin e punonjesve qe punojne nen keto efekte.

⇒ Pajisjet nen tension do te jene te izoluar , punonjesit qe do te punojne ne keto pajisje si dhe ne pajisjet nen presion duhet te jete te instruktuar me pare dhe te veshur me rroba te caktuara te posacme .

⇒ Per garantimin e mbrojtjes se jetes dhe aktivitetit nga zjarri gjate procesit te zhvillimit te aktivitetit eshte projektuar te vendosen fikset e zjarrit ne cdo ambient dhe do ndertohet sistemi i pavarur i mbrojtjes nga zjarri ne rast nevojë ne perputhje me Kushtet e Mbrojtjes nga Zjarri te miratuara me pare si dhe eshte bere instruktimi i duhur i punonjesve qe do te punojne ne aparaturat elektrike dhe pajisjet e tjera nga personi pergjegjes .

Megjithetë , egziston mundësia per rast aksidenti , sepse :

▲ nga humbja e vemendjes se punonjesit mund te ndodhe zjarr .

▲ nga pakujdesia ne perdorimin e makinerive te punes gjate ndertimit mund te kasidentohen punonjesit nga gjymtyret .

▲ gjate punimit me makinerine ngritese te automjeteve neuren metalike elektrike duhet vemendje e larte dhe kujdes i madh pasi punonjesit mund te aksidentohen si pasoje e humbjes se vemendjes gjate kohes se punes .

▲ gjate transportit te mbeturinave si atyre te ngurta edhe te atyre te lengeta duhet siguruar ngarkesa me kujdes ne menyre qe te mos kete rrjedhje ose renie te ngarkeses nga makina e transportit per shkak te gabariteve te vogla te detaleve .

Duhet te eliminohen rreziqet e mundshme te shkaktuara nga agjentet kimik vajra , karburante etj. ose te zvoglohen ne minimum nepermjet masave te meposhtme:

- a) projektimi dhe organizmi i sistemeve te punimeve ne vendin e punes;
- b) furnizimi me mjetet e pershtatshme per punet specifike dhe procedurat perkatese te mirembajtjes;
- c) zvoglimi ne minimum i numrit te punetoreve qe jane ose mund te jene te ekspozuar;
- d) zvoglimi ne minimum i kohezgjatjes dhe i intensitetit te ekspozimit;
- e) masat higjenike te duhura;

Masat e marra dhe qe do zbatohen nga investitori jane te mjaftueshme per te zvogluar rrezikun e mundshem .

Punedhenesi , per te mbrojtur shendetin dhe sigurine e punetoreve nga pasojat e aksidenteve ose te emergjencave te shkaktuara nga zhvillimi i ketij aktiviteti ne vendin e punes , vendos procedura te pershtatshme nderhyrje per tu zbatuar ne keto raste. Keto masa perfshijne ushtrime praktike per sigurine qe duhet te kryhen me intervale te rregullta dhe venien ne dispozicion te mjeteve te pershtatshme per ndihmen e shpejte.

Ne rast zjarri ose emergjence, punedhenesi merr menjehere masa te drejtperdrejta per te zvogluar efektet dhe ne menyre te vecante asistencen per largimin, evakuimin dhe informimin e punetoreve. Punedhenesi merr masa te pershtatshme per te normalizuar situaten sa me pare.

Punetoreve qe u lejohet te punojne ne zonen e prekur ose punetoret e domosdoshem per kryerjen e riparimeve dhe aktiviteteve te nevojshme u jepen veshje mbrojtese, mjete te mbrojtjes individuale dhe mjete te pershtatshme per nderhyrjen qe perdoren deri sa vazhdon situata anormale.

Punedhenesi pershtat masat e nevojshme për të përgatitur sistemin e alarmit dhe sisteme të tjera komunikimi të nevojshme për të senjalizuar menjëherë aksidentin ose emergjencën.

Masat e emergjencës, të përfshira në plan duhet të përmbajne:

- a) informacione paraprake mbi aktivitetet e rrezikshme , mbi agjentët kimik të rrezikshëm , mbi masat e identifikimit të rrezikut të mundshme , mbi masat parandaluese dhe procedurat në mënyrë të tillë që zyrtarët kompetentë për situatat e emergjencës të mund të përcaktojnë menjëherë , procedurat perkatese dhe masat parandaluese ;
- b) çdo lloj tjetër informacioni mbi rreziqet e mundshme të shkaktuara ose që mund të shkaktohen nga aksidente ose situata emergjente, përfshirë informacionet mbi procedurat e ndjekura në baza të ketij neni.

Në rast zjarri ose emergjence, subjektet e pambrojtura duhet të largohen nga zona menjëherë.

Në përcaktimin e personave , punedhenesi mban parasysh dimensionet e ndër marrjes si dhe rreziqet specifike të ndërmarrjes ose njesive të prodhimit.

Punetoret nuk mund të refuzojnë këtë emergjencë , me përjashtim të rasteve kur kanë motivacionet e duhura. Ata duhet të informohen , të jenë në numër të mjaftueshëm e të kenë në dispozicion mjetet e duhura , duke patur parasysh dimensionet e ndërmarrjes dhe rreziqet specifike të ndërmarrjes dhe njesive të prodhimit.

9 –Benifitet e projekti

9.1 –Përmirësim në infrastrukturë

Fuqitë •Bukuri natyrore unike në Shqipëri •Klimë e mirë •Prodhime bio të standarteve të larta të zonës •Vende të trashëgimisë kulturore dhe të besimit •Komunitet mikpritës dhe me tradita të pasura kulturore •Fermerë të aftë	Dobësitë •Marketim i ulet i zonës dhe vlerave të saj •Marketim i ulet i produkteve të zonës •Mungesë programesh zhvillimit rural •Mungesë e krahut të kualifikuar të punës •Migrim i pandalshëm i banorëve të zonës
Mundësitë •Akses më të madh në shkollë •Shumfishim i faciliteteve dhe shërbimeve •Hapje vendesh pune gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit •Rritje e vlerës së truallit •Promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe bukuri të natyrës •Përfitime nga turizmi •Hapje biznesesh në funksion të fuqizimit të zonës •Zhvillimi i ekoturizmit	Kërcënimet • Ndotja e lumenjve dhe mospastrimi ndër vite i tyre

Keto shkollë do të ndikojë në ofrimin më të mirë të shërbimeve të nxenesve dhe mesuesve

9.2 –Zhvillim ekonomik , punesim dhe rritje e cilesise se jetes

Nepermjet permiresimit te sherbimit ne sistwemin arsimor , sistemimit te shtresave asfaltike ne htyrje te shkolles , ndricimit dhe shtimit te siperfaqes se gjelberuar do kemi rritje te madhe edhe te promovimit te ketyre shkollave .

Natyrisht qe ky shtim edhe nga prurje te vendit tone do ndikoje ne menyre te drejtperdrejte ne rritjen e nivelilt te jeteses si pasoje e shtimit te qarkullimit te te ardhurave .

Projekti për përmirësimin e standartit të jeteses ne shkollla të qytetit të Fushe - Krujës është i një rëndësie të madhe për të njëjtën gjë përbën nje risi dhe favor te madh për qytetarët dhe është gjithashtu një punë e nevojshme duke pasur parasysh kushtet e tanishme te degradimit, sigurise se dobët dhe vështirësitë në përdorimin e infrastrukturës ekzistuese.

Pjesa e projektit nga rimodumi i shkolles egzistuese do te coje ne zgjerim te saj.

9.3–Analiza SWOT

Perfitimet ekonomike nga turizmi

Zhvillimi social-ekonomik

Fuqitë	Dobësitë
•Popullsi e re në moshë •Tradita të mira familjare •Të ardhura nga emigracioni •Kapacitet për tu përshtatur me të renë dhe për të mbijetuar	•Migrimi i trurit drejt qendrave të mëdha •Sistem i dobët i arsimit profesional •Të ardhura të pakta në NJQV •Pak OJF të shërbimeve komunitare dhe sociale
Mundësitë	Kërcënimet
•Akses më të madh në shërbime •Mundësi për ngritje qendrash për trinime në fushën e shërbimit dhe shkollimit •Nxitje për mësimin e gjuhëve të huaja •Përmirësim i arsimit profesional •Përsimrësim i kujdesit shëndetsor •Rikthim i popullsisë së migruar	•Financim i pamjaftueshëm për arsimin •Shërbimi shëndetsor aktual jo në nivelin e kënaqshëm •Politika jo të qarta të zhvillimit rajonal

9.5–Turizem

Kruja është shndërruar në një nga destinacionet turistike më tërheqëse në Shqipëri. Ajo është njohur për historinë e saj të hershme .

Kruja është një prej qyteteve më historike të Shqipërisë. Ajo ndodhet në një distancë të afërt nga kryeqyteti, vetëm 32 km larg. Emri dhe rëndësia e Krujës lidhet me veprën dhe aktivitetin 25 vjeçar të heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti (Skënderbeu) i cili gjatë periudhës së mesjetës në shek e XVI e shndërroi Krujën dhe kështjellën e saj në një pikë të papërkulur rezistencë ndaj rrezikut Osman dhe duke e bërë atë të njohur dhe të famshme në të gjitha kancelaritë diplomatike të Europës.

Është objekti kryesor turistik i qytetit të Krujës. Kështjella është ngritur gjatë shekujve të V-VI. Ajo ka trajtë eliptike me një perimetër prej 804 metrash. Muret rrethuese janë të përforcuara nga 9 kulla. Në pjesën më të lartë në veri–lindje ngrihet kulla e Sahatit, e cila shërbente për vrojtim dhe sinjalizim me kalanë e Petrelës dhe Durrësin. Muzeu ndodhet në hyrjen kryesore të kështjellës. Muzeu është përruruar në vitin 1982. Krahës stendave që shpjegojnë veprimtarinë e Skënderbeut në museum ndodhen edhe biblioteka, dokumente dhe botime që lidhen me figurën e Skënderbeut. Muzeu ka karakterin e një memoriali dhe ka elemente të tilla si harqe guri, piktura në xham etj. Brenda mureve të

kalasë gjenden disa shtëpi dhe Teqeja e Dollmasë. Në përfundim të kështjellës ruhet edhe hamami i shek XV.

Një ndër atraksionet e qytetit të Krujës është pa dyshim Pazari karakteristik i Krujës Derexhiku i cili fillimet i ka në shekullin XVII, u dëmtua shumë në vitin 1944 nga një zjarr i madh dhe u restaurua në vitin 1967, vit në të cilin u shpall “Monument kulture”. Në fillimet e veta numëronte rreth 200 dyqane, ndërsa sot janë rreth 70- 80. Është i njohur sidomos për prodhimin e zejeve, ku qilimat zënë vendin kryesor të prodhimit dhe janë ndër suvenirët më të preferuar të turistëve (vendi më i këshillueshëm për turistët për blerjen e suvenirëve në Shqipëri nga shumicave e guidave si Western Balkan, publikuar nga Lonely Planet apo guida frëngjisht “Albanie nga Petit Fute”).

Shume i rendesishem eshte edhe vizita nga turistet ne Malin e Krujes , Sarisalltik i cili ndodhet ne lindje te qytetit te Krujes, ne pjesen me te sipërme te shpatit perendimor te malit te Krujes. Disa dhjetra metra poshte pjeses se sheshte te malit gjendet shpella e Sarisalltikut. Eshte formuar nga karsti ne shkembijnjte gelqerore. Qysh shume heret eshte perdorur si objekt kulti per besimtarete bektashiane. Tek shpella ata kryejne ritin fetar, ndersa uji i burimit u shuan etjen e vapes se veres. Kjo shpelle nuk ka stalaktite e stalagmite, pasi duhet te jene demtuar heret nga besimtarete, sigurisht jo me qellim. Ajo vizitohet shume nga banoret e Krujes e zonave perreth, pavaresisht nese jane bektashinje, krishtere etj.

Si përfundim :

-Duke pare , studiuar dhe verifikuar ne vend sheshin e ndertimit , projektin e realizimit te ketij objekti , anen funksionale te tij , masat qe jane parashikuar te merren dhe duhen te zbatohen konstatime se kryerja e ketij aktiviteti , nuk sjell e nuk do te sjelle pasoja te mundshme negative ne mjedis.

Rekomandime :

1. Gjate procesit te ndertimit ne zbatim te projektit te hartuar nga specialiste te fushave perkatese te mos preket apo perdoret sipërfaqe sheshi jashte nga ajo e planifikuar .
2. Te behet kujdes i vecante gjate ndertimit per trajtimin e mbetjeve te ndertimit me grumbullim ne nje vend te caktuar dhe evadim brenda dites ne vendin e caktar me pare nga njesia vendore
3. Te behet kujdes i vecante ne menyre qe te mosndotet sipërfaqja e tokes nga hedhja e perzierjeve te ndryshme me ujin , e rerave , gelqeres apo cimentos etj .
4. Te zbatohet rregullat teknike dhe masat e sigurimit teknik ne pune gjate ndertimit ne menyre qe te evitohet ne maksimum ndonje aksident i mundshem .
5. Te zbatohen rregullat e MNZ-se .
6. Te perdoret personel i kualifikuar dhe i instruktuar .
7. Te mos zihet as perkohesisht rruga apo sheshi jashte planifikimit me pare .
8. Te zbatohet ne cdo faze legjistacioni ne fuqi si gjate ndertimit ashtu edhe gjate funksionimit te kesaj veprimtarie .
9. Ne cdo rast avarie te mundshme te njoftohen menjehere strukturat perkatese per marrjen e masave ne menyre urgjente .

SHOQERIA “ERALD-G” shpk

Perfaqesuesi i Grupit te punes te Hartimit te Raportit te VNM-se
Ekspert i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Vendim Nr.122 , nr.5238 Prot., dhe
Nr. identifikues 577 dt.23.06.2017
Ing.Gezim ISLAMI

